



BISEDË **ME TË RINJTË**

- 12 PYETJE-PËRGJIGJE -

Osman Nuri TOPBASH





BISEDË **ME TË RINJTË**

Osman Nuri Topbash

PËRKTHEU

Elona Sytari

REDAKTOI

Dr. Irida Hoti

DIZAJN

Bledar Xama

BOTIMI I

Mars 2019, Shkodër

ISBN

ISBN: 978-992-82-0728-9

PROGRESI BOTIME

Sheshi "2 Prilli", Rr: Studenti

Shkodër, Shqipëri

Mob: +355 67 340 6182

www.progresibotime.com



Progresi Botime

BISEDË ***ME TË RINJTË***

- 12 PYETJE-PËRGJIGJE -

Osman Nuri TOPBASH

PARATHËNIE

Falënderimet dhe laudërimet e pafundme qofshin për Krijuesin e Gjithësisë, i Cili na krijoi si qenie njerëzore nga hiçi, na bëri besimtarë, ndjekës të rrugës së Muhamedit ﷺ, dhe na nderoi me shpalljen e Kuranit Famëlartë!

Salate dhe selame për udhërrëfyesin e kësaj bote dhe ndërmjetësuesin në botën tjetër, Muhamed Mustafanë ﷺ, për familjen dhe shokët e tij besnikë!

Më 17 Mars 2018 patëm rastin të takohemi me disa të rinj në Konja, qytet që vlerën e vërtetë e merr nga Mevlana Xhelaleddin Rumi, një personalitet i jashtëzakonshëm shpirtëror edhe pse në të njëjtën kohë Konja është një vatër e historisë, kulturës dhe qytetërimit.

Tema kryesore që u trajtua ishte “Çfarë u mësoi Pejgamberi ﷺ shokëve të tij? Si ua mësoi? Çfarë arriti t’i përcillte umetit (bashkësisë islame)?”

Meqë bashkëbiseduesit tanë ishin të rinj na u kërkua që bisedën ta zhvillonim në formë pyetje-përgjigjesh në mënyrë që ata të përfitonin më shumë.



Kështu çështjen e parë të diskutimit në lidhje me edukimin dhe mësimin e Pejgamberit ﷺ e konsideruam si pyetjen e parë dhe më pas u përpoqëm t'u përgjigjeshim pyetjeve të tjera të të rinjve tanë. Duke pasur parasysh që koha ishte e pamjaftueshme për t'iu përgjigjur thujtëse pesëdhjetë pyetjeve, menduam të trajtojmë me përparësi disa prej tyre.

Me dëshirën e mirë që nga ky program i bukur të mbetet një kujtim i ëmbël mbresëlënës, u kërkua nga Bashkia e Konjës që kjo bisedë të sillej në formën e një libri e më pas të botohej. Kështu, patëm rastin të bëjmë disa rregullime dhe plotësime në lidhje me disa çështje që për efekt kohe nuk arritëm t'i trajtojmë gjatë programit.

Shpresoj që ky libërth modest të jetë burim mirësie! Lutem për lumturinë në të dy botët për personelin e Bashkisë së Konjës që realizuan këtë program, për të gjithë ata që morën pjesë në këtë takim, si dhe për të gjithë ju lexues të nderuar!¹

Osman Nûri TOPBASH
Korrik, 2018
Yskydar

1. Falënderoj M. Akif Günay për kontributin e tij në përgatitjen e këtij libri si dhe i lutem Zotit të Gjithësisë që përpjekjet e tij të jenë një sadaka rrjedhëse!

KONJA - 17 Mars 2018

Shumë të çmuar djem, besimtarë, të guximshëm!

Shumë të çmuara, vajza besimtare!

Të dashur vëllezër dhe motra!

*Allahu na dhuroftë të gjithëve një jetë të dobishme
për atdheun, për të ardhmen dhe fatin e kombit tonë.*

E bekuar qoftë kjo ditë!

Për begatinë dhe përsipirtshmërinë e takimit tonë;

*Për shpirtin e të Dërguarit të Allahut, të paraardhësve tanë, të evlijave të Konjas, për të gjithë robërit
e mirë të Allahut,*

*Në mënyrë të veçantë për dëshmorët e Çanakalasë,
për dëshmorët e Luftës së Pavarësisë, për dëshmorët
e 15 Korrikut, në mënyrë të posaçme për dëshmorët
e Afrinit dhe me lutjen për shërim sa më të shpejtë të
veteranëve tanë.*

*Për mbrojtjen e atdheut e kombit tonë nga dëmi i
dashakeqve,*

*Le ta nisim me leximin një herë të sures **Fatiha** dhe
tri herë të sures **Ihlas**...*





Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti?

Ardhjen e të **Dërguarit të Allahut** ﷺ si mëshirë për botët,
Halid Bagdadi e rrëfen në këtë mënyrë:

*“Në saje të respektit ndaj tij, detet me rërë dhurojnë
margaritarë, sa e sa gurë të fortë bëhen rubinë e gjembat kthehen
në trëndafila. Në një bahçe ku flitet për moralin e tij të bukur, nga
gëzimi dhe entuziazmi nuk mbetet asnjë gonxhe e paçelur”.*

Pyetja e Parë

Profeti Muhammed ﷺ i dërguar si mëshirë për botët për të plotësuar moralin e bukur, arriti që nga një shoqëri gjysmë të egër e injorante, të ndërtonte një model botëror të qytetërimit duke i dhuruar njerëzimit epokën e lumturisë. Çfarë mësoi? Si mësoi? Çfarë arriti Pejgamberi ﷺ, krenaria e Gjithësisë, që në një interval të shkurtër kohor prej 23 vitesh të zhvillonte një shoqëri kaq të jashtëzakonshme të lumturisë?

Si pjesë e umetit të tij, 14 shekuj më vonë, ç'duhet të bëjmë që të përjetojmë përsëri emocionin e epokës së lumturisë dhe ta njohim botën me ato vlera të jashtëzakonshme të një qytetërimi të virtutshëm?

Shumë të nderuar vëllezërit e mi!

Në këtë trajtesë nevojitet një përmbledhje e krejt Historisë Profetike. Sigurisht në aspektin kohor kjo është e pamundur. Atëherë le të fillojmë:

- Përse Allahu na ka dërguar në këtë botë?
- Çfarë është dituria e vërtetë? Ç'është arsimimi?
- Cilat dituri duhet të përvetësojmë?
- Cili është qëllimi i diturisë?

Qëllimi i diturisë është të jemi robër të Allahut (t'i nënshtrohemi Allahut).²

2. Shih Dharijat, 56.



Ky univers është një shkollë e ndërtuar për t'u bërë shërbëtorë të Allahut, është një pasqyrë ku mund të shohim veten. Njeriu vjen në këtë jetë, jeton aq sa ka përcaktuar Krijuesi i Gjithësisë e më pas e pret një jetë e pafundme.

Cili është qëllimi i ibadetit? Ibadeti ka për qëllim njohjen e Zotit me zemër, përfitimin nga fshehtësia e të qenit bashkë me Të.

Krijuesi i Gjithësisë thotë:

“Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit...” (Isra, 70)

Njeriu duhet ta fitojë këtë nderim duke flakur tutje dëshirat epshore në mënyrë që të bëhet i denjë për Xhenetin madhështor. Kështu, Krijuesi i Gjithësisë e fton robërit e Tij për në Daru's-Selam (Vendin e Paqes).

Allahu i Lartë është Rrahman dhe Rrahim. Pejgamberi është “rauf dhe rahim.”³ Zoti ynë dëshiron që edhe besimtari të jetë “njeri i mëshirës”, në mënyrë që ai të jetë i denjë për Xhenetin.

Edhe qëllimi i mësimin në shkollën e kësaj bote është të qenit “njerëz të mëshirës” dhe edukimi i “njerëzve të mëshirës”. Në këtë mënyrë mund të ndërtojmë një botë të qetë.

Krijuesi i Gjithësisë, në një ajet kuranor, në lidhje me tiparet negative të njeriut shprehet: **“Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur...”** (Ahzab, 72)

3. Shih Teube, 128.



Së pari, njeriu është “dhalûm” (i padrejtë), dhe padrejtësinë më të madhe e kryen ndaj vetes duke shkatërruar të ardhmen e tij të përjetshme.

Përpara nesh qëndron një jetë e pafundme. Mbase jeta e kësaj bote nuk përbën as edhe një grimcë përballë jetës së përhershme. Padrejtësia më e madhe është ajo që njeriu i bën vetes duke shkatërruar të ardhmen e tij në Ahiret.

Së dyti, është “xhehûla” (shumë injorant). Pra, njeriu tregohet indiferent ndaj lumturisë së Ahiretit dhe harron qëllimin e krijimit të tij.

“- Përse erdhi në këtë botë?

- Në pronën e kujt jeton?

- Ku shkon? Për ku kjo rrjedhë?” Të mos jesh i vetëdijsëm ndaj këtyre pyetjeve është thelbi i injorancës...

Për këtë arsye Zoti ynë u ka dërguar robërve të Tij peygamberë. Sipas një transmetimi janë dërguar mbi njëqind e njëzet e katër mijë peygamberë. Për çdo popull është dërguar një peygamber. Përveç Peygamberit ﷺ, i cili u dërgua për mbarë njerëzimin deri në Ditën e Gjykimit, si “Usve-i hasene” d.m.th. “shembull më i mirë”...

Po ashtu Krijuesi i Gjithësisë i dërgoi njerëzimit libra dhe fletë.

Ky univers është një shfaqje e fuqisë dhe e madhësisë hyjnore nga mikrouniversi në makrounivers, nga atomi në galaktika.



Ajeti i parë i Kuranit Famëlartë nis me urdhrin **“Lexo!”**.

Me çfarë duhet të lexosh?

“...të lexosh me emrin e Zotit tënd.”⁴

Kjo do të thotë që Krijuesi i Gjithësisë leximit i jep një veçori: **“Të lexosh me emrin e Zotit tënd”**...

Çdo gjë që lexon me mendje, duhet ta lexosh edhe me zemrën tënde. Syri duhet të jetë drita e mendjes dhe e zemrës tënde. Zemra jote duhet të lexojë fshehtësinë dhe urtësinë e çdo sendi dhe qenieje, e kështu të arrijë të mbushet.

Çdo gjë është provë e madhështisë hyjnore. Për këtë arsye asgjë nuk duhet parë me një sy të zbrazët. Çdo shfaqje hyjnore duhet të shihet përmes meditimt. Natyrisht kjo përfshirje është e lidhur me gjendjen e zemrës.

Shkencat e dukshme / shkencat pozitiviste përbejnë një mundësi për njeriun për t’ju afruar Zotit. Në këtë mënyrë robi, me mendje e me zemër, duke kaluar nga gjurma tek Gjurmëlënësi, nga shkaku tek Shkaktari, nga arti tek Artisti, është në përpjekje të vazhdueshme që të arrijë tek Krijuesi Fuqiplotë.

Atëherë:

ÇFARË ËSHTË DITURIA E DOBISHME?

Dituria e dobishme është ajo dituri e cila e bash-

4. Shih, el-Alak, 1.



Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti? ﴿مَنْ مَعَهُ﴾

kon njeriun me devotshmërinë, që në Kuranin e Shenjtë përmendet 258 herë.

Çfarë është devotshmëria?

Devotshmëria është flakja tutje e dëshirave të egos, kultivimi i virtyeteve shpirtërore, ndërgjegjësimi i njeriut se ai përherë ndodhet nën vëzhgimin hyjnor. Pasurimi i zemrës me këto ndjesi është shenja më e rëndësishme e devotshmërisë.

Krijuesi i Gjithësisë shprehet se “njeriut i është dhënë pak nga dituria.”⁵ I Dërguari i Allahut ﷺ, arriti kulmin e diturisë. Kështu shprehej se:

“Sikur të dinit atë çfarë unë di (do qëndronit pa ngrënë e pa pirë) e do dilnit në rrugë...” (Ibn Maxhe, Zuhd, 19.)

Mevlana, kur përmbledh jetën e tij, gjendjen kulminante në shkencat pozitiviste e shpreh me termin “i papjekur”, kur sekretet e universit fillojnë të manifestohen tek ai e përshkruan gjendjen me termin “u poqa”, ndërsa shkrirjen e tij tek Krijuesi Fuqiplotë e përshkruan me termin “u dogja”.

SI MËSOI I DËRGUARI I ALLAHUT?

Në Mekë nuk ekzistonte ndonjë këshill shkencor, ndonjë bibliotekë apo shkollë. Meka ishte një fis. Nuk kishte as një klerik të mirëfilltë. As një murg apo mësues. Pejgamberi i Allahut u lind jetim dhe u rrit pa nënë e në mungesë të mbështetjes prindërore gjatë gjithë jetës.

5. Shih, el-Isra, 85.



Edukatori i tij ishte vetë Allahu. Në hadithin profetik thuhet:

“Mua më edukoi Allahu. Sa bukur më edukoi Ai.” (Sujuti, Xhamiu's-Sagir, I, 12.)

Allahu e edukoi të Dërguarin e Tij. Ndërsa i Dërguari i Allahut me këtë moral edukoi një umet të tërë. Në këtë mënyrë nga ato njerëz gjysëm të egër, u ndërtua qytetërimi i Epokës së Lumturisë.

METODA E TIJ E VEÇANTË E EDUKIMIT

I Dërguari i Allahut ﷺ nuk kishte qenë më parë edukator. Para ardhjes së profecisë, për 40 vjet, as nuk kishte mësuar nga dikush, as nuk i kishte mësuar dikujt diçka. Shoqëria në të cilën ndodhej ishte shoqëri injorante. Vetë Profeti ﷺ nuk dinte as shkrim dhe as lexim. Edhe shoqëria ishte analfabete. Thuajse nuk kishte fare njerëz që dinin të shkruanin e të lexonin.

Por, Krijuesi i Gjithësisë e mësoi dhe e edukoi Pejgamberin ﷺ aq bukur, sa ai u bë edukatori i krejt gjithësisë, duke i dhënë drejtim universit.

Një fazë tjetër:

METODA E TIJ E JASHTËZAKONSHME E DREJTIMIT

Para ardhjes së profecisë Pejgamberi ﷺ nuk kishte drejtuar asnjë betejë, nuk kishte qenë ushtar dhe nuk kishte njohje të organizimit ushtarak. Në



zonën ku ai jetoj ekzistonin vetëm ngatërresa mes fisesh. Por pas ardhjes së profecisë ai shpërndau mëshirë madje edhe në luftë. Kështu, përpara luftës së Bedrit, armiku shkoi të kërkonte ujë e Profeti ia dha.

Le të krahasojmë këshillat e Pejgamberit ﷺ me gjendjen e sotme:

Pejgamberi ﷺ ka thënë:

“O umeti im! Edhe nëse jeni në luftë:

- *Mos bëni padrejtësi!*
- *Mos torturoni!*
- *Mos vrisni fëmijë!”* (Muslim, Xhihad, 3; Ahmed, V, 352, 358.)

“O umeti im! Edhe nëse jeni në luftë mos vrisni:

- *Fëmijët*
- *Personat që janë në adhurim në faltoret e tyre (të krishterë, hebre etj.)*
- *Gratë*
- *Të moshuarit*
- *Njerëzit që nuk janë të përfshirë në luftë e që merren me punë të tjera (Veçanërisht)*
- *Mos digjni kishat*
- *Mos i prisni pemët në rrënjë!”* (Ahmed, I, 300; Taberani, Kebir, XI, 224/11562; Buhari, Xhihad, 148; Muslim, Xhihad, 24, 25.)⁶

6. Shih Taberani, Evsat, I, 48,/135; Ibn-i Maxhe, Xhihad, 30;



Këtë qasje e gjejmë edhe tek të parët tanë Osmanët. Ata asnjëherë nuk i bënë padrejtësi jomyslimanëve.

Një cilësi tjetër e Pejgamberit ﷺ ishte:

AFTËSIA E JASHTËZAKONSHME E UDHËHEQJES

I Dërguari i Allahut më herët nuk kishte drejtuar asnjë popull. Në fëmijëri, përveç drejtimit të tufës së bagëtive, nuk kishte menaxhuar asgjë tjetër. Mirëpo me ndërtimin e Shtetit Islam të Medines ai hodhi themelet e një qytetërimi të lartë.

Ai i shpëtoi të gjitha krijesat nga e keqja e zulumqarëve.

Robërit gjetën paqe. Kafshët gjetën qetësi. Bimët gjetën prehje. Shkretëtirat që ishin kthyer në lumenj gjaku u paqësuan...

Sa bukur e shpreh Mehmed Akif Ersoj këtë gjendje:

I dobëti dhe i pafuqishmi që shtypeshin shumë, gjetën jetë.

U zbeh dhuna që asgjësimin se shkonte as ndër mend.

Po ashtu në anën tjetër vërehet edhe:

DREJTËSIA E TIJ E JASHTËZAKONSHME

Ai nuk ishte jurist. As nuk kishte ndonjë eks-

Vakidi, III, 912; Abdurrezzak, Musannef, V, 220.



Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti? 

periençë në praktikimin e drejtësisë dhe ligjeve. Mirëpo Hútbja e tij e Lamtumirës u kthye në një “Deklaratë të të Drejtave të Njeriut”. Ajo u kthye në një kushtetutë të pandryshueshme.

Sapo ndërtoi Shtetin e parë Islam në Medine, i Dërguari i Allahut themeloi edhe kushtetutën e parë.

Shkollat e drejtësisë, të cilat u krijuan nga nxënësit e tij në një kohë të shkurtër, tejkaluan majat në të cilat mendja njerëzore nuk do mund t'i arrinte në qindra vjet. Juristët e famshëm Soloni dhe Hammurabi, nuk mund të konsideroheshin as çirakë përballë gjenialitetit të Ebu Hanifes...

Aristoteli ka hedhur bazat e disa rregullave dhe ligjeve mbi filozofinë e etikës. Mirëpo ngaqë filozofia e tij ishte larg shpalljes hyjnore, populli nuk arriti lumturinë e kërkuar me këtë filozofi; sepse idetë dhe veprimet e filozofëve nuk ishin pjekur nën udhëzimin e shpalljes hyjnore. Prandaj dhe sistemet që ata kanë sjellë nuk kanë depërtuar përtej sallave të konferencave apo rreshtave të librave.

Kurse i Dërguari i Allahut mori udhëzime nga shpallja hyjnore. Për këtë arsye sistemi që ai solli është i përsosur për njerëzimin. Ai shënoi kulmin në çdo fushë, arritjet e tij ishin të jashtëzakonshme. Sepse edukatori i tij ishte vetë Allahu ﷻ.

NXËNËSIT E TIJ

Karafi (v. 684), një ndër emrat e famshëm në



fushën e metodologjisë së jurisprudencës islame, thotë:

“Sikur i Dërguari i Allahut të mos kishte asnjë mrekulli tjetër përveç faktit që edukoi një brez sahabësh (nga njerëz gjysëm të egër në njerëz të qytetëruar), kjo do t’i mjaftonte atij si argument i profecisë.”

Për shembull:

Abdullah ibn Mesudi... ishte bari. U bë themelues i një Shkolle Juridike me të cilën e gjithë bota mahnitet. Ebu Hanifja u edukua si nxënës i kësaj Shkolle në Kufe.

Çfarë u mësoi tjetër ai Zotëri?

U MËSOI KURANIN

Pra i mësoi njerëzimit udhëzimet e Krijuesit të Gjithësisë. I mësoi Kuranin Famëlartë, thirrjen e fundit të Zotit të Gjithësisë drejtuar njerëzimit.

SI PËRPIQEJ AI ﷺ TË MËSONTE TË TJERËT?

Ebu Talha ﷺ tregon:

“Një ditë shkova pranë të Dërguarit të Allahut. Ishte bërë dyfish nga uria sa që për të mbajtur trupin drejt kishte lidhur një gur në bark. Në atë gjendje po ia mësonte Kuranin banorëve të Suffes.” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 342.)

Ibn Mesudi ﷺ, një nga sahabet që ishte nderuar



Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti? ﴿٢٠٠﴾

me shfaqjet e urtësisë në mësimin dhe edukimin profetik, thoshte:

“Kishim mbërritur në atë gjendje saqë dëgjonim dhikrin e kafshatave të bukës.” (Buhari, Menakib, 25)

Ebu Hurejre ؓ thotë:

“Teksa të gjithë ishin të interesuar në mbledhjen e hurmave nëpër bahçe, ne edhe pse të uritur, mblidheshim rreth Profetit ﷺ për të nxënë dituri.” (Buhari, Ilim, 42.)

Me pak fjalë, me përpjekjet e të Dërguarit të Allahut e tërë Medina qe mbushur me mësues të Kuranit Fisnik. Pejgamberi ﷺ u përpoq t'i përhapte ata në çdo anë të botës.

DËLIRËSIA E KURANIT

Përmes Kuranit Fisnik, Medina u ndriçua nga një gjendje shpirtërore e lartë. Krijuesi i Gjithësisë shprehet:

وَنُزِّلَ مِنَ الْقُرْآنِ مَا هُوَ شِفَاءٌ وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ

“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët...” (Isra, 82)

Allahu Fuqiptotë bën me dije se Kurani është “shërim dhe mëshirë”. Edhe ne shpresojmë të marrim hise nga ky shërim e nga kjo mëshirë...

Nëse do të na duhej të jepnim disa shembuj nga mëshira e Kuranit, themi se:



Xhebraili zbriti Kuranin dhe u bë meleku më i lartë.

Kurani i zbriti Muhamedit ﷺ. Ai u bë zotëria i të gjithë peygamberëve, “Sejjidu’l-Enbija”.

Kurani i zbriti Muhamedit ﷺ. Ndjekësit e tij u bënë bashkësia më e vlerësuar, umeti i mëshirës.

Kurani zbriti në muajin e bekuar të Ramazanit, duke i falur këtij muaji një vlerë të lartë. Ai u bë muaji më i bekuar, duke mbartur një bukuri të veçantë në mesin e dymbëdhjetë muajve.

Kurani zbriti në natën e Kadrit. Krijuesi i Gjithësisë i fali asaj nate vlerën e më shumë se një mijë muajve.⁷

Sikur Kurani të zbriste në zemrat tona e në jetën tonë, edhe ne do bëheshim njerëzit më të dobishëm të të gjithë njerëzimit.

Në këtë mënyrë u edukua një brez i tërë i sahabëve. Ata u bënë “njerëz të mëshirës”, prej dorës, gjuhës e zemrës së të cilëve përhapej vetëm mëshirë. Shpresojmë të ecim edhe ne në gjurmët e tyre.

Për këtë arsye i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Më i dobishmi nga ju është ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson atë të tjerëve.” (Buhari, Fedailu’l-Kuran, 21.)

Si duhet t’u përcillet Kurani të tjerëve? Vetëm duke u vënë në jetë.

7. Shih el-Kadr, 3.



AI U MËSOI IMANIN

Pjesa më e vështirë e fesë është ruajtja e imanit, akides. I Dërguari i Allahut përgjatë 13 viteve të profecisë së tij në Mekë, u mësoi sahabëve besimin. Imani shkërmoqi çdo fanatizëm e padrejtësi. Sahabët nuk u përkulën përballë asnjë padrejtësie. Ranë dëshmorë, pasuria u humbi, por kurrsesi nuk hoqën dorë për asnjë çast nga besimi.

Sahabët ditën ta ruanin imanin përballë shumë sprovave të rënda. Me fuqinë e besimit në zemër, arritën t'i kalojnë të gjitha pengesat e egos.

Edhe kur emigruan, një pjesë në këmbë e një pjesë mbi deve, lanë pas mallin e pasuritë e tyre.

Qëndrueshmëria në besim që shfaqën Sumejja dhe Jasiri kur ranë dëshmorë, është për ne një shfaqje madhështore e virtytit.

Krijuesi i Gjithësisë shprehet kështu për besimtarët:

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit...” (Teube, 111)

Besimi pra, tejkaloi çdo fanatizëm.

AI U MËSOI SE JETA E VËRTETË ËSHTË JETA E AHIRETIT

Në kohët e vështira të luftës së Hendekut (të urisë, të ftohtit) ai thoshte:

اللَّهُمَّ لَا عَيْشَ إِلَّا عَيْشُ الْآخِرَةِ



“Zoti im, jeta e vërtetë është jeta e Ahiretit.”

(Buhari, Rikak, 1.)

Po ashtu, edhe në kohën e çlirimit të Mekës, në momentin e triumfit, në mënyrë që të pengonte kalimin në euforizëm, thoshte:

“Zoti im, jeta e vërtetë është jeta e Ahiretit.”

(Buhari, Rikak, 1.)

Me pak fjalë, besimtari në asnjë fazë të jetës nuk duhet të harrojë se jeta e vërtetë është ajo e përtejnjës. Gjithnjë duhet të shqetësohet për Ahiretin.⁸

AI U MËSOI ADHURIMET

U mësoi namazin

U mësoi njerëzve anën juridike të namazit, por edhe anën shpirtërore të tij. U mësoi një namaz ku zemra dhe trupi ishin në harmoni, e ky namaz, do ta ndalte robin nga paturpësia dhe e keqja.

“Si falem unë?”

Sahabët shfaqnin në sjelljet e tyre dimensionin shpirtëror, duke monologuar:

- A sheh syri diçka të gabuar?
- A përpiket veshi të dëgjojë diçka që nuk duhet?
- A flet goja ndonjë fjalë të pavend?
- Cilat janë punët e mira? Po përfitimi?”

8. Shih Zumer, 9.



Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti? ﴿تَبٰرَكَ﴾

Të gjithë këto qëndrime ishin treguesit e namazit.

Krijuesi i Gjithësisë, në lidhje me namazin e falur në mënyrë të denjë, shprehet kështu:

“...Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar...” (Ankebut, 45)

Por në anën tjetër ka nga ato namaze të shkujdesura për të cilat i Dërguari i Allahut ka thënë:

“Njeriu fal namaz, por nuk i pranohet i tërë namazi: vetëm një e treta, një e katërta, një e pesta, një e gjashta, një e shtata, një e teta, apo një e dhjeta.” (Ebu Davut, Salat, 123, 124.)

Po ashtu për të njëjtën arsye i Dërguari i Allahut ka porositur:

*“Faleni namazin ashtu siç më shihni mua duke e falur.”*⁹

*“Falni namazin sikur të ishte namazi juaj i fundit.”*¹⁰

Ai u mësoi agjërimin

Ai mësoi se krahas agjërimit të lukthit, është i domosdoshëm agjërimi i syrit, veshit dhe ç’është më e rëndësishme agjërimi i ndërgjegjes dhe ndjenjave. Agjërimi i kultivoi atij ndjenjën e mëshirës dhe dhembshurisë, i mësoi të përkujtojë mirësitë e Allahut...

9. Buhari, Ezan, 18.

10. Dejlami, Musned, I, 431.



Ai u mësoi zekatin, bamirësinë e lëmoshën

Ai mësoi se pronari i vetëm i gjithçkaje është vetëm Krijuesi i Gjithësisë.

Ai i mësoi njerëzve të lumturoheshin kur falnin.

Duhet të lumturohesh kur jep, sepse në ajetin fisnik thuhet:

يَأْخُذُ الصَّدَقَاتِ

“...**Ai që pranon bamirësinë...**” (Teube, 104)

Ai mësoi që lëmosha duhet dhënë vetëm për kënaqësinë e Allahut.

Ai u mësoi Haxhin

Haxhi është një provë e Ditës së Mahsherit.

Është një adhurim kulmor në hijeshi e një ftesë për meditim.

Pjesë e haxhit është edhe gjuajtja e shejtanit me gurë. E në anën tjetër nuk lejohet të shkulet bari, të bëhet gjueti, t’i tregohet gjahu gjuetarit, nuk lejohet shthurja, grindjet e gjendjet e tjera negative.

Ai mësoi pra një haxh të tillë.

AI U MËSOI TË KËRKOHET VIRTYTI

Sahabët u bënë aq të virtytshëm sa nuk e pyesnin Pejgamberin ﷺ nëse diçka ishte “farz, vaxhib apo sunet”. Ata pasonin gjithçka shihnin prej tij.

Enesi ﷺ tregon:

Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti? ﴿تَبَارَكَ﴾

“Një ditë e pashë të Dërguarin e Allahut teksa falte namazin e Duhasë. Që prej asaj dite nuk e kam lënë asnjëherë këtë namaz.”

Edhe Hasan Basriu që e përcjell këtë transmetim shprehet me të njëjtën ndjeshmëri:

“Pas kësaj fjale të Enesit as unë nuk e kam lënë asnjëherë namazin e Duhasë.” (Taberani, Evsat, II, 68/1276.)

AI U MËSOI ZGJIMIN NË SEHER

Ai mësoi sesi përmes kohës së seherit duhet të përgatitemi për ditën në vazhdim. Domethënë na mësoi ta gjallërojmë zemrën përmes ushqimit shpirtëror në kohën e seherit.

Po ashtu na mësoi sesi përmes ditës të përgatitemi për natën. Gjatë ditës duhet ta ruash syrin, veshin e ndërgjegjen që të mund të përgatitesh për natën.

Ai mësoi së duhet jetuar një jetë me devotshmëri ashtu si: dielli pason hënën, e hëna pason diellin, nata ditën e dita natën.

AI U MËSOI PASTËRTINË

Ai u mësoi njerëzve pastërtinë në çdo drejtim. U mësoi atyre si të pastroheshin nga politeizmi, femohimi e morali i keq.

Në ajetin fisnik thuhet:



قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّيْهَا

“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë.” (Shems, 9)

Ashtu sikurse u tregoi njerëzve pastërtinë materiale duke u mësuar atyre abdestin e guslin, ashtu u mësoi edhe dëlirësinë shpirtërore, pastërtinë e zemrës e të shpirtit.

Mësoi pastrimin nga e papastra. Mësoi se nuk duhet shëtitur në mënyrë të parregullt.

Ai mësoi si duhet të jetohet një personalitet dhe karakter i mirëfilltë islam.

Më e rëndësishmja:

AI U MËSOI TË DREJTËN DHE LIGJIN

Ai u mësoi njerëzve të epokës së injorancës termin “drejtësi”. Mësoi se nuk ka të drejtë gjithmonë ai që është i fortë, por është i fortë gjithmonë ai që ka të drejtë.

Në anën tjetër na mësoi të drejtat tona:

Na mësoi të drejtën e Krijuesit, e Pejgamberit, e besimtarëve, e të gjitha krijesave...

Shpeshherë ai na mësoi sesi duhet përhapur drejtësia duke sjellë shembuj nga vetja e tij:

“Në fund të fundit ashtu si ju edhe unë jam njeri. Mund t’i kem hyrë në hak ndonjërit prej jush. Nëse i kam rënë dikujt në shpinë, ja shpina ime, le të vijë të më godasë! Nëse dikujt i kam



Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti? 

prekur pasurinë pa dashje, ja pasuria ime, le të vijë ta marrë!” (Ahmed, III, 400.)

Ai na mësoi të përhapim drejtësinë e ligjin duke qenë vetë shembull i gjallë i saj. E njëjta qasje ndaj drejtësisë dhe ligjit u ndoq edhe nga pasuesit e tij.

Për shembull në historinë tonë tregohet sesi Sulltan Mehmed Fatihu doli në gjyq me një arkitekt të krishterë. U ul në karrigen e të akuzuarit. Kadiu Hëzër Bej i dërgoi një thirrje gjyqësore.

Nuk iu drejtua me fjalët: “*Sulltani biri i Sulltanit, Fitimtari, Babai i Çlirimit, Muhamed Han-i Thani*”, siç i drejtoheshin rëndom, por i tha: “Mehmedi i biri i Muratit, eja në gjyq në filan orë”.

Fatihu shkoi në gjyq. Mund edhe të mos shkonte. Sepse ai ishte sundimtari i botës, i cili kishte ndërtuar një epokë të re historike. Gjithsesi ai u ul në bankën e të akuzuarit.

Kadiu i tha:

“Akuzohesh për një dëm, ngrihu në këmbë!”

Fatihu u ngrit dhe foli. Por kadiu e shpalli fajtor.

Arkitekti i krishterë tha:

“- Askush në këtë botë nuk ka përhapur një drejtësi të tillë.” - dhe kështu pranoi Islamin.

Përsëri i Dërguari i Allahut:

U MËSOI MORALIN E BUKUR

Në Islam ekziston parimi “largimi i së keqes është më parësor se afrimi i së mirës”. Kjo do të thotë



që për të arritur në një shkallë të lartë të moralit, fillimisht duhet dëbuar çdo sjellje e shëmtuar.

Çfarë duhet të pastrojmë nga veset e këqija të zemrës?

“Egoizmin, padrejtësinë, hakmarrjen, lakminë, pangopësinë, përçarjen, urrejtjen, krenarinë, mendjemadhësinë, gënjeshtren, thashethemet.”

Të gjitha këto duhet të fshihen nga zemra. Këto cilësi negative nuk kanë vend në besim, e zemra duhet pastruar prej tyre.

Me çfarë duhet t'i zëvendësojmë ato në zemër?

Duhet të zënë vend cilësi të tilla të bukura, si: dashuria hyjnore, mëshira, shërbimi, modestia, bujaria, patriotizmi, bindja ndaj drejtësisë, drejtësia, bindja, të qenurit El-Emin (besnik) dhe es-Sadik (i sinqertë), paramendimi për mirë, bamirësia, respekti, paanshmëria, falja, sinqeriteti, serioziteti, edukata, durimi, turpi.

I Dërguari i Allahut u mësoi pikërisht këto cilësi të bukura sahabëve të tij. Ata u lartësuan përmes këtyre cilësive.

Zotëria ynë ﷺ;

U MËSOI ÇFARË DUHET MPOSHTUR DHE RRUGËN QË DUHET TË NDJEKIM PËR KËTË QËLLIM

**U mësoi se sprovat dhe fatkeqësitë duhen
mposhtur me anë të namazit dhe durimit:**



Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti? ﴿تَبٰرَكَ﴾

Jeta ka vazhdimisht *baticat e zbaticat* e saj, ka *sprovat* e saj. *E si do të përballohen?* Me durim e me namaz. Në ajetin fisnik thuhet:

“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit!...” (Bekare, 153)

U mësoi se harresa mund të eleminohet përmes dhikrit:

I Dërguari i Allahut ﷺ bënte dhikër në mënyrë të vazhdueshme.

Teksa shihte nga qielli, mahnitej me madhështinë e Zotit dhe përmendte Allahun. Shihte veten, shihte tokën e përsëri përmendte Allahun. Kudo që shikonte e përkujtonte Zotin.

Edhe ata që patën fatin të shohin fytyrën e tij, e përkujtonin Allahun. Ai kishte arritur t'i sillte zemrat e tyre tek ëmbëlsia e dhikrit.

Ai u mësoi sahabëve “të shpëtonin nga harresa duke bërë dhikër”. Sepse njeriu atëherë kur harron, mëkaton. Askush nuk mundet që duke thënë “emrin e Zotit (bismilah)” të përgojë dikë, të merret me thashetheme apo t'i bëjë dëm dikujt.

U mësoi se mosmirënjohja mund të eleminohet përmes falënderimit:

Mosmirënjohja është fatkeqësia më e madhe e njeriut! Është njësoj sikur t'i thuash lamtumirë njerzillëkut e ndërgjegjes, njësoj sikur të bëhesh injorant e i pasjellshëm!



Njeriu duhet të meditojë rreth mirësive që Allahu i ka dhuruar e të pasurojë botën e tij të brendshme. Në këtë mënyrë ai do të mbrohet nga rënia pre e ndjenjave egoiste.

Nevojitet që ai të shohë drejt vetes, universit, ekuilibrit hyjnor dhe ekologjik. Duhet të shohë atomin, galaktikat, qelizën, krijesat madhështore e të mahnitet me madhështinë e Zotit.

Të gjitha këto mundësi iu dhuruan njeriut. Në ajetin fisnik thuhet:

“Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej dhe në Tokë, të gjitha janë prej Tij. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë.” (Xhathije, 13)

U mësoi se rebelimi eleminohet me bindje:

Njeriu nuk duhet të vendosë nëse diçka është e mirë apo e keqe, duke u bazuar në pëlqimin apo refuzimin e tij vetjak. Krijuesi i Gjithësisë shprehet:

“...mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju...” (Bekare, 216)

Për këtë arsye kriteri i vlerësimit duhet të jetë gjithmonë pëlqimi i Allahut. Njeriu, duhet të përpiqet në mënyrë të vazhdueshme t'i mbështetet Allahut dhe të jetë i kënaqur pavarësisht kushteve të ndryshme.

I Dërguari i Allahut ﷺ, edhe pse në Taif u godit me gurë, u lut duke thënë:



Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti? ﴿مَنْ سَأَلَ عِلْمًا فَهُوَ كَيْفَ يَسْأَلُ﴾

“Zoti im! Nëse Ti nuk je i hidhëruar me mua, unë nuk merakosem për gjë tjetër.” (Ibn-i Hisham, II, 29-30; Hejthemi, VI, 35.)

Nga ana tjetër:

لَا يَعْلَمُ الْغَيْبَ إِلَّا اللَّهُ

“Askush nuk mund ta njohë të fshehtën përveç Allahut.”

Ti nuk e njeh të fshehtën. Diçka që ti e sheh si të dobishme mund të rezultojë e dëmshme, ose diçka që ti e sheh si të dëmshme mund të rezultojë e dobishme. Prandaj i Dërguari i Allahut ﷺ, ka mësuar se gjithnjë duhet të tregohet pëlqim pa kushte ndaj kaderit (paracaktimit) të Zotit.

Për shembull, nëse dikujt Allahu nuk i ka falur fëmijë, ai nuk duhet të mërzitet, duhet të kënaqet me caktimin e Zotit, sepse ai nuk e di nëse fëmija do t'i kishte sjellë atij dëm apo dobi. Ne nuk mund ta dijmë të fshehtën. Nuk duhet të harrojmë faktin se as Aishja ؓ nuk kishte fëmijë.

U mësoi se koprracia eliminohet me bujari:

Koprracia është kanceri i shpirtit, është rrënimi i botës shpirtërore, është prirja e njeriut drejt adhurimit të pasurisë e parasë.

Aishja ؓ rrëfen:

“Familja e të Dërguarit të Allahut që prej ardhjes



në Medine e deri në ditën e vdekjes nuk është ngopur tre ditë rresht me miell gruri.” (Muslim, Zuhd, 20)

“I Dërguari i Allahut gjatë gjithë jetës së tij nuk u ngop dy ditë rresht me bukë elbi.” (Buhari, Ejman, 22; Ibn-i Maxhe, Et’ime, 48.)

“Kalonin tre muaj e në shtëpinë e të Dërguarit të Allahut nuk ndizej oxhaku. (Anëtarët e familjes) e kalonin urinë me hurma dhe ujë.” (Buhari, Hibe, 1; Rikak, 17; Muslim, Zuhd, 28.)

Kënaqësia më e madhe e të Dërguarit të Allahut ishte të dhuronte; të përmbushte nevojën e një të dobëti, të varfri, të vetmuari, nevojtari. Tek i Dërguari i Allahut, kënaqësia e dhurimit i mbijetonte urisë. Këtë ia mësoi edhe umetit (pasuesve) të tij.

Xhabiri ﷺ thotë:

“Nuk njoh ndonjë sahab që të ketë pasur mall e pasuri e të mos e ketë dhuruar atë.” (Ibnu Kudame, el-Mugni, V, 598.)

U mësoi së pangopësia duhet eliminuar me ndjenjën e mjaftueshmërisë

I Dërguari i Allahut ﷺ, thotë:

“Sikur njeriu të kishte një luginë me ar, do të dëshironte të dytën. Gojën e tij s’e ngop gjë tjetër përveç dheut...” (Buhari, Rikak, 10; Muslim, Zekat, 116-119.)

Ndërsa Ahmed ibn Hambeli thotë:

“Besimtari kënaqet me pak pasuri, ndërsa ambiciozi nuk ngopet as me shumë pasuri”.



Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti? ﴿٢٢﴾

Ai u mësoi se mizoria duhet eliminuar me ndjenjën e faljes:

Krijuesi i Gjithësisë shprehet:

**“Vallë, a nuk doni ju që Allahu t’ju falë?
Allahu është Falës e Mëshirëplotë.”** (Nur, 22)

Edhe sahabët ndërtuan një vllazëri të tillë. Ata falën gabimet e pakta të vëllezërve të tyre. Ata falnin siç falte i Dërguari i Allahut.

Çlirimi i Mekës ishte rasti i duhur për t’u hakmarrë. Ishte koha për të marrë hakun e 20 viteve padrejtësi. Politeistët e Mekës erdhën pranë të Dërguarit të Allahut duke u dridhur nga frika dhe e pyetën:

“Çfarë ka për ne sot?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, u përgjigj:

“-Falje!”

“-Sa njeri i jashtëzakonshëm je ti!”-i thanë politeistët. (Ibn Hisham, IV, 32; Vakidi, II, 835; Ibn-i Sa’d, II, 142-143.)

Ai u mësoi së dyshimi duhet larguar me bindje:

وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنْتُمْ

“...Ai është me ju kudo që të gjendeni...”

(Hadid, 4)



Krijuesi i Gjithësisë nuk është i kufizuar në kohë apo vend. Robi i devotshëm në mënyrë të pandërprerë duhet të jetë i bindur me zemër dhe i ndërgjegjshëm se ndodhet nën vëzhgimin e kamerave hyjnore.

Kjo është “mirësia”...

**U mësoi se hipokrizia mund të mposhtet
përmes sinqeritetit:**

Besimi i mbështetur në Zotin Një nuk ka sesi t'i lërë vend idhujtarisë.

**U mësoi së mendjemadhësia dhe fanatizmi
duhet t'i lënë vend modestisë:**

Në këtë mënyrë njeriu duhet të bëhet “ibadurrahman” (Rob i të Gjithëmëshirshmit). Në ajetin fisnik thuhet:

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë..” (Furkan, 63)

**U mësoi se kryeneçësia
duhet mposhtur me pendesë:**

Ai hapi dyert e faljes. Por në të njëjtën kohë mësoi se pendesa duhet të jetë e sinqertë.

**U mësoi se shkujdesja mund të largohet
përmes meditimit:**

Sepse meditimi është çelësi i besimit.



Ai urdhëroi largimin nga harami duke i shëruar kështu edhe zemrat:

Si duhet larguar nga harami?

-Në vend të tradhëtisë bashkëshortore ai orientoi drejt kënaqësisë së lidhjes bashkëshortore dhe qetësisë së jetës familjare.

-Në vend të kamatës dhe mashtrimit ai këshilloi drejt borxhit të mirë e fitesës në rrugë të lejuara.

-Në vend të shëmtisë së haramit, i drejtoi njerëzit drejt bukurisë së hallallit. Ai mësoi se përballë çdo ndalese që e kënaq shejtanin ndodhet diçka e lejuar që e kënaq Krijuesin e Gjithësisë.

SI U MËSOI?

Ai ishte një edukator që duhej nga të tjerët:

Dashuria është një rrjedhje mes dy zemrave. Ai deshi dhe u desh aq shumë saqë të gjithë njerëzit u mahnitën nga karakteri i tij duke e quajtur “el-Emin” (besniku) “es-Sadik” (i sinqerti). “Çdo gjë që ti thua është e vërtetë”, - deklaroi të gjithë. Madje edhe Ebu Xhehli thoshte: “Ti je njeriu më i drejtë në mesin tonë. Je njeriu me karakterin më të lartë. Por ne nuk e pranojmë atë çfarë na ke sjellë”.

Ai ishte shumë miqësor dhe tregonte kujdes ndaj njerëzve:

Në mënyrë të veçantë ai tregonte kujdes ndaj nxënësve të dijes, duke i mbajtur pranë.



Ai i hipte mbi kafshën e tij. Nganjëherë e mbante për dore bashkëbiseduesin e tij.

Ai nuk u lodh, sakrifikoi:

Në çdo rast tregoi se çmimi i mirësisë së besimit duhet paguar. Gjatë njëzet e tre viteve të profecisë, as edhe një ditë të vetme nuk reshti nga thirrja. Ai asnjëherë nuk u shpreh: “Këto tri ditë do të pushoj nën hijen e kësaj hurme dhe do të çlodhem.” Madje në jetën e tij nuk ekzistonte fjala pushim. Pushimi i tij ishte kënaqësia që i jepte shërbimi në rrugë të Allahut. Ai pushonte përmes kënaqësisë shpirtërore që i falte ky shërbim.

Pa kompromis, por gradualisht:

Ai edukoi sipas nivelit të të kuptuarit. Fjalën e fundit nuk e tha kurrë të parën. Mbikëqyri rendin. Priti me durim që bashkëbiseduesit të ishin gati.

U mësoi duke dhënë parime dhe rregulla:

Vendosi parime dhe rregulla që do të vlejnin deri në Ditën e Kiametit.

U mësoi sipas prirjeve:

Fillimisht identifikoi prirjet e sahabëve e pastaj i mësoi njerëzit sipas prirjeve të tyre.

Disa prej sahabëve të tij u bënë komandantë lufte, disa prijës fetar e disa vali (guvernatorë)...



Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti? 

Aishja  u bë dijetare (muxhtehide), një nga 7 dijetarët e mëdhenj.

Ai i ndali sahabët që tentuan të kalonin kufirin (e normales):

Ai nuk e lejoi (fanatizmin) ekstremizmin, por këshilloi rrugën e mesme.

Ai thoshte: “A nuk jam unë një shembull për ju?”¹¹

Ai tregonte shumë kujdes ndaj të rinjve:

Ai i trajtoi në mënyrë të veçantë të rinjtë. Valiu i Mekës ishte rreth të 20-ve. Edhe Usame bin Zejd, një ndër komandantët e ushtrisë Islame, ishte i së njëjtës moshë. Gjithashtu edhe Xhafer Tajjari kur shkoi në Etiopi ishte pak a shumë në atë moshë. Po ashtu edhe Aliu në Hajber...

I Dërguari i Allahut tregonte shumë kujdes ndaj të rinjve, sepse e ardhmja i përket rinisë. Janë ata që do të marrin detyra të rëndësishme në të ardhmen e Islamit e do të shpërndajnë shembullin e personalitetit dhe karakterit Islam.

Si u mësoi ai?

Ai u mësoi duke jetuar:

Njëzet e tre vjet të jetës profetike ishin shembull në çdo moment.

11. Ahmed, VI, 226; Ibn-i Haxher, el-Isabe, IV, 291.



Askush nuk mund të pretendojë se “ka kaluar një situatë që nuk është jetuar në jetën e Profetit apo në epokën e lumturisë”.

ÇFARË ARRITI AI?

CILI ISHTE PËRFUNDIMI I MËSIMIT DHE EDUKIMIT TË TIJ?

Nga një periudhë e injorancës u ndërtua një epokë e lumturisë.

Ç’ ishte periudha e injorancës?

Një jetë mes fisesh, një shoqëri e egër.

Kishte dy shenja dalluese të rëndësishme.

E para, ishte mohimi i Ahiretit.

E dyta, ishte prezenca e sistemit të hierarkisë. Fisnikët e pasur shtypnin robërit e varfër. Në mënyrë të veçantë jetimët nëpërkëmbeshin.

Gjithashtu nuk kishte asgjë të ndalte epshet, ambiciet. Feja, morali, arsyetimi, ndërgjegjja kishin arritur në kufirin e zhdukjes.

Alkooli, kumara, kamata, imoraliteti, tradhëtia bashkëshortore kishin arritur kulmin...

Kjo ishte edhe arsyeja pse ata i dolën kundër Islamit. Politeistët thonin:

“Ti o Muhamed! Ndryshoji këto (ligje), e ne do të të pasojmë, do të të japim çfarë të duash”.

Ndërsa ai ﷺ si kundërpërgjigje thoshte:



Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti? 

“Për Allahun, edhe sikur të më jepnit diellin në dorën e djathtë e hënën në të majtën që unë të heq dorë nga kjo kauzë, (unë) kurrë nuk do të tërhiqesha. Ose Allahu do ta përhapë këtë fe në katër anët e botës e detyra ime do të përmbushet, ose unë do të vdes në këtë rrugë!”¹²

SI ARRITI I DËRGUARI I ALLAHUT QË NGA NJË SHOQËRI INJORANTE TË NDËRTONTE EPOKËN E LUMTURISË?

I Dërguari i Allahut ﷺ, sahabëve të tij, pra atyre që e pasuan, nuk u dha as para e pasuri, as u premtoi poste e ofiqe. Ai u shfaqti atyre një personalitet të lartë, sepse njerëzit mahniten ndaj karakterit të bukur.

Trashëgimia më me vlerë që i Dërguari i Allahut la pas, është shembulli i tij i lartë i karakterit dhe personalitetit. Ai dëshironte që edhe ne ta pasojmë këtë shembull dhe t'i mësojmë të tjerët me të.

Ai tha: *“Po ju lë dy amanete: Kuranin dhe Traditën Profetike.”* (Muvatta, Kader, 3.)

Karakter i lartë i Profetit ﷺ, ndershmëria, drejtësia e morali i tij i bukur ishin tipare që i pranuan madje edhe ata që nuk e besuan.

Kështu, para se të fillonte thirrjen në Islam, i mblodhi të afërmit e tij dhe u tha:

12. Ibn-i Hisham, I, 278; Ibn-i Kethir, el-Bidaje, III, 96-97; Ibn-i Esir, el-Kamil, II, 64.



“A do të më besonit (mua) nëse do ju thoja se pas këtij mali gjendet një armik?”

Ata u përgjigjën:

“Ti je i el-Emin (besniku), es-Sadik (i sinqerti), je njeriu më i drejtë në mesin tonë.” (Buhari, Tefsir, 26)

Kjo do të thotë që një mysliman duhet të jetë përherë shembulli i karakterit të lartë në mënyrë që edhe të tjerët t'i besojnë.

Kjo është një ndër shkaqet kryesore pse boshnjakët apo shqiptarët e sotëm e kanë pranuar fenë Islame. Ata që erdhën pas Sulltan Muratit të I-rë, vendosën në këto treva familje të zgjedhura nga Anadulli, Konja e Kajseri. Shumëkush e pranoi Islamin vetëm duke u ndikuar nga shembulli i tyre.

Njerëzit e vrazhdë të kohës së injorancës pasi pranuan Islamin, u edukuan nga Pejgamberi ﷺ dhe fituan një personalitet të lartë, u bënë nga “të diturit e vërtetë”, duke përfituar nga dituria e vërtetë.

Çfarë ndodhi? Meditimi u thellua:

Filloi një fazë meditimi të thellë rreth shembujve të tillë si:

- Zhvillimi i trupit të njeriut nga një pikë ujë.

I zogut nga një vezë e thjeshtë.

I pemëve dhe frutave nga një farë e vogël pothuajse e padukshme.

- Jeta u përqendrua në arritjen e kënaqësisë së Allahut.



Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti? ﴿مَنْ مِمَّنْ﴾

- Përhapja e mëshirës, dhembshurisë e drejtësisë arriti kulmin.

- Qëllimi parësor i sahabëve ishte përngjasimi me të Dërguarin e Allahut.

- Ata jetonin një jetë brenda kufijve të devotshmërisë.

- Konsumi i tepërt, grykësia, jeta e luksit e syfaqësia ishin modele të panjohura për brezin e sahabëve.

- U zhvillua koncepti se “stacioni i nesërm i shpirtit do të jetë varri”.

Me pak fjalë i Dërguari i Allahut për njëzet e tre vjet me radhë në detyrën e drejtimit, edukimit e drejtësisë, qe shembulli më i jashtëzakonshëm, personaliteti më i lartë.

Prandaj çdo njeri mund të gjejë në jetën e në Traditën e tij Profetike, shembullin e duhur sa i takon sjelljeve më të bukura e të përkryera.

I Dërguari i Allahut ka shpërndarë shembuj të pashoq për të gjithë njerëzimin, në çdo fazë të jetës deri në Ditën e Gjykimit. Kështu Ai:

Është modeli i liderit fetar. Është shembulli i drejtuesit të shtetit. Është shembulli i atyre që lidhen në dashurinë hyjnore. Është shembulli sesi duhet falënderuar dhe treguar modesti ndaj mirësi-ve të Allahut. Është po ashtu shembull se si duhet duruar dhe dorëzuar caktimit të Allahut edhe në



kohë e vende të vështira. Është shembull i bujarisë dhe mjaftueshmërisë ndaj plaçkës së luftës. Është shembulli i dhembshurisë ndaj anëtarëve të familjes. Është shembull i mëshirës ndaj të pambrojturve, të vetmuarve dhe robërve. Është shembull i faljes dhe tolerancës ndaj gjynahqarëve.

Nëse je i pasur, përkujto modestinë, mjaftueshmërinë dhe bujarinë e atij Pejgamberi që sundoi tërë Arabinë!

Nëse i përket një shtrese të dobët, merr shembull nga jeta e Pejgamberit të shtypur nën udhëheqjen e politeistëve mizorë e të padrejtë të Mekës!

Nëse je një çlirimtar ngadhënjyes, merr mësim nga jeta e Pejgamberit të guximshëm e të nënshtruar ndaj Zotit, i cili doli fitimtar në luftën e Bedrit e të Hunejnit!

Allahu na ruajt, nëse je mposhtur, përkujto Pejgamberin i cili duke lënë pas dore plagën e vet u end me durim e trimëri në mesin e dëshmorëve dhe të plagosurve në luftën e Uhudit.

Nëse je mësues, mendo rreth Pejgamberit që u mësonte urdhrat hyjnorë Sahabëve të Suffes në mesxhid, duke u përcjellur atyre delikatesën e lartësinë e tij shpirtërore.

Nëse je nxënës, imagjino Pejgamberin i cili me mirësjellje, vëmendje e dëshirë të pamatë, ulej pranë melekut Xhebrail për të pranuar (nxënë) shpalljen hyjnore.



Nëse je predikues apo udhërrëfyes besnik, dëgjo Pejgamberin që përhapte urtësi teksa bisedonte me sahabet në Xhaminë e Tij (Xhaminë e Pejgamberit). Dëgjoje zërin e tij të ëmbël dhe falja zemrën!

Nëse kërkon të përhapësh të vërtetën e nuk ke askënd që të të mbështesë e të të ndihmojë, shiko jetën e Pejgamberit i cili edhe pse i privuar nga çdo ndihmë në Mekë, nuk u ndal së deklaruari zullumqarëve vetëm të vërtetën që t'i udhëzonte ata!

Nesë ke ngadhënjyer mbi armikun, nëse ke shkatërruar të pavërtetën e ke shpallur të vërtetën, atëherë kujto Pjegamberin që në ditën e çlirimit të Mekës edhe pse ishte një komandant fitimtar, hyri në atë qytet të bekuar me modesti, i kërrusur mbi devenë e tij, thuajse duke bërë sexhde, e falënderues (ndaj Zotit)!

Nëse zotëron një fermë dhe dëshiron t'i vendosësh punët mbarë, merr shembull nga ai Pejgamber mendjemprehtë i cili pasi u bë pronar i tokave të Beni Nadirit, Hajberit dhe Fedekut, vendosi në krye të tyre persona që ditën t'i përmirësonin e t'i drejtonin popujt në mënyrën më të mirë!

Nëse je njeri i vetmuar, mendo jetimin e Abdullahut dhe Amines, dritën e tyre të syrit, atë të Pafajshmin, Jetimin e ndritur!



Nëse je i ri i formuar, ki kujdes ndaj jetës së atij të riu pejgamber të ardhshëm e që ishte çobani i tufës së xhaxhait të tij Ebu Talibit në Mekë.

Nëse je një tregtar që bën tregti me karvan, mendo gjendjen e atij Personi, më të madhin në mesin e karvaneve të Shamit e Jemenit.

Nëse je një gjyqtar, mendo veprimin e tij të drejtë e largpamës teksa vendosi Gurin e Zi në vendin e duhur në Qabe, duke evituar kacafytjet e parisë së Mekës.

Dhe përsëri hidh vështrimin prapa në histori, e shih atë Pejgamber në Xhaminë e tij në Medine, që gjykonte në mënyrën më të drejtë mes njerëzve, duke mos bërë dallim midis të varfrit të zhytur në skamje e të pasurit në pasuri.

Nëse je bashkëshort, tregohu i kujdesshëm ndaj jetës së pastër të atij njeriu të bekuar, ndaj ndjeshmërisë së thellë e dhembshurisë, si bashkëshort i Hatixhes dhe Aishes.

Nëse je baba, mëso sjelljen e atij Personaliteti të lartë si babai i Fatimes dhe gjyshi i Hasanit e Husejnit.

Me pak fjalë, çfarëdo roli të kesh, e në çfarë gjendje të jesh, do ta gjesh përherë Muhamed Mustafanë ﷺ si udhëheqësin tënd shpirtëror më të përsosur e si udhëzuesin më të mirë.

Sepse edukatori i tij është Allahu i Lartë, e udhëzuesi i tij është Kurani Famëlartë.



Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti? ﴿مَنْ مَعَهُ﴾

Le ta përfundojmë këtë temë me disa vargje të bukura të Mehmed Akif Ersojit:

Ç'ka bota, të gjithë janë prej tij;

Shoqëria dhe individ i janë borxhlinj atij!

Atij të pafajshmit gjithë bota i ka detyrim...

O Zot, na bashko Ditën e Fundit me këtë besim!





Ruajtja e qëndrueshmërisë në fe

Krijuesi i Gjithësisë pyet:

**“Vërtet mendojnë njerëzit,
se do të lihen të thonë “Ne besojmë”,
pa u vënë në provë?!”**

(Ankebut, 2)

Pyetja e Dytë

Një i ri i ndërgjegjshëm, i rritur me edukim dhe frymë fetare, i cili pas shkollimit hidhet në jetë dhe në raporte pune, familjare, shoqërore, herë pas here mund të bëjë lëshime sa i takon disa parimeve islame.

Pikërisht në këto rrethana, si mund të mbahet qëndrueshmëria në fe, si mund të kujdesemi për ruajtjen e ndjeshmërisë dhe parimeve islame? Si i këshilloni të rinjtë?

Së pari:

Zgjidhja e parë sa i takon ruajtjes së qëndrueshmërisë në fe është shoqërimi me besimtarë të drejtë e besnikë.

Krijuesi i Gjithësisë shprehet:

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)!”

(Teube, 119)

Si rezultat i shoqërimit me të mirët, njeriu merr vlera të cilat përmirësojnë nivelin e tij të gjykitimit drejt dhe të sinqeritetit, përmes shkëmbimeve në gjendjet e tyre shpirtërore.

Shejh Sadi thotë:

“Qeni i Banorëve të Shpellës (As’hab-i Kehf), fitoi një nderim të madh duke u përmendur në



Kuran, ngaqë u shoqërua me njerëz të mirë. Ndërsa gratë e Nuhut dhe Lutit përfunduan në Xhehenem si rezultat i bashkimit shpirtëror me të devijuarit”.

Prandaj është shumë e rëndësishme zgjedhja e rrethit, shoqërisë, komshiut, shokut.

Kur një atom shpërbëhet në protone, neutrone dhe elektrone, fillojnë të përhapen disa rrezatime, të cilat mund të jenë pozitive apo negative. Ekzistojnë disa rreze që ne nuk mund t'i shohim si: alfa, beta, gama, ultravjollcë etj., por të gjitha kanë nga një efekt.

Ndërsa rrezatimet më ndikuese janë ato që dalin nga zemra. Ndikimin e dobishëm e quajmë fejk, përrshpirtshmëri; ndërsa të dëmshmin e quajmë gaflet, shkujdesje.

Për këtë arsye Krijuesi i Gjithësisë shprehet:

“...Bëhuni me ata që janë të sinqertë...” (Teube, 119)

“....Mos rri me keqbërësit!” (Enam, 68)

Madje ana shpirtërore shtrin ndikimin e saj edhe në hapësira të caktuara.

Kështu, i Dërguari i Allahut pati qëndruar me sahabët e tij në zonën e Hixhrit, aty ku u shkatërrua populli i Themudit. Sahabët nxorën ujë nga pusi për nevojat e tyre dhe nga ky ujë përgatitën brumë. I Dërguari i Allahut urdhëroi të derdhej ai ujë, brumi i përgatitur me të t'u jepej si ushqim deveve, dhe



sahabet të merrnin ujë vetëm nga pusi ku kishte pirë deveja e Salihut ﷺ. (Buhari, Enbija, 17; Muslim, Zuhd, 40.)

Edhe pse nga ajo kohë kanë kaluar me mijëra vite, akoma sot personat që kalojnë andej nuk e përdorin atë ujë për abdest, si rezultat i mallkimit hyjnor ndaj atij vendi.

Kjo do të thotë që, po aq sa duhet qëndruar larg femohuesit, të devijuarit apo të shkujdesurit, po aq duhet qëndruar larg edhe vendeve ku ka rënë mallkimi hyjnor për shkak të haramit dhe mosbindjes.

Së dyti:

Këshilla e dytë është kujdesi ndaj adhurimeve tona, në mënyrë të veçantë kujdesi ndaj faljes së namazit me përqendrim dhe me xhemat. Sepse Krijuesi i Gjithësisë ka garantuar mbrojtje nga imoraliteti dhe e shëmtuara, pra nga gjynahet e papranueshme sipas fesë e logjikës, nga zvarritja në situata dhe gabime të shëmtuara, nëse namazi falet si me trup ashtu edhe me zemër.¹³

Prandaj, duhet të përpiqemi të jemi fqinj me xhaminë e të afërt me xhematin.

Edhe të parët tanë Osmanët kanë qenë të ndjeshëm ndaj detajeve. Ata ndërtuan komplekse të mëdha në vendet qendrore, ndërsa midis lagjeve ndërtuan xhami të vogla sa një dhomë, në mënyrë që kur nuk kishte energji elektrike, namazi me

13. Ankebut, 45.



xhemat i sabahut, akshamit e jaxisë të mund të falej rregullisht dhe njerëzit të mos privoheshin nga kënaqësia e qetësia e namazit me xhemat.

Provojeni o të rinj: Nëse jeni nisur të shkoni diku sepse keni një punë, mirëpo thërret ezani... Zbrisni nga autobuzi, faleni namazin me xhemat, pastaj vazhdoni rrugën; do ta shihni që punën do ta keni më të lehtë....

Së treti:

Këshillohet që të mos harrohet mësimi i Pejgamberit ﷺ:

*“Jeta e vëtetë është jeta e Ahiretit.”*¹⁴

Nëse arrihet një sukses, duhet kujtuar ky hadith e duhet pasur kujdes nga teprimi. Ndërsa në momentet e vështira nuk duhet rënë në pesimizëm. Asnjëherë nuk duhet të harrojmë që kjo jetë është kalimtare e jeta e Ahiretit është jeta e vërtetë dhe e pafundme. Nuk duhet të harrojmë se si rehatia, ashtu edhe vështirësitë e kësaj jete janë vetëm sprova hyjnore.

Sulejmani عليه السلام kishte pasuri dhe pushtet të jashtëzakonshëm. Por ai e kishte ruajtur zemrën e tij nga tundimi i mirësive të kësaj bote. Ai e falënderonte pafundësisht Zotëruesin e vërtetë të këtyre mirësive. Prandaj dhe fitoi vlerësimin **“robi i mirë”**.¹⁵

14. Buhari, Rikak, 1.

15. Sad, 30.

Nga ana tjetër edhe Ejjubi , i sprovuar me skamje, sëmundje e shumë vështirësi, gjithnjë ishte falënderues dhe asnjëherë nuk ankohej për gjendjen e tij për të cilën ishte i bindur se ishte një sprovë e caktuar nga Allahu. Edhe ai përmes falënderimit dhe nënshtrimit ndaj Zotit, arriti të fitonte vlerësimin **“robi i mirë”**.¹⁶

Prandaj dhe ne si besimtarë, nuk duhet t’u kushtojmë rëndësi kushteve me të cilat jemi sprovuar, por mundësive të arritjes së kënaqësisë së Allahut Fuqiplotë.

Sa bukur shprehet Mevlana:

“Bota jote e brendshme është si një strehë mysafirësh. Gëzimet e hidhërimet hyjnë e dalin. Mos u mashtro nga gëzimet, e as mos u mërzit nga hidhërimet! Mos u mërzit nëse pikëllimet pengojnë lumturinë tënde! Sepse nëse duron pikëllimet sot, ata janë lajmëtarë të gëzimit dhe lumturisë së të ardhmes”.

Kjo botë është jetë e sprovave. Në këtë ajet fisnik Krijuesi i Gjithësisë shprehet:

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?!”

(Ankebut, 2)

Ne duhet t’i mbështetemi mëshirës së Allahut Fuqiplotë, si në pasuri ashtu dhe në skamje.

16. Sad, 44.



Jetën e Ahiretit duhet ta konsiderojmë çështjen parësore të jetës sonë. Nuk duhet të harrojmë kurrë se vdekja, përkohshmëria, fryma e fundit, varri, kiameti, ringjallja, llogaridhënia, peshorja e veprave, ura e Siratit, me pak fjalë Ahireti, është e vërteta më e madhe që i përket të ardhmes sonë.

Në ajetin fisnik Allahu Fuqiplotë shprehet:

“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!” (Muminun, 115)

“Betohem në Ditën e Kiametit! Betohem në shpirtin qortues!” (Kijame, 1-2)

“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?” (Kijame, 36)

“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.”
(Zelzele, 7-8)

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!” (Tekathur, 8)

Ashtu si në ditët e sotme që nëse shkruan një emër në një telefon apo në një aparaturë të vogël, të shfaqen të gjitha të dhënat në lidhje me personin, po ashtu edhe melekët Kiramen Katibin regjistrojnë gjithçka në lidhje me ne. Këto të dhëna dokumentohen në dosjet e përtejme për t’u hapur në Ditën e Llogarisë.



Atë ditë do të thuhet:

“Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!” (Isra, 14)

Do të flasin sytë! Çfarë kanë parë këta sy? Për çfarë t'i ka dhuruar Allahu këto sy, e ti çfarë ke vrotuar me ta?

Allahu përse t'i ka dhënë veshët, ti çfarë ke dëgjuar?

Do të flasë gjuha jote! Çfarë ke shqiptuar? Në ç'masë ke folur pozitivisht e në ç'masë negativisht?

Me pak fjalë, ajo është një ditë e vështirë, për të cilën duhet të përgatitemi që në këtë botë. Prandaj duhet t'i kushtojmë rëndësi adhurimeve. Duhet të përkujtojmë shpesh vdekjen dhe Ahiretin. Nëse mendja dhe zemra jonë thellohen në këtë meditim, do të jetë më e lehtë ta mbrojmë veten nga sfidat e kohës.

Së katërti:

Këshillohet devotshmëria.

Çfarë ka urdhëruar Allahu Fuqiplotë? Si e konkretizoi atë i Dërguari i Allahut? Si jetuan sahabët? Edhe ne pas gati 1400 vitesh duhet të përpiqemi të jetojmë si sahabët e nderuar.

Çfarë është devotshmëria?

Devotshmëria është shmangia me kujdes nga veprat e ndaluara dhe të papëlqyeshme, me ndjenjën e dashurisë dhe frikës ndaj Allahut.



Një ditë Omeri ﷺ e pyeti Ubej ibn Kabin ﷺ se çfarë është devotshmëria: Ubeji tha:

“-O Omer, a ke ecur ndonjëherë në një rrugë me gjemba?”

Omeri ﷺ u përgjigj:

“- Po kam ecur”.

“- Si ke ecur?”- e pyeti përsëri.

“- Kam mbledhur rrobën time dhe kam treguar kujdes që mos të dëmtohem nga gjembat”,- u përgjigj ai.

Pas kësaj Ubej ibn Kabi ﷺ tha:

“- Ja pra, kjo është devotshmëria”.

Pra të jesh i devotshëm do të thotë të mbrohesh me kujdes nga gjembat e haramit dhe gjynahit.

Sot njerëzimi nën ndikimin e televizionit, internetit, shifrave, modës e pushtimit kulturor global, është pllakosur në vorbullën e haramit dhe gjynaheve si trungjet e pemëve që rrëshqasin nga përmbytjet.

Rruga e mbrojtjes ndaj hutimit (të tipit) “shkoj pas turmës”, është mbushja e shpirtit me ndjesinë e frikës së humbjes së kënaqësisë dhe dashurisë së Allahut, pra me ndjenjën e devotshmërisë. Devotshmëria është lartësim i zemrës.

Shfaqja më e bukur e devotshmërisë është largimi nga kufri (mohimi), nifaku (hipokrizia) dhe shirku (idhujtaria), siç largohesh nga zjarri, dhe vrapimi



për të realizuar urdhrat e Krijuesit të Gjithësisë në mënyrën më të plotë.

Në këtë botë, e cila është vendi i sprovave hyjnore, devotshmëria është kujdesi që duhet treguar në çdo hap që hedhim në jetën tonë, njësoj sikur të ishim duke ecur në një zonë të minuar.

Prandaj nuk duhet të harrojmë asnjëherë që Islami nuk është një përjetim stinor, por një jetë e tërë devotshmërie që rregullon çdo frymëmarrje tonën në mënyrë që të ruajmë qëndrueshmërinë në fe.

Po ashtu, duhet të kërkojmë mbrojtjen e Allahut gjatë gjithë jetës që Ai ta ruajë sinqeritetin dhe qëndrueshmërinë tonë në fe.





Përçarja për shkak të ateizmit dhe deizmit

Rumiu thotë:

*“Nëse nuk arrin të nuhasësh
mos e fajëso trëndafilin...!”*

Pyetja e tretë:

Kohët e fundit ndikimi i ateizmit dhe deizmit në botën shpirtërore të brezit të ri ka filluar të shtohet. Cilat janë arsyet kryesore të këtij fenomeni? Cila është këshilla juaj në lidhje me parandalimin e këtij fenomeni dhe si mund të arrihet një besim i pastër?

Në ditët e sotme vendet islame janë pushtuar nga “kultura globale”. Ashtu siç mund të pushtohesh nga armiku, mund të pushtohesh edhe nga kultura. Reklamat cytëse të egos, moda nxitëse e luksit dhe e shpërdorimit, programet e kota televizive, rrugët e papërshtatshme të internetit, thirrjet dhe propagandat negative, sjellin me vete një erozion të jashtëzakonshëm shpirtëror. Dita - ditës bota mendore dhe shpirtërore e njerëzve po trazohet.

Qëllimi dhe mjeti po përzihen. Jeta po merr kuptimin e kënaqësisë që buron vetëm prej ngrënies dhe pirjes. Zemrat po robërohen nga bota, shpirtrat po i dorëzohen dëshirave egoiste. Pangopësia e shpirtit po e zvarrit njerëzimin në kriza individuale dhe shoqërore.

Njerëzve po u injektohet një botëkuptim pa Ahiret, larg shqetësimit për Botën e Ardhshme. Me propagandën e Perëndimit materialist që kërkon të armiqësojë botën islame ndaj vlerave autentike, njerëzit hap pas hapi po largohen nga feja dhe po zvarriten në kriza shpirtërore. Dhe për fat të keq Islami nuk njihet ashtu siç duhet.



Dua t'ju përcjell një histori që ka ndodhur në Stamboll pak a shumë para njëzet-tridhjetë vitesh:

Sekretari i Partisë Komuniste të Francës, Rozher Garaudi (Roger Garaudy) kishte ardhur në Stamboll. Po jepte një konferencë në Jëlldëz Saraj (Yıldız Saray), e cila zhvillohej me pyetje-përgjigje.

E pyetën:

“- Ju, një herë e një kohë ishit komunist. Madje një komunist që mund të përmbliidhte në një libër nga fillimi deri në fund të gjitha mendimet e Marksit. Ndërsa tani jeni bërë mysliman. Ishit një i krishterë katolik, ishit një komunist dhe përse tani jeni një mysliman?”

Ai u përgjigj:

“- Unë isha katolik. Shkova në Amerikë për shkollim. Atë kohë trustet dhe kartelet¹⁷ nuk e di sa ton grurë digjnin e sa ton qumësht derdhnin. Gjithë këtë e bënin me qëllim monopolizimin. U revoltova së brendshmi ndaj kësaj mizorie dhe brutalizmi. Kjo revoltë më zvarriti drejt komunizmit.

Pashë që edhe komunizmi ndërtonte ndërgjegje pa shpirt. Prandaj mendova të ndërtoj një urë me katolicizmin, e kështu t'i jap shpirt komunizmit, por as kjo nuk ndodhi dot. Mbete ashtu bosh.

Pastaj u dënova me “ekzekutim”. (Nuk e tregon arsyen pse.) Një ushtar e mbylli njërin sy dhe më la të ikja.

17. Bashkim monopolist i disa ndërmarrjeve të mëdha kapitaliste, që krijohen me qëllim të përqendrimit të kapitalit.



Ngaqë isha sociolog u bëra kureshtar përse ky ushtar më la të ikja. Shkova dhe e gjeta:

«- Përse më le të ikja ndërkohë që për mua kishte dalë urdhri për ekzekutim?»

Ai u përgjigj:

«- Unë jam mysliman, nuk e di se çfarë ke bërë. Nuk e di përse donin të të vrisnin. Nuk desha të bëhem vegël e tyre, për këtë arsye mbylla njërin sy dhe ti ike».

Deri në atë kohë unë e pandehja islamin si fe fisesh. U bëra kureshtar. Ngaqë isha edhe ekonomist së pari fillova nga ekonomia:

Çfarë është kamata? Në komunizëm kamata është e ndaluar. Është një sistem shfrytëzimi. Çfarë është kamata në Islam? Më shtyu kureshtja.

(Përsëriti tekstualisht këtë shprehje duke nënkuptuar Bilalin ﴿﴾)

Më qetësoi një ndodhi e Bilalit. Bilali i dërgoi një hurmë Pejgamberit ﴿﴾. I Dërguari i Allahut e vërejti hurmën dhe e pyeti:

«-Bilal, nga e ke marrë këtë hurmë?»

Ai u përgjigj:

«-Ne kishim hurma të rëndomtë. Dhamë dy masa prej tyre për të marrë një masë hurma të mirë në mënyrë që të hante i Dërguari i Allahut».

Pas kësaj i Dërguari i Allahut tha:

«-Mos! Kjo është vetë kamata. Kujdes mos veproni kështu». Pastaj tregoi një rrugë:



«Nëse dëshiron të marrësh hurma të mirë, shiti ato që ke në dorë, pastaj me ato para bli hurmat e mirë.»¹⁸

Pashë që i Dërguari i Allahut nuk bënte asnjë kompromis në çështjen e kamatës. Kjo ngjarje më bëri të hulumtoj në lidhje me Islamin.

U përballa me drejtësinë e jashtëzakonshme të Ebu Hanifes. Kjo më qetësoi dhe më orientoi.

Por sot dëshiroj të them që, për fat të keq bota islame nuk e njeh kolosin e madh Ebu Hanifen. Unë po ua mësoj të tjerëve drejtësinë e Ebu Hanifes edhe pse sapo kam përqaftuar Islamin.

Ju jeni të shëndoshë, por mendoni se jeni të sëmurë. Ju imitoni një Perëndim të sëmurë. A mundet një njeri i shëndoshë të shkojë pas një të sëmuri?”

Kjo do të thotë që së pari duhet të jemi të vetëdijshëm për vlerat tona. Duhet t’ia dimë vlerën gjërave tona të shenjta. Në të kundërt, nuk do jemi ndryshe nga të mjerët që vdesin të uritur edhe pse lundrojnë mbi thesare!

Vërtet, sot bota e perëndimit është e sëmurë sepse mbështetet mbi interesin, pragmatizmin... Krishtërimi nuk e ngop shpirtin sepse së brendshmi është i zbrazët. Goditjen e parë krishtërimi e mori nga Pali. Ai hoqi ligjin hyjnor, duke thënë:

18. Muslim, Musabakat, 96.



“- Ju besoni në Atin, Birin dhe Shpirtin e shenjtë, pra në trinitet, lëreni pjesën tjetër. Pjesa tjetër e ligjeve të Teuratit nuk vlen më për ju. Nxjerrja e ligjeve tashmë i përket Çezarit”.

Pra, jetoni të qetë si të dëshironi. Ai tha që edhe ligjet e kësaj bote do të vendosen nga mbretërit. Mbretërve kjo u shkoi për shtat. Më pas u mbledhën një pas një koncilet, të cilët e përcaktuan edhe sistemin e ri besimor të krishtërimit. Kjo do të thotë që ky sistem i ri besimi u përcaktua nga vetë njerëzit.

Në Koncilin e Nikeas (Iznik) të mbledhur në vitin 325 u mor vendimi që Krishti është Zot.

Në Koncilin e Stambollit të mbledhur në vitin 381 u mor vendimi që Shpirti i Shenjtë është Zot.

Në Koncilin e Efesit të mbledhur në vitin 431 Merjemit iu dha epiteti “lindëse e Zotit”. Isait iu mveshën edhe natyra njerëzore edhe natyra hyjnore.

Në Koncilin e Kalcedonisë (Kadıköy) të mbledhur në vitin 451, Kishat e Lindjes (Koptët e Egjiptit, Armenët, Surjanitë, Etiopianët) të cilat mbronin tezën që Isai kishte vetëm natyrë hyjnore, u konsideruan të devijuara.

Në Koncilin e Dytë të Nikeas të mbledhur në vitin 787, u mor vendimi që adhurimi i ikonave nuk është mëkat. Ndërkohë që për afro 200 vite më parë ishte diskutuar çështja e adhurimit të ikonave, madje disa perandorë kishin ndaluar adhurimin e tyre.



Të krishterët Ortodoks pranojnë 7 koncilet e para. Ndërsa të krishterët katolikë pranojnë gjithsej 21 koncile, ndër të cilët edhe të fundit të vitit 1965. Në koncilin e fundit të Vatikanit Katolik është bërë thirrje për “dialog” ndërjetar.

Me pak fjalë, sistemi besimor i Krishtëritimit të sotëm është përcaktuar nga koncilet. Është ngritur një sistem hyjnor që boshatishi fenë. Kisha solli metodën e pastrimit të mëkateve si rrjedhojë e përfitimeve. Një qenie njerëzore filloi të pastrojë nga gjynahet një qenie tjetër njerëzore.

Me këtë rast dëshiroj t’ju përcjell një kujtim që e kam dëgjuar nga Nexhip Fazëll Kësakyrëk (Necip Fazıl Kısakürek):

Tojnbi (Toynbee) shkoi në Egjipt. Ngaqë ishte sociolog, iu afrua një lypësi të gjorë dhe e pyeti:

“- Çfarë bën nëse të jap para?”

Lypësi u përgjigj:

“- I lutem Allahut për ty”.

“- Mirë, a e pranon Allahu duanë tënde?”-, e pyet Tojnbi.

Lypësi përgjigjet:

“- Zotëri, unë i lutem Atij, e pastaj nuk i përzi-hem. Nëse Ai dëshiron e pranon lutjen time, në të kundërt, nuk e pranon.”

Pas kësaj Tojnbi tha:

“- Klerikët tanë të shkolluar thonë se i pastrojnë



njerëzit nga gjynahet duke qenë edhe ata vetë qenie njerëzore. Ndërsa këtu një njeri i gjorë i kësaj feje thotë: «Nëse Allahu dëshiron e pranon lutjen time, në të kundërt, nuk e pranon».

Ja pra, Krishtërimi i devijuar i ditëve të sotme ka marrë një formë ku ekzistojnë disa praktika absurde. Në anën tjetër, kjo formë është tërheqëse për shumë syresh, nisur nga fakti se ofron mundësi për të jetuar lehtësisht një jetë epshore.

Pyeta një misionar të vjetër që kishte përqaftuar Islamin:

“- Sot bota e brendshme e Krishtëritimit është boshatisur, kishat po shiten. Qasjet drejt Islamit janë të dukshme, por si është e mundur që njerëzit nuk e pranojnë masivisht atë (Islamin)?”

Ai u përgjigj:

“- Islami është i vështirë. Krishtërimi është boshatisur, çdo gjë është e lejuar. Një mysliman duhet të falet pesë herë në ditë, po ashtu në Islam ka agjërim, zekat, bamirësi, dispozita morale, tregtare, ligjore. Asnjë nga këta nuk i ke në Krishtërim”.

Për këtë arsye ky boshllëk ka krijuar në shpirtin e njeriut një lloj pakënaqësie. Në momentin kur njerëzit filluan të gjenin disa anomali në Krishtërim, atëherë shkuan drejt ateizmit. Në mënyrë të veçantë sot në Europë ateizmi po përhapet shumë.

Në të vërtetë, ateizmi nuk ka asnjë anë logjike. Domethënë, si mund të ekzistojë vetvetiu gjithësia?



Si mund të burojë vetvetiu ajo dritë? Asgjë nuk ekziston vetvetiu...

Ateizmi, pra mosbesimi, është jologjik për cilindo që zotëron mendje dhe zemër të shëndoshë. Ngjan si mosfunksionim i mendjes apo venitje e zemrës. Sepse çdo gjë që funksionon në mënyrë perfekte në gjithësi, përfshirë këtu edhe ekuilibrin ekologjik që mban gjallë jetën, është një garanci e qartë për njeriun se e gjithë kjo nuk mund të jetë një produkt i verbër i rastësisë. Për këtë arsye urdhri i parë i Krijuesit të Gjithësisë në Kuranin Famëlartë është:

“Lexo me emrin e Zotit tënd që krijoj...” (Alak, 1)

Pra mos e shih jetën me sy të zbrazët! Asgjë nuk është krijuar pa një qëllim...

Krijuesi i Gjithësisë, çdo gjë në tokë dhe në qiell, tek njeriu dhe vetë bota, e ka dhuruar si shenjë për ekzistencën, njësimin dhe fuqinë e Tij, si një thirrje për meditim.

Zemrat që shohin, dëgjojnë dhe ndjejnë, nuk mund të shohin gjë tjetër vetëm se manifestimet e fuqisë dhe madhësisë hyjnore.

Megjithatë:

Ç’keqardhje për ata njerëz të hutuar ndaj shfaqjeve të emrave dhe cilësive hyjnore “el-Bari” (Shpikësi) dhe “el-Musavvir” (Formuesi); për ata zemra të vrazhda që nuk kuptojnë dot nga gjuha e heshtur e erërave, përrenjve dhe dallgëve!



Gjendja e zemrave të verbra ndaj shfaqjeve të madhështisë hyjnore është thuajse e njëjtë me gjendjen e fatkeqëve që vdesin të uritur mbi thesare...

Shkaku i prirjes së botës, e veçanërisht i brezit të ri, drejt mohimit të Zotit duhet kërkuar në propagandat negative. (Për ndryshe) Maturiditë, dijetarët e medhhebit tonë në çështjet e akides thonë:

“Sikur një personi të mos i ketë arritur as edhe një libër apo pejgamber, ai duhet të pranojë së paku ekzistencën e Allahut.”

Pra gjithësia është një vend meditimi, një laborator besimi. Të mos besosh do të thotë të anulosh kapacitetin mendor, të jesh budalla, të kesh një zemër të verbër.

Shiko këtë lule se si mbin nga një dhé e zezë? Sa ngjyruet apo sa dekorues punojnë për të? Kujt ia fal Krijuesi i Gjithësisë këtë lule? Përse nuk ka shfaqje të tilla në planete apo yje ku nuk gjenden njerëzit?

Çdo krijesë është argument për ekzistencën e Krijuesit të Gjithësisë. Natyrisht për ata që kuptojnë. Ndërsa për të shkujdesurit çdo gjë është shkak hutimi.

Për këtë arsye një i ditur shprehet:

“Ky univers është një mundësi për të mençurit që të vrojtojnë krijimin hyjnor me urtësi, ndërsa për budallenjtë është thjesht vendi i ushqimit dhe epshit.”



Shejh Sadi Shirazi thotë:

“Për të mençurit çdo gjethë e pemëve është një kryevepër në njohjen e Allahut me zemër, është një libër i detajuar. Ndërsa për të shkujdesurit (hutuarit), të gjitha pemët nuk përbëjnë as edhe një gjethë të vetme”.

Allahu Fuqiplotë ka krijuar gjithçka me një rend të përsosur. Kur vrojtojmë gjithësinë vëmë re një përsosmëri nga grimca më e vogël deri tek galaktikat. Pra, në çdo gjë ka një rend hyjnor, një sistem hyjnor që tërheq vëmendjen.

Këtë pohim mund ta ilustrojmë me disa shembuj:

Katër elementet (Anasir-i erbaa), d.m.th., zjarri, ajri, uji dhe toka, asnjëri prej tyre nuk kalon kufirin e tjetrit.

Për shembull, shtresa e magmës në tokë është një oqean i jashtëzakonshëm zjarri. Ndërsa dielli sipër nesh, një top i pamasë flake. Asnjëri prej tyre nuk prek në kufirin e tjetrit. Në mesin e këtyre dy zjarreve, Krijuesi ynë na fal ne robërve të Tij një jetë të qetë e të freskët.

Allahu Fuqiplotë thotë:

“Dielli dhe Hëna ndjekin rrugën e caktuar.”

(Rahman, 5)

Nëse largësia midis diellit dhe tokës do të ishte pak më e madhe, vendet do të ktheheshin në pole. Nëse largësia ekzistuese do ishte më e vogël, atëherë çdo gjë do të merrte flakë.



Gjithashtu nëse rreth boshtit të tokës nuk do ekzistonte një pjerrësi prej 23.5 gradësh, nuk do ishin shfaqur stinët. Në këtë rast në disa vende do ishte gjithnjë verë e në disa të tjera gjithnjë dimër.

Sikur shpejtësia e rrotullimit të tokës rreth vetes do ishte pak më e vogël, ndryshimet e temperaturës midis natës dhe ditës do të ishin tepër të mëdha. Sikur kjo shpejtësi të ishte pak më e madhe erërat e atmosferës do të arrinin shpejtësi shumë të madhe e kështu stuhitë dhe përmytjet do ta bënë jetën të pamundur.

Nëse korja e tokës do ishte pak më e trashë nuk do gjendej oksigjeni, burimi i pazëvendësueshëm i jetës së gjallesave. Korja e trashë e tokës do përthithte oksigjenin duke e bërë të pamundur jetën.

Edhe detet po ashtu. Nëse detet do ishin edhe më të thellë se ç'janë sot, ujërat e tepërt do thithnin dioksidin e karbonit dhe oksigjenin, duke e bërë të pamundur jetën në tokë, madje edhe bimët nuk do mund të rriteshin.

Nëse shtresa e atmosferës rreth tokës do ishte pak më e hollë, meteorët do godisnin çdo ditë sipërfaqen e saj.

Si do të ishte e mundur vazhdimësia e jetës sikur të ndryshonte raporti i ajrit prej 78% azot dhe 21% oksigjen? A mendojmë ndonjëherë rreth kësaj?

Në lidhje më këtë po ju përcjell një kujtim:

Një ditë po kthehesha nga Medina. Në avion erdhën stjuardesat dhe thanë:



“-Ju qenkeni hoxhë”.

“- Jo, ashtu thonë”,-iu përgjigja.

“- Më thanë: Na jepni ndonjë këshillë”.

“- Ju udhëtoni shpesh me avion. Oksigjeni në lartësi është i paktë, ndërsa këtu në avion është aq sa në tokë. Për të arritur këtë mundësi, punojnë disa mekanizma të caktuar në mënyrë të vazhdueshme. Thoni që kur ka avari do ju sillen maskat e oksigjenit.

Po kur ndodheni në sipërfaqen e tokës a mund të thotë dikush se nesër 21% e ajrit me oksigjen apo 78% me azot mund të ndryshojë prandaj dilni me maska oksigjeni?! Edhe atesisti nuk ka rrugë tjetër përveçse t'i dorëzohet rendit hyjnor edhe pse verbëria e zemrës bëhet pengesë për besimin në Zot...”, - u thashë.

Me të vërtetë që edhe ateisti, sado që të mohojë, jeton në paqe vetëm në saje të nënshtimit ndaj rendit hyjnor në univers. Çdokush mbështetet në fuqinë hyjnore për të vazhduar jetën. Por vetëm një natyrë e pastër mund ta pranojë Zotëruesin e asaj fuqie.

Uji, H_2O , përbëhet nga 2 molekula hidrogjen dhe 1 oksigjen. Njëri është element ndezës dhe tjetri i ndezshëm. Nëse oksigjeni dhe hidrogjeni do të lireshin të lirë, çdo gjë do përzihej dhe jeta do të ishte e pamundur. Kjo është një tjetër shprehje e artit dhe fuqisë së Krijuesit të Gjithësisë i Cili lidh



së bashku ndezësin dhe të ndezshmin, pra ujin e bën burim jete për çdo gjë të gjallë.

Uji kur ndotet ngrihet lart në qiell, pastrohet në formën më të mirë dhe zbret përsëri si mëshirë në sipërfaqen e tokës.

Një peshk që jeton me oksigjenin e ujit, nëse del mbi ujë vdes. Në të vërtetë oksigjeni i ajrit është më i shumtë se i ujit...

Toka e ruan prodhimin e saj. Po sikur të mos e ruante?

Çdo lule çel në stinën e vet. Çdo frut dhe perime prodhohet në sezonin e vet, sikur të komandoheshin nga një kompjuter.

Çdo gjë ekziston brenda kufirit të vet. Çdo gjë jeton sipas një rendi hyjnor. Gjithçka qëndron në një ekuilibër të jashtëzakonshëm ekologjik...

Pandehja e njeriut se është krijuar pa ndonjë qëllim si krijesat e tjera dhe përpjekja për ta jetuar jetën në mënyrë të papërgjegjshme përballë këtij rendi të jashtëzakonshëm të universit dhe këtij ekuilibri të imtë dhe delikat, nuk është gjë tjetër vetëm se një rrënim i errët i zemrës.

Me një fjalë, për çdo gjë në këtë gjithësi është vendosur një rend ekzakt. Sikur të kishte një devijim nga ky rend, kjo harmoni do të ishte prishur menjëherë.

Krijuesi i Gjithësisë e ka vendosur këtë rend në shërbim të njerëzimit. Në ajetin fisnik thuhet:



“Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej dhe në Tokë, të gjitha janë prej Tij. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë.” (Xhathije, 13. Po ashtu shih: Lukman, 20)

“Ai ka krijuar shtatë qiej njërin mbi tjetrin. Nuk mund të gjesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë ceni. Hidhe vështrimin: a sheh ndonjë plasaritje? Pastaj hidhe sërish vështrimin; sytë e tu do të kthehen të lodhur e të molisur.” (Mulk, 3-4)

“Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë balancën (për çdo gjë), që ju të mos e shkelni atë.” (Rahman, 7-8)

Edhe në portretin e njeriut bie në sy ky rend hyjnor:

Le të hedhë vështrimin njeriu tek vetvetja. A sheh ndonjë mangësi? A ka ndonjë kockë të tepërt në trup? Po ndonjë mangët?

Për çfarë ke nevojë? Ke nevojë për dy këmbë, Krijuesi i Gjithësisë t'i ka falur. Të nevojiten dy krahë, t'i ka falur. Ku do të vendosen sytë, veshët? Në kokë. Jo në një vend tjetër, jo në një pozicion tjetër.

Nëse njeriu do të kishte vetëm një këmbë, ai nuk do mund të ecte, ose nëse njëra këmbë do ishte më e gjatë se tjetra nuk do mund të lëvizte me lehtësi. Nëse do të kishte vetëm një krah, nuk do mund të punonte siç duhet. Syri, veshi, gjuha, çdonjëra prej tyre janë në një rend më vete. Nëse njëra prej



tyre do mungonte, harmonia dhe ekuilibri i trupit do të prishej.

Nëse sot do të na thuhej “Ma jep njërin sy në këmbim të botës!” Kush do ta jepte?!

Çdo qelizë ndodhet në atë organ ku është programuar të kryejë misionin e vet. Kur njeriu ndodhet ende në formën e gjakut të ngjizur, çdo qelizë vrapon të kryejë misionin e përcaktuar në organin përkatës sikur t’i ishte dhënë një sinjal. Qeliza e syrit nuk vrapon për tek zemra. Qeliza e zembrës nuk është e përfshirë në mëlçi. Shëndeti dhe ekuilibri i organizmit janë të lidhura direkt me harmoninë e të gjitha organeve.

Me pak fjalë, i gjithë universi është një manifestim i fuqisë dhe madhësisë së Krijuesit të Gjithësisë. Ai e ka krijuar universin në mënyrë që njeriu ta kuptojë. Mjafton që njeriu të shohë me zemër, të nxjerrë mësim, të meditojë, të jetë i devotshëm...

Besimtari duhet të jetë mbartës i kësaj harmonie hyjnore duke treguar hijeshi në adhurim, moral dhe në raportet njerëzore.

Krijuesi i Gjithësisë shprehet:

“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!” (Muminun, 115)

Çdo gjë e gjallë është krijuar për njeriun. Vetë njeriu është krijuar që të adhurojë Allahun. Përndryshe krijimi nuk do të kishte kuptim.



Të mos besosh ndërsa je i vetëdijshtë ndaj kësaj madhështie hyjnore, nuk është gjë tjetër veçse një verbërim i zemrës. Është e pamundur ta mohosh Zotin, sepse çdo gjë dëshmon ekzistencën e Tij.

Krijuesi i Gjithësisë i pyet të hutuarit me mentalitet ateisti, me një metodë imponuese:

“A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo mos janë ata krijues të vetvetes?!” (Tur, 35)

Krijuesi i Gjithësisë pyet: A ka diçka që është krijuar vetvetiu?

Prandaj dhe shkaku më i rëndësishëm i ateizmit dhe rënies në mosbesim është shoqërimi me jobesimtarët dhe të devijuarit. Shoqërimi me to me kalimin e kohës i hap rrugën ngjashmërisë në botëkuptim dhe në ndjenja.

I Dërguari i Allahut ﷺ, kur po kalonte me sahabet e tij nga gërmadhat shumëshekullore të popullit të Themudit, u tërhoqi atyre vëmendjen duke u thënë:

*“Kaloni me shpejtësi dhe me keqardhje këtu, mos mbushni ujë, edhe nëse e keni mbushur, derdheni!”*¹⁹

Le të mendojmë pak për gjendjen e njerëzve tanë të cilët sot nga mëngjesi në mbrëmje përballen me propagandat e jobesimtarëve në ekrane, telefona apo programe televizive.

19. Buhari, Salat, 53, Enbija, 17, Tefsir 15/2; Muslim, Zuhd, 38-39.



Nëse braktisim edukimin, mësimin, kumtimin, nëse nuk punojmë aq sa duhet për *“emrin bil maruf nehji anil munker”* (urdhërimi për mirë dhe ndalesa nga e keqja), fëmijët tanë do të kthehen në pasardhës të të tjerëve.

Në një ajet thuhet se shejtani do të bëhet ortak në pasuri dhe fëmijë.²⁰

Nuk ka ndonjë kuptim të jesh thjesht prindi biologjik i fëmijës. Nëse djalli e ushqen me gji fëmijën dhe jobesimtarët e rrisin, atëherë fëmija bëhet biri i tyre.

Duhet të bëjmë shumë kujdes në këtë çështje.



Si rezultat i trishtë i mungesës së një edukimi të duhur islam, sot përballemi edhe me problemin e Deizmit. Sipas kësaj teze, Zoti ekziston – sepse nuk ka sesi të mohohet- por ashtu sikurse Ai krijoi bimët e bagëtitë dhe nuk i ngarkoi me detyrën e adhurimit, edhe njeriu është i tillë, pra pa përgjegjshmëri, pa ndonjë detyrim.

Ndërsa Krijuesi i Gjithësisë në Kuranin Famëlartë vazhdimisht tërheq vërejtjen duke thënë:

“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?” (Kijame, 36)

“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t’u zbavitur!” (Duhan, 38; Enbija, 16)

20. Isra, 64.



Deizmi është një sëmundje më vete. Patëm thënë që të mohosh Krijuesin e Lartë është marrëzi. Deisti sipas tij nuk mohon Krijuesin, por refuzon të qenët e Tij Zot, thënë ndryshe nuk pranon rendin hyjnor që Ai ka urdhëruar, refuzon Librin, Pejgamberin dhe dispozitat fetare. Atëherë ç'ndryshim ka midis njeriut dhe krijesave të tjera?

Për fat të keq diskutimet që sjellin pështjellime në kokat e njerëzve në lidhje me fenë, sunetin, medh'hebin dhe dispozitat fetare, si dhe injoranca e shoqërisë sonë sa i takon mësimave fetare, po përgatisin terrenin për këto përçarje.

Për ta përcjellë Islamin me të gjitha vlerat e tij, nevojitet një përgatitje serioze. Për këtë nuk mjafton një kurs veror. Po ashtu nuk mjaftojnë as medresetë me kurrikulat dhe kushtet aktuale.

Të Dërguarit të Allahut iu deshën 23 vjet për t'ua mësuar Islamin sahabëve. Kjo kulturë u plotësua në 23 vjet. Kjo do të thotë që Islami duhet përjetuar si një mësim i pandërprerë që zgjat gjithë jetën. Po ashtu ky mësim duhet të kërkohet pranë njerëzve të devotshëm dhe hoxhallarëve të denjë.

Të pandehësh si të mjaftueshëm frekuentimin e kurseve verore të xhamisë apo marrjen e kulturës fetare përmes një ore në kurrikulën e shkollës, do të thotë të nënvlerësosh edukimin fetar. Njerëzit që kanë marrë një formim të tillë bien në dyshime kur përballen me debate televizive. Kur dëshirat



e pakontrolluara të egos ndezin më tej dyshimet, njeriu përhumbet në mosbesim.

Në ditët e sotme këndvështrimet e prapambetura të huazuara nga të tjerët po përhapen kudo. Por nuk ka vend për pesimizëm! Zgjidhja është kumtimi i fesë duke u frymëzuar nga i Dërguari i Allahut dhe shokët e tij. Çdo njeri duhet të përpiqet me aq sa ka mundësi. Nuk ka asnjë justifikim për të qëndruar indiferent ndaj thirrjes Islame për cilindo që ka njohuri të mjaftueshme në kumtimin dhe predikimin e fesë.

Të ndodhur në një situatë ku shoqëria ka nevojë për mësimet e fesë, nëse kurset e Kuranit nuk mbushen do të thotë që ne nuk po punojmë ende mjaftueshëm.

Prandaj në këtë shkollë të jetës:

✓ Duhet t'u përkujtojmë njerëzve në mënyrë të vazhdueshme se jeta e vërtetë është jeta e përtejme.

✓ Duhet t'u tregojmë se për çdo vepër do jepet llogari.

✓ Duhet t'u tregojmë se qëllimi i krijimit tonë është njohja e Zotit dhe adhurimi i Tij.

✓ Gjatë gjithë jetës duhet të punojmë për fenë e Allahut, duhet t'i shërbejmë asaj. Nëse punojmë për të fituar kënaqësinë e Allahut, Ai na premtonte se do të na ndihmojë dhe do të na i forcojë këmbët në rrugën e drejtë.²¹

21. Muhammed, 7.





Suneti është praktikimi në jetë i Kuranit

Krijuesi i Gjithësisë thotë:

**“Kush i bindet të Dërguarit,
i është bindur Allahut.”** (Nisa, 80)

Pyetja e Katërt

Në ditët e sotme, të mjaftuarit vetëm me Kuran për të kuptuar dhe jetuar Islamin duke përdorur shprehje të tilla si: “Ne na mjafton Kurani”, po bëhen ndikuese në disa qarqe.

Ç’mendoni në lidhje me rëndësinë e Hadithit dhe Sunetit?

Ashtu sikurse Krishtërimi u boshatis së brendshmi nga Pali dhe më pas Dëshmitarët e Jehovahit anuluan çdo dispozitë fetare, në të njëjtën mënyrë disa qarqe të panjohura dhe të padukshme po përpiqen ta zvarrisin gjendjen në këtë drejtim. Qëllimi është boshatisja e fesë! Ashtu si Krishtërimi tashmë është kthyer në një simbol pa qenë më një fe, në të njëjtën mënyrë duan që edhe Islami të shndërrohet në atë gjendje.

Ahmed ibn Hanbeli rahimë Allai e ka bërë të qartë vendin e Sunetit në fe duke kujtuar se në 33 ajete kuranore përsëritet bindja ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Periudha 23 vjeçare e jetës së Pejgamberit rahimë Allai ishte një lloj komentimi i Kuranit Famëlartë. Nga Suneti i tij kemi mësuar namazin, agjërimin, të gjithë adhurimet, raportet shoqërore, ligjet. Si mund të jetohet një jetë pa të?

Krijuesi i Gjithësisë shprehet:

مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ



“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut.” (Nisa, 80)

Ajeti i mëposhtëm e shpreh bukur kuptimin e fjalëve të Pejgamberit ﷺ:

“Ai nuk flet sipas dëshirës, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij.”
(Nexhm, 3-4)

Si fjala, ashtu edhe kuptimi i Kuranit Famëlartë është nga Allahu. Ndërsa Hadithet profetike, mënyrën e të shprehurit e kanë nga Profeti ﷺ kurse kuptimin nga Krijuesi i Gjithësisë.

Aliu ﷺ thotë:

“E pamë të Dërguarin e Allahut të ngrihej në këmbë, u ngritëm edhe ne; e pamë të ulej, u ulëm edhe ne.” (Ahmed, I, 83.)

Sahabët e nderuar e dinin shumë mirë se i Dërguari i Allahut vepronte vetëm sipas dëshirës së Tij (të Allahut). Mësuesi dhe edukuesi i tij ishte vetëm Allahu i Lartësuar. Ai nuk fliste sipas dëshirës, por predikonte shpalljen hyjnore.

Në mënyrë të veçantë ajeti i mëposhtëm shpreh qartazi që krahas Allahut Fuqiplotë, edhe i Dërguari i Tij është i autorizuar të vendosë dispozita fetare:

“...Ai do t'i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t'i ndalojë nga të këqijat; do t'ua lejojë të mirat e do t'ua ndalojë të këqijat...”

(Araf, 157; Teube, 29)



Po ashtu:

“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.”

(Hashr, 7)

“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet!” (Al-i Imran, 31)

Kurani dhe Suneti janë dy baza të pandashme nga njëra tjetra. Sjelljet dhe veprat e Pejgamberit janë një koment i Kuranit Famëlartë. Si rrjedhojë edhe ne në ditët e sotme duhet të jemi shumë vigjilentë ndaj grupimeve të cilët po përpiqen ta zhvlerësojnë Traditën Profetike, e cila është një koment i gjallë i Kuranit Famëlartë, duke thënë se “Na mjafton neve Kurani “.

Ejjub es-Sahtijani, një ndër dijetarët e fikhut dhe hadithit, i kohës së tabiinëve thotë:

“Kur t’i flisni një personi në lidhje me Sunetin dhe ai ju përgjigjet: «Lëri këto, na mjafton ne Kurani», ta dini se ka devijuar për vete dhe po çorienton edhe të tjerët.”²²

Edhe Imam Evzai, dijetari i gjeneratës së tabei tabiinëve, thotë:

“Suneti ka të drejtën e vendosjes së dispozitave në bazë të Kuranit”.

22. Hakim, Ma’rifetu Ulumi’l-Hadith, fq. 65; Hatib el-Bagdadi, el-Kifaje fi Ilmi’r-Rivaje, fq.16.



Kurani Famëlatë është zbritur në zemrën e Krenarisë së Gjithësisë ﷻ. Në ajetin fisnik thuhet:

“Nuk ka dyshim se ky (Kuran) është Shpallja e Zotit të botëve. Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed) që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe.” (Shuara, 192-195)

Komentuesi i parë dhe më i saktë i Kuranit Famëllartë është vetë i Dërguari i Allahut ﷺ. Në ajetin fisnik thuhet:

“...Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kuranin), me qëllim që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë.” (Nahl, 44)

Kurani Kerim është komentuar me jetën 23 vjeçare profetike. Prandaj është e pamundur të kuptohet dhe të jetohet Kurani pa u bërë pjesë e botës së brendshme të Pejgamberit, pa u edukuar me moralin e tij, pa ndjekur traditën e tij.

Kështu, të gjitha detajet e adhurimeve bazë të Islamit, si: namazi, agjërimi, zeqati, dhe haxhi, janë përcaktuar në praktikën e vetë Pejgamberit ﷺ. Në Kuranin Fisnik nuk janë përcaktuar çështje të tilla, si: kohët e namazit, rekatet, shtyllat e namazit, apo gjërat që e prishin namazin; të gjithë këto çështje zënë vend në Sunetin e Pejgamberit ﷺ (Traditën Profetike).

Në Kuran nuk përcaktohet si, sa dhe në çfarë



kushtesh dhe në çfarë sasje do të jepet zeqati. Të gjitha këto ne i kemi mësuar nga Pejgamberi ﷺ.

Me të vërtetë, nuk mund të mësohet si të vihet në praktikë Kurani pa u njohur me Traditën Profetike. Për shembull sipas Kuranit Fisnik është e ndaluar (haram) të hahet coftina. Por ne konsumojmë peshkun që ka ngordhur vetvetiu pas peshkimit. Ne mësojmë se sipas Traditës Profetike peshku përbën një përjashtim.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet për namazin e Xhumasë. Por kur e si do falet, e mësojmë nga Tradita Profetike.

Prandaj kuptohet që qëllimi i fshehtë i atyre që nënvlerësojnë Traditën Profetike, është heqja e dispozitave fetare.

Nuk ka dyshim që sahabët e nderuar e shihnin Traditën Profetike si një burim bazik të fesë.

Tregohet se në kohën e kalifatit të Osmanit ﷺ, një person shkon tek Imran ibn Husejni ﷺ, kadiu i Basrës, dhe i thotë:

“- Ju na tregoni disa hadithe, por ne nuk arrijmë ta gjejmë burimin e tyre në Kuran”.

Imrani ﷺ shprehet:

“- A ju tregohet në Kuran se për çdo 40 dirhem jepet 1 dirhem zekat, se për aq dele jepen kaq dele apo se për aq deve jepen kaq deve?”

Personi përgjigjet:



“-Jo.”

Imrani ﷺ e pyet:

“-Po nga i mësuar gjithë këto rregulla? I mësuar nga ne. Ndërsa ne i mësuar nga i Dërguari i Allahut». Dhe i përmend edhe shembuj të tillë të ngjashëm.²³

Vetë i Dërguari i Allahut u ka paraprirë me këtë thënie personave që do të kishin tendencën e përjashtimit të hadithit dhe sunetit:

“A mendon ndonjëri prej jush, i krekosur në kolltukun e tij, që nuk ka gjëra të tjera të ndaluara përveç atyre që ka ndaluar Kurani? Ta dini se unë ju kam këshilluar, ju kam urdhëruar dhe shumë gjëra jua kam ndaluar. Këta janë sa Kurani madje edhe më shumë...” (Ebu Davud, Haraxh, 31-33/3050.)

“Ta dini se bashkë me Kuranin Fisnik më është dhënë edhe diçka e ngjashme me të. Kini kujdes; janë të afërta ditët kur një njeri me barkun plot, i krekosur në kolltukun e tij do të thotë: «Ju kapuni vetëm pas këtij Kurani! Mjafton që të pranoni si të lejuar atë që ju lejon ky Libër e të pranoni të ndaluar atë që ju ndalon ai».” (Ebu Davud, Sunnet, 5/4604; Ahmed, IV, 131.)

Këto hadithe janë të mrekullueshme...Sepse në të vërtetë kemi arritur në kohën për të cilën

23. Ebu Davud, Zekat, 2/1561; Ibn-i Eb' Asim, es-Sunne, II, 386.



i Dërguari i Allahut ka bërë me dije se Tradita Profetike do të ketë tendencën të zhvlerësohet. Duhet të përpiqemi ta mësojmë fenë tonë në mënyrën e duhur që të mund të shpëtojmë veten dhe pasardhësit tanë nga përçarjet e kohës.

Lidhur me këtë çështje i Dërguari i Allahut i është shprehur Abdullah Ibn Omerit  kështu:

*“O ibn-i Omer! Përqafoje fort fenë tënde, përqafoje fort fenë tënde! Sepse ajo është edhe mishi edhe gjaku yt. Ki kujdes nga kush e mëson fenë tënde! Shkencat dhe dispozitat fetare merri nga dijetarët e qëndrueshëm në fe, mos i merr nga ata që orvaten majtas djathtas nga interesat e kësaj bote!”*²⁴

Nuk duhet të harrojmë që Tradita Profetike është një udhëzues unik për të kuptuar Kuranin. Prandaj dhe nuk duhet harruar kurrë se çdo kundërshtim ndaj Traditës Profetike është kundërshtim edhe ndaj Kuranit e për rrjedhojë edhe ndaj Krijuesit të Gjithësisë.

Kështu Abdullah ibn Dejlmi, një nga dijetarët e medhenj të brezit të tabiinëve, thotë:

“Sipas asaj që më ka mbërritur mua, shkatërrimi i fesë do vijë si rezultat i largimit nga Tradita Profetike. Ashtu sikur litarit i hiqen fijet një nga një e në fund këputet, ashtu edhe feja do

24. Hatib el-Bagdadi, el-Kifaje fi Ilmi'r-Rivaje, el=Medinetu'l-Munewvere, el-Mektebetu'l-Ilmijje, fq.121.



braktiset me largimin një nga një prej suneteve.”

(Darimi, Mukaddime, 16/98.)

Prandaj dhe largimi një nga një prej suneteve nga jeta jonë e mban në fije të perit shpëtimin tonë në jetën e përtëjme.

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë:

“Po ju lë dy porosi: Kuranin dhe Traditën time”. (Hakim, I, 171/318)

Vëllezër, të mos harrojmë së armiqësia ndaj Traditës Profetike është një skemë e qëllimshme. Prandaj duhet t'i kushtojmë shumë rëndësi Traditës Profetike sepse objektivi i armiqve të sunetit është zbrazja e brendësisë së Islamit.

Kështu në historinë e feve, devijimi i Jahudizmit dhe Krishtëritimit ka filluar në të njëjtën mënyrë. Fillimisht u braktis tradita e pejgamberëve e më pas u devijua nga çështjet e besimit dhe adhurimit.

Kemi shembullin e Abdulehad Davut Efendiut, i cili ka studiuar kopjet më të vjetra të literaturës së krishterë dhe letrat e Palit. U konvertua në Islam dhe mori emrin Abdulehad.

Ai shprehet:

“Shtrembërimi i krishtëritimit filloi në këtë mënyrë:

- U hoq tradita profetike e në vend të saj erdhi pagëzimi,
- U hoq namazi e në vend të saj erdhi rituali,



- U hoq agjërimi e në vend të saj erdhi pehriza”.

Më pas u braktis mbulesa duke iu lënë si veçanti vetëm murgeshave. Sot, kjo mbulesë ka filluar të hiqet edhe ndër murgesha.

Kështu krishtërimi pushoi së qeni një fe hyjnore. U shtrembërua, u dëmtua. Tashmë nuk është më një model jete, por një markë e një shenjë. Sot Dëshmitarët e Jehovahit pothuajse po i japin fund dispozitave të Krishtërit.

Në lidhje me këtë diskutim ka shumë shembuj. Në momentin që feja shqetëson egon e njerëzve, bëhet tabelë qitjeje. Për shembull në Greqinë e lashtë Sokrati tha: “Zoti është një”. Sapo vendosi disa dispozita në lidhje me besimin monoteist, Konsulli i Athinës kundërshtoi dhe Sokrati u helmua. Sepse feja i kishte shqetësuar ata....

Me pak fjalë ka disa grupime shoqërore që shqetësohen nga Tradita Profetike. Qëllimi i tyre është zbrazja e fesë sikurse ndodhi në fenë e krishterë...

I njëjti kurth po mundohet të ngrihet edhe ndaj fesë së vetme hyjnore, Islamit. Duke përjashtuar Traditën Profetike po kërkohet të prishet Islami ashtu sikurse edhe krishtërimi.

Është thelbësore të jemi jashtëzakonisht vigjilentë si besimtarë ndaj këtyre armiqve të fshehtë apo të dukshëm të fesë. Le të mos harrojmë se medh’hebet janë mbrojtësit e Traditës Profetike, e Tradita Profetike është mbrojtëse e Kuranit.


Prandaj:



✓ Është domosdoshmëri ngritja dhe vijimësia e institucioneve ku mësohet feja me sinqeritet e përkushtim.

✓ Është thelbësor edukimi i dijetarëve që kanë njohuri të thella dhe që mund të mbrojnë hadithin e shkencat e ngjashme.





Çfarë është dhe çfarë nuk është tasavvufi?

Rumiu thotë:

*“Për sa kohë të kem shpirt, unë jam rob i Kuranit. Jam
pluhuri i i rrugës së Muhamedit ﷺ. Nëse dikush përcjell
diçka tjetër nga fjala ime, sado e vogël qoftë, unë jam
lënduar edhe nga fjala e tij edhe nga vetë ai.”*

Pyetja e pestë:

Kur flitet për tasavufin dhe tarikadet, bëhet një përshkrim me fjalë të tilla si makam, mevki, gauth, kutb, keramet²⁵, “Nëse lidhesh me filan hoxhë, ai do të të shpëtojë në jetën e përtejme etj.” Çfarë duhet të kuptojmë kur flasim për tasavvufin? Si e përkufizoni tasavvufin e vërtetë?

ÇFARË ËSHTË TASAVVUFI?

Le të themi që në fillim se në disa grupe shoqërore tasavvufi përshkruhet si shtojcë e fesë. Në të vërtetë tasavvufi nuk është një shtojcë, përkundrazi është devotshmëria, përkushtimi, mirësia në fe. Pra, është arti i njohjes së Krijuesit të Gjithësisë me zemër dhe shpirt.

Tasavvufi thënë ndryshe është bartja e “imanit” (besimit) drejt “ihsan-it” (mirësisë). Është përjetimi i brendisë së “Hadithit të Xhebrailit”. Në këtë ndodhi Xhebraili e pyet të Dërguarin e Allahut:

“ - Çfarë është ihsani?”

I Dërguari i Allahut ﷺ përgjigjet:

“ - Ihsani është adhurimi i Allahut duke përfytyruar sikur po e sheh Atë me sytë e tu. Edhe

25. Sipas terminologjisë së Tasavvufit, **makam** dhe **mevki** nënkuptojnë shkallën, nivelin, pozitën shpirtërore, **kutb** ka kuptimin: personalitet, udhëheqës, zotëri; **gauth** ka kuptimin: shpëtimtar, ndihmëtar; **keramet** ka kuptimin: mrekulli (shënim i përkthyesit).



pse ti nuk mund ta shikosh Allahun, Ai të sheh ty". (Muslim, Iman, 1)

Me fjalë të tjera, tasavvufi është të jetuarit me vetëdijen e mbikëqyrjes dhe vëzhgimit hyjnor. Është ndërgjegjësimi dhe perceptimi i zemrës ndaj kësaj të vërtete. Natyrisht kjo nuk arrihet duke lexuar një libër apo nga një punë mendore. Kjo gjendje është rezultat i përkushtimit shpirtëror.

Tasavvufi është një disiplinë pastrimi, kullimi. Është rruga drejt devotshmërisë duke u shmangur nga çdo gjë që të largon nga Krijuesi i Gjithësisë. Është një edukim shpirtëror që mban frerin e dëshirave egoiste duke kultivuar prirjet e larta shpirtërore.

Tasavvufi është një shkollë shpirtërore ku egoja pastrohet e zemra lartësohet nën frymën e edukatorëve të vërtetë, pasues të rrugës profetike.

Tasavvufi është braktisja e veseve të këqija dhe përvetësimi i moralit të mirë.

Tasavvufi është një betejë me egon që nuk pranon paqe deri në frymën e fundit.

Tasavvufi është aftësia për të qenë përherë mik me Allahun duke treguar pëlqim ndaj çdo caktimi hyjnor. Është ruajtja e një ekuilibri shpirtëror ndaj çdo ulje ngritje të jetës e çdo surprize të ëmbël apo të hidhur të saj. Është mosteprimi në bollëk apo në varfëri. Është pjekuria për ta konsideruar çdo fatkeqësi si një sprovë hyjnore dhe mundësi



Çfarë është dhe çfarë nuk është tasavvufi? 

për t'u pastruar shpirtërisht. Është aftësia për të qenë përherë një “rob i mirë” falënderues duke lënë mënjanë çdo ankesë e qarje.

Tasavvufi është edukimi i ndjenjës së përgjegjësisë tek besimtarët e plotësuar shpirtërisht dhe materialisht, që t'i drejtohen krijesave me një shpirt altruist për të përmbushur kërkesat dhe mungesat e tyre. Është kthimi i ndjenjës së bamirësisë, mëshirës, dashurisë dhe shërbimit në natyrshmëri, si rrjedhojë e dashurisë Hyjnore.

Tasavvufi është përpjekja për të jetuar në çdo fazë të jetës mësimet hyjnore dhe profetike duke u bërë një me Kuranin dhe Traditën e Profetit.

Me pak fjalë tasavvufi është përpjekja për ta njohur së afërmi dhe me dashuri të Dërguarin e Allahut, është afrimi me të, është ekstaza e të jetuarit në përputhje me thelbin dhe shpirtin e fesë duke marrë hise/përftuar nga karakteri, personaliteti dhe morali i tij i lartë.

Çdo qasje tjetër që nuk përputhet me këto parime dhe nuk mbështetet në Kuran dhe Traditën Profetike, sado që t'i mvishet tasavvufit, është e kotë.

ÇFARË NUK ËSHTË TASAVVUFI?

Botëkuptime të tilla, si: “*Mjafton të kesh zemrën e pastër, edhe pse nuk përpiqesh të bësh punë të mira*”, të njerëzve që i kanë hapur rrugën dëshirave



egoiste, nuk kanë asnjë lidhje me tasavvufin si një shërbëtor i vërtetë i fesë.

Në ditët e sotme disa persona që janë shumë larg shpirtit të librit të *Methnevisë*, duke shpërfillur devotshmërinë e Mevlevinjëve, e kanë kthyer Semanë në një shfaqje folklorike dhe në një ansambël muzikor.

E vërteta është se Mevlana në 18 vargjet e para të *Methnevisë* ankohet për të shkujdesurit që, edhe pse e dëgjojnë atë, nuk arrijnë të kuptojnë qëllimin, duke u shprehur me fjalët:

“Unë kam rënkuar në çdo tubim, kuvend. Jam shoqëruar me të mirë e të këqinj.

Të gjithë u miqësuan me mua sipas botëkuptimit të tyre. Por askush nuk arriti të kuptonte misterin e shpirtit tim.

Sekreti im nuk është larg thirrjes sime. Megjithatë, jo çdo sy ka dritën e duhur për ta parë e jo çdo vesh ka fuqinë e duhur për ta dëgjuar.

Shpirtit e vegjël nuk mund t'i kuptojnë njerëzit e mëdhenj. Prandaj fjala duhet thënë shkurt ‘Paqe’.”

Kurani dhe Tradita Profetike kanë qenë burim i frymëzimit hyjnor për Mevlanën dhe miqtë e tjerë të Zotit. Këtë të vërtetë e ka shprehur me vargjet:

“Sa të kem frymë, unë jam shërbëtor i Kuranit, Jam dhë në rrugën e Muhamed Mustafait.



*Nëse dikush nga fjalët e mia përfton tjetër gjë,
Unë pikëllohem dhe ndjej neveri për të.”*

Më këtë deklaratë Mevlana shprehet hapur se ai është: “Robi i Kuranit, dheu i rrugës së Muhamedit”. Pra deklaron qartë se krah u ngulur i kompasit është përherë i qëndrueshëm në shariat dhe se jetën e ka ndërtuar sipas parimeve të Kuranit dhe Traditës Profetike.

Prandaj, do ishte e padrejtë të pretendosh përkatësinë në rrugën e Mevlanës, pa punuar sipas dispozitave Islame, kjo do e lëndonte atë.

Nga ana tjetër, shihet se në disa tarikate bëhen kompromise, në të cilat ndjeshmëria ndaj të lejuarës dhe të ndaluarës vihet në plan të dytë duke u përdorur shprehje të pakuptimta si: “kam zemrën e pastër”. Gjithashtu i hapet rruga përzierjes femra-meshkuj, tregohet dobësi në çështjet e mbulesës e të shumë dispozitave të tjera fetare. Në këtë mënyrë shfaqet një tendencë drejt mendimeve të pabaza ku «pastërtia» e zemrës mjafton kundër kufirit të hallallit dhe haramit.

Kështu udhërrëfyesi më i madh, i cili ishte njeriu me zemrën më të pastër, ndonëse përbënte shembullin e pashoq për umetin e tij në çështjet e adhurimit, marrëdhënieve ndërmjerezore, etikës dhe në mënyrë të veçantë kujdesit ndaj kufirit midis të lejuarës dhe të ndaluarës si problemi më i madh i ditëve të sotme, Pejgamberi ﷺ, po anashkalohet dita ditës.



Ndërsa tasavvufi i vërtetë i formësuar nën frymën e Traditës Profetike është përpjekja për t'u unifikuar dukshëm dhe fshehurazi me parimet jetësore të Profetit. Çdo besimtar, pa marrë parasysh pozicionin, sektin apo tarikatin e tij, është i detyruar të jetë i qartë ndaj përgjegjësive fetare duke marrë shembull të Dërguarin e Allahut, që pavarësisht faktit se ishte në kulmin e përsosjes shpirtërore, plotësonte me përkujdesje të madhe çdo detyrim të fesë.

Një ndodhi e transmetuar nga Abdulkadir Gejlani e shpreh bukur këtë çështje:

«Një ditë para syve m'u shfaq një dritë që kishte përfshirë gjithë horizontin. Teksa po mundohesha të kuptoja ç'ishte ajo, një zë nga drita më foli:

«O Abdulkadir, unë jam Zoti yt! Jam aq i kënaqur nga punët e tua të mira sa që tani e tutje të ndaluarat i kam lejuar për ty».

Sapo dialogu mbaroi, kuptova që ai ishte zëri i shejtanit të mallkuar dhe thashë:

«-Largohu, o i mallkuar! Drita që më tregove është për mua një errësi e përjetshme».

Shejtani tha:

«Me urtësinë dhe mprehtësinë që të ka dhuruar Zoti yt, shpëtove edhe një herë nga duart e mia», - dhe u largua.

I hapa duart drejt dergahut dhe e falënderova Krijuesin e Gjithësisë me vetëdije të plotë se kjo ishte një mirësi nga ana e Tij.



Dikush nga xhemati pyeti:

«-Nga e kuptuat që ai ishte shejtani?»

Ai u përgjigj:

«-Nga pohimi – Të ndaluarat i kam lejuar për ty».

Vërtet, nëse dikush do duhej të bënte përjashtim nga kufiri midis të lejuarës dhe të ndaluarës për shkak të gjendjes së tij të bukur, punëve të tij të mira dhe nivelit shpirtëror, së pari ky përjashtim do vlente për të Dërguarin e Allahut, i cili ishte shembulli i përkryer njerëzor i adhurimit të Zotit. Nëse atij ﷺ nuk i është njohur një privilegj i tillë, nuk do t'i njihet askuj tjetër.”

Prandaj, nuk mund të jetë sufi i vërtetë një person që nuk e ndërton jetën sipas parimeve të Kuranit dhe Traditës Profetike, që anashkalon detyrimet e dukshme fetare, sado që nga goja e tij të derdhen shprehje mistike.

Po kështu, nuk mund të flitet për tasavvufin e dikujt që nuk e ka ndërtuar jetën familjare në bazë të parimeve Islame.

Një prind që e privon fëmijën nga mësimi i Kuranit duke menduar vetëm për të ardhmen e kësaj bote kalimtare, duke vënë në rrezik kështu të ardhmen e tij të përjetshme, nuk mund t'i dhurojë atij një edukim shpirtëror. Është shenjë shkujdesjeje e këtyre prindërve pandehja e vetes si të edukuar me tasavvuf.



Padrejtësia më e madhe që njeriu i bën vetes, është të nëpërkëmbë të drejtat e njerëzve në marrëdhëniet tregtare për hir të interesave të kësaj bote, të veprojë kundër asaj që Allahu ka ndaluar, t'i qaset lëshimeve në fe duke menduar se: «Vetëm këtë radhë po gaboj herën tjetër nuk e përsëris...» Kjo është plagë shpirtërore.

Nuk duhet të harrohen kriteret e Omerit  në lidhje me këtë çështje:

“Mos shihni namazin apo agjërimin e një personi, por shihni:

- ✓ A thotë të vërtetën (të drejtën) kur flet?
- ✓ A e mban amanetin kur i jepet?
- ✓ A i kushton kujdes hallallit e haramit kur merret me punët e kësaj bote ?”²⁶

Me pak fjalë, nuk ka kuptim të pritet një shfaqje mistike tek një person që nuk i kushton rëndësi kriterëve fetare në adhurime, në marrëdhëniet ndër-njerëzore, në etikë dhe në rendin e jetës. Kështu, Imam Rabbaniu thotë:

“Tasavvufi është përsosja e sheriatit”. Pra tasavvufi, është përpjekja për t'u bërë një njeri i përkryer, një rob i devotshëm nën gjurmët e Kuranit dhe Traditës Profetike.

MREKULLIA E VËRTETË ËSHTË ISTIKAMETI

**Tasavvufi nuk është një udhëtim
në përpjekjen për të gjetur
një zbulim a mrekulli.**

Zbulimi-mrekullia mund të haset si një dhunti hyjnore në rrugën e tasavufit. Por mrekullia nuk është garanci e imanit në frymën e fundit.

Allahu i Plotfuqishëm në Kuranin Famëlartë tregon për Belam ibn Buaranë. Edhe atij i qe dhuruar zbulimi, mrekullia, po ashtu njihte emrin më të madh të Allahut (Ismi Adham). Por u shkatërrua duke u dhënë pas kësaj bote dhe dëshirave të egos. Krijuesi i Gjithësisë në ajetin fisnik e krahason atë me një qen të hutuar.²⁷

Karuni fillimisht ishte një rob i mirë i Allahut. Jetonte një jetë me devotshmëri. Por ai gjithashtu u dha pas egos. Allahu i dhuroi atij pasuri, e sprovoi me pasuri, por ai nuk e konsideroi si provë hyjnore dhe humbi rrugën e drejtë. I doli kundër Musait عليه السلام. Allahu Fuqiplotë e varrosi atë në tokë bashkë me pasurinë të cilës i besonte dhe tek e cila mbështetej.

Zbulimi-mrekullia nuk është treguesi i asaj që do të ndodhë me njeriun në frymën e fundit. Prandaj tasavvufi është rruga e respektimit të mësimi hyjnor:

27. Araf, 176.



فَاسْتَقِمْ كَمَا أُمِرْتَ

“Qëndro i patundur në udhën e drejtë...” (Hud, 112)

Dijetarët e mëdhenj të tasavvufit janë shprehur se:
“Mrekullia e vërtetë është ecja në rrugën e drejtë”.

Mrekullitë, ëndërrat apo disa gjendje të jash-tëzakonshme, janë çështje që mund të hasen në tasavvuf, por në asnjë mënyrë nuk janë qëllime më vete.

Tasavvufi para së gjithash është përpjekja për ta ndërtuar jetën në bazë të Kuranit dhe Traditës Profetike.

I Dërguari i Allahut ﷺ në Hutben e Lamtumurës është shprehur:

“O besimtarë! Po ju lë dy amanete. Nëse kapeni fort pas tyre, nuk do e humbisni rrugën. Këto janë Kurani, Libri i Allahut, dhe Suneti i Pjegamberit të Tij...” (Muslim, Haxh, 147; Ebu Davud, Menasik, 56.)

Tasavvufi i vërtetë është respektimi në mënyrën e duhur i këtyre dy amaneteve. Është një formë edukimi që udhëzon mënyrën si të përvetësohen disa tipare shpirtërore që përmenden në Kuran e Sunet si: singëriteti, devotshmëria, asketizmi, përlësia ndaj Krijuesit, pendesa, pëlqimi; përkundër kësaj, si të zhduken disa sëmundje të shpirtit si: syfaqësia, vetëpëlqimi, mendjemadhësia, përgojimi, zilia.



Prandaj, tasavvufi nuk është përpjekja për të arritur kerametin-mrekullinë, por edukimi për të qenë rob i Allahut.

Arritja e zbulimit dhe e mrekullisë nuk është kriter vlerësimi i anës shpirtërore. Kështu nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë mrekulli fizike dhe të dukshme të Ebu Bekrit رضي الله عنه, edhe pse në shumë transmetime²⁸ është bërë e ditur se ai është ndër më të mirët e njerëzve pas pejgamberëve. Mrekullia e tij më e madhe është nënshtrimi dhe bindja e jashtëzakonshme me dashuri dhe besnikëri ndaj të Dërguarit të Allahut. Siç shprehet edhe në Kuran: **“vetë të dytin”**.²⁹

Për këtë arsye, miqtë e Allahut nuk u kanë kushtuar rëndësi mrekullive të dukshme dhe janë treguar të kujdesshëm të mos zbulojnë mrekullitë që mund të jenë shkak i mendjemadhësisë dhe famës. Madje me ndjenjën e frikës dhe shqetësimit, zbulimet e mrekullisë i kanë quajtur “të përmuajshmet e meshkujve” (“hajzi rixhal”). Të gjitha përpjekjet e tyre i kanë përqendruar në arritjen e mrekullisë së vërtetë që është jeta sipas Kuranit dhe Sunetit.

Xhunejd Bagdadi thotë:

“Nëse shihni një person (të ulur në kolltukun e tij) teksa fluturon në ajër, dhe ai nuk i bindet Kuranit dhe Sunetit, (mos e merrni për bazë atë)

28. Ali el-Muttaki, Kenzu'l-Ummal, XI, 549/32578; Ibn-i Maxhe, Mukaddime, 11/106; Ahmed, I, 127, II, 26.

29. Teube, 40.



sepse kjo nuk është mrekulli por istidraxh (humbje graduale deri në shkatërrim)”.

Po ashtu transmetohet se edhe Bejazit Bistami ka thënë:

“Një ditë doja të kaloja në anën tjetër të lumit Tigër. Dy anët e lumit u bashkuan së bashku si një mrekulli për të më hapur rrugë. Menjëherë e mblodha veten dhe iu drejtova Tigrin:

«Betohem se nuk do të mashtrohem! Lundërtarët i kalojnë njerëzit në anën tjetër të lumit kundrejt një gjysëm akçeje. (Ndërsa ti po kërkon në këmbim punët e mia të mira, të cilat prej 30 vitesh po i përgatis për ditën e Mahsherit.) Unë nuk mund të çoj dëm një jetë 30 vjeçare për hir të një gjysëm akçeje (për hir të një kerameti që do më bënte të ndihesha i pasur dhe egoist.) Mua më duhet Kerimi (Allahu) jo kerameti (mrekullia)!”³⁰

Miqtë e Allahut, kur përballeshin me situata të tilla të jashtëzakonshme, përpiqeshin t’i fshihnin nga frika se mos kjo ishte një sprovë që pengon qëllimin e vërtetë të adhurimit dhe njohjes së Zotit.

Përkundrejt kësaj, disa injorantë dhe të pamatur mund të kenë pretendime të tilla si:

“Shejhu im do të më mbrojë në Mahsher. Nuk do më braktisë. Do të më marrë me vete në Xhenet!”

Shprehje të tilla nuk mund të pajtohen kurrë

30. Attar, Tedhkiretu’l-Evlja, fq.217, Ilim ve Kültür Yayınları, Bursa 1984.



me parimet e sheriatit, janë të pabaza, janë eufori emocionesh deri në kufirin e marrëzisë. Ashtu siç e kemi shprehur edhe më parë, askush përveç pejgamberëve dhe të përgëzuarve me Xhennet, nuk ka garanci të imanit në frymën e fundit.

Në ajetin fisnik thuhet:

وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنْتُمْ مُسْلِمُونَ

“...vdisni vetëm duke qenë myslimanë!
(Kujdes, mos vdisni ndryshe!)” (Al-i Imran, 102)

Edhe pse nuk dihet se kush do të shpëtojë duke dorëzuar frymën e fundit me iman, në ajetin Kuranor bëhet e ditur se:

“O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun (pra çështjen e Tij), edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja.”

(Muhammed, 7)

Në këtë aspekt besimtari duhet të përpiqet që gjatë kësaj jete të fitojë kënaqësinë e Allahut për të shpëtuar besimin në frymën e fundit, po ashtu duhet të lutet vazhdimisht me shpresën që të fitojë mëshirën dhe faljen e Krijuesit të Gjithësisë.

Kështu edhe Ibrahim عليه السلام, që ishte Halili (miku i ngushtë) i Allahut Fuqiplotë, i është lutur Atij me një lloj meraku:

“...dhe mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen njerëzit..” (Shuara, 87)



Edhe Jusufi ﷺ i është lutur Krijuesit Fuqiplotë:

“Bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët (në botën tjetër)!”³¹

Prandaj çdo besimtar, pa marrë parasysht në çfarë niveli shpirtëror gjendet, duhet të përgatitet për frymën e fundit dhe jetën e përtejme.

Duhet të themi se shefaati (ndërmjetësimi) është i vërtetë. Zoti i Gjithësisë mund t'i dhurojë ndërmjetësimin kujt të dëshirojë. Por kush do të ndërmjetësojë dhe për kë, është një çështje që e di vetëm Ai. Askush nuk mund të ndërmjetësojë për askënd pa lejen e Tij. Ashtu siç shprehet në ajetin fisnik:

“...Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij?...” (Bekare, 255)

Profeti ﷺ, edhe pse është ndërmjetësuesi më i rëndësishëm, ka porositur vajzën dhe hallën e tij me këto fjalë:

“O Fatime, bija e Muhamedit të Dërguarit të Allahut! O (halla ime) Safije! Punoni vepra të mira të pranuar tek Allahu! (Nëse nuk keni ndonjë vepër të mirë mos i besoni profecisë sime!) Sepse unë nuk mund t’ju shpëtoj nga dënimi i Allahut (nëse nuk keni kryer vepra të mira)!” (Ibn-i Sa’d, II, 256; Buhari, Menakib, 13-14; Muslim, Iman, 348-353.)

Prandaj çdokush është i pafuqishëm, qoftë

31. Jusuf, 101.



shejhu, e qoftë ndjekësi i tij. Përveç personave që i Dërguari i Allahut ka bërë me dije që do jenë prej banorëve të Xhenetit, askush nuk ka garanci në çështjen e frymës së fundit dhe jetës së përtejme.

Kur ndërroi jetë Osman ibn Me'dhuni رضي الله عنه, një ndër njerëzit e devotshëm në mesin e sahabëve, një grua tha:

“- O Osman, dëshmoj se tani Allahu i Lartësuar është duke të gostitur”.

I Dërguari i Allahut ndërhyri dhe tha:

“- *Nga e di ti se Allahu po e gostit?*”

Kur gruaja tha: “- Pasha Allahun, nuk e di.”

I Dërguari i Allahut u përgjigj:

“- *Osmani ka ndërruar jetë. Unë shpresoj nga Allahu të mirën e tij. Por edhe pse unë jam Profet, nuk e di se çfarë do të ndodhë me mua dhe me ju (pra me çfarë situatash do të përballemi)...*”

(Buhari, Tabir, 27.)

Kjo do të thotë që robi gjithnjë duhet të jetojë me devotshmëri dhe me përlësi ndaj Krijuesit Fuqiplotë. Ai duhet të përpiqet që të stoliset me moralin e bukur të Pejgamberit صلی الله علیه و آله. Tjetër rrugë shpëtimi nuk ka. Ashtu si lutjet, edhe adhurimet tona kanë nevojë të pranohen.

Halid Bagdadi, i njohur si “dielli i diejve” në dituri dhe njohje, në letrat që i ka shkruar nxënësve të tij, ka kërkuar duanë e dorëzimit të frymës së fundit me



iman (“husn-i hatime”). Në letrën që i shkroi vëllait të tij e shprehu këtë ndjenjë duke thënë:

“Betohem në Krijuesin e Gjithësisë se që nga dita që më lindi nëna e deri më sot nuk besoj të kem punuar qoftë edhe një punë të vetme të pranuar e të vyeshme tek Allahu për të cilën nuk do jap llogari...”

Nëse nuk e konsideron veten tënde të dështuar sa i takon krejt punëve të mira, ta dish që ky është kulmi i injorancës. Nëse e konsideron veten të dështuar, prapë se prapë mos i humb shpresat nga mëshira e Allahut. Sepse bujaria dhe mirësia e Allahut janë më të dobishme për njeriun se gjithë punët e mira të njerëzve dhe xhindëve.”³²

Kjo do të thotë që sa i takon shpëtimit të përjetshëm, është i panjohur si fundi i muridit ashtu edhe i murshidit... Të jetosh një jetë larg devotshmërisë dhe përkushtimit e të gjesh ngushëllim duke pritur se “Shejhu do më shpëtojë”, është një shkujdesje dhe injorancë që nuk mund të pranohet nga Tasavvufi. Krijuesi i Gjithësisë shprehet:

“...djallin mos e lini t’ju mashtrojë për Allahun.” (Lukman, 33; Fatir, 5)

Të jetosh në shkujdesje e të besosh në faljen e Allahut është përshkruar si “mashttrim i Shejtanit”. Nisur nga kjo, nuk mund të ketë asnjë arsye legjitime që, duke pretenduar në shpëtimin e murshidit në

32. Mektubat-ı Mevlana Halid, 28. Mektup.



jetën e përtejme, të tregohet indiferentizëm dhe neglizhencë ndaj detyrimeve të fesë si robër të Zotit.

Prandaj, konsiderimi i ndjenjës së dashurisë, respektit, lidhjes, përkatësisë ndaj robërve të mirë, si garanci për jetën e përtejme, në vend që të jetë përfitim, është humbje për këdo.

Tasavvufi nuk është rruga e përfitimit të posteve e pozitës

Ashtu si në çdo fushë, edhe në tasavvuf, herë pas here ka pasur persona që kanë abuzuar. Edhe sot, si rezultat i egos dhe i sëmundjes shpirtërore, ka persona që shfaqin pretendime të tilla, si: “Unë jam kutbi e gauthi i kohës”, duke qenë shumë larg shpirtit të vërtetë të tasavvufit.

Gjatë gjithë historisë, abuzues të tillë janë kritikuar nga ithtarët e vërtetë të Tasavvufit.

Le të mos harrojmë se ne nuk kemi ardhur në këtë botë të sprovave për t’u mburrur ndaj njeri-tjetrit. Të gjithë jemi dërguar në këtë botë për të kuptuar përkohshmërinë dhe dobësinë tonë e për të qenë adhurues të Allahut. Kështu, i përfshirë nga këto ndjesi, Shah-i Nakshibendi është shprehur:

“Bota është gruri, ndërsa unë kashta

Të gjithë janë të mirë, ndërsa unë i keq”.


Pra, Tasavvufi nuk është “arz-i endam” (bota e dukjes), por “arz-i hal” (bota e gjendjes). Nuk



është rruga e syfaqësisë, e dukjes, e krekosjes, por është rruga e adhurimit me përulësi dhe modesti. Është rruga e kuptimit të paaftësisë sonë si robër, pavarësisht pozitës në shoqëri. Është vlerësimi i pozitës si “diçka kalimtare”.

Me pak fjalë, grada më e lartë e kësaj bote të përkohshme, është adhurimi i Zotit. Të gjithë ne, me të metat dhe të mirat tona, jemi robër të pafuqishëm të Zotit. Pasi të përpiqemi me sa kemi mundësi, për fundin tonë, ajo çfarë mbetet është të mbështetemi në mëshirën, faljen dhe përkujdesjen e Tij.





Miqtë e Allahut

Lutja e Davudit عليه السلام:

“O Allah! Unë kërkoj dashurinë Tënde, dashurinë e atyre që të duan Ty, dashurinë ndaj një vepre të mirë që më afrojnë në dashurinë Tënde....” (Tirmidhi, Deavat, 72)



Sulltan Javuz Selimi, kuptimin e sundimit të vërtetë
e shpreh me këto fjalë:

*Të jesh mbreti i botës, qenka një luftë e pavlerë;
Të jesh shërbëtor i një evlijaje, qenka më mirë se gjithçka...*

Pyetja e gjashtë

Kush quhet mik i Allahut? Si duhet të shoqërohem me të? Çfarë duhet të bëjnë të rinjtë e sotëm që të përfitojnë nga miqtë e Allahut?

Miqtë e Allahut janë modele të larta të ndjekjes së rrugës profetike, të cilët e kanë plotësuar fenë si nga ana e jashtme ashtu edhe nga ana e brendshme, kanë përparuar shpirtërisht në rrugën e devotshmërisë dhe asketizmit, dhe në mënyrë të vazhdueshme e shohin veten nën vëzhgimin hyjnor.

Ata janë pasuesit e misionit pejgamberik të pas-trimit të egos, pra udhëzuesit shpirtëror që thërrasin në rrugën e drejtë.

Gjithashtu, ata janë personalitete të larta që duhen marrë shembull, pas të Dërguarit të Allahut dhe shokëve të tij. Sepse ata me diturinë, dijen dhe moralin e tyre shembullor, janë “Trashëgimtarët e Profetëve”.

Kështu në hadithin profetik thuhet:

“Dijetarët (që kanë plotësuar fenë si nga ana e jashtme ashtu edhe nga ana e brendshme, që diturinë e kanë kthyer në njohje) janë trashëgimtarët e profetëve.” (Ebu Davud, Ilim, 1.)

Miqtë e Allahut:

- Janë besimtarë që kanë shijuar besimin, thellësinë e emocioneve, përsosjen e sjelljes.



- I tërë qëllimi i tyre është shpëtimi i njerëzimit nga veset e këqija dhe ambiciet egoiste duke i treguar rrugën e moralit të bukur dhe pjekurisë shpirtërore.

- Janë besimtarë të ditur e besnikë që e shohin veten si përgjegjës për gjithë umetin.

Në zemrat e njerëzve, Allahu ka mbjellur dashuri ndaj tyre. Në ajetin fisnik thuhet:

“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t’u dhurojë dashuri.” (Merjem, 96)

Kjo është arsyeja pse Shah Nakshibendi, Gejlani, Mevlana, Junus Emre, Hydaji e të tjerë miq të Zotit, të cilët kanë shijuar miqësinë e buruar nga Allahu, u bënë përjetësisht miq të njerëzimit. Dëshën dhe u deshën. Pas jetës së kësaj bote, ata u përjetësuan në miqësi dhe dashuri, duke lënë pas një jehonë të këndshme në kubënë e kësaj jete të përkohshme.

Pas jetës së tyre të përkohshme, ata vazhduan të jetonin në zemrat e njerëzve. Tregimet, këshillat, librat, poezitë dhe gjithçka lanë pas, nuk u harruan. Ata sot vizitohen më shumë se disa të tjerë që janë ende në jetë.

Pak më parë vizituam Mevlanën. Të pyesim veten:

“Kush është i gjallë, e kush i vdekur?”

Sa më vizitojnë mua gjatë ditës, e sa vizitojnë tyrben e Mevlanës?



Sa luten për mua, e sa herë në ditë luten e lexojnë Fatihanë për Mevlanën?

Mevlana ka shtatë shekuj e ca që ka ndërruar jetë, ndërsa vepra e tij *Methnevi*, *Divan-ı Kebir*, ka shtatë shekuj që jeton...

Kjo do të thotë që Krijuesi i Gjithësisë e lartëson atë njeri që Ai e do. Jeta e përtejme (Ahireti) është një botë e frikshme. Por Allahu Fuqiplotë u jep siguri atyre që kanë fituar miqësinë e Tij:

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar. (Të tillë janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut). Ata i pret lajmi i mirë në këtë jetë dhe në tjetrën. S’ka ndryshim në fjalët e Allahut; kjo është fitorja madhështore.” (Junus, 62-64)

Si t’i njohim miqtë e Allahut?

Sipas një transmetimi, kur sahabët e nderuar e pyetën Pejgamberin ﷺ: “Kush janë robërit e mirë të Allahut (veli)?” Ai u përgjigj:

“Kur t’i shikoni në fytyrë ata persona do t’ju përkujtojnë Allahun e Lartësuar.” (Hajthemi, Mexhmau’z-Zevaid, X, 78; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 4.)

Cilat janë shenjat dalluese të miqve të Allahut?

Ebu Abdullah Salimi, një njeri i ditur dhe poet, u pyet:



“- Si t’i dalloni miqtë e Allahut në mes njerëzve të tjerë?” Ai dha këtë përgjigje:

- Me ëmbëlsinë e gjuhës së tyre,
- Me hijeshinë e moralit të tyre,
- Me sjelljen e tyre fisnike,
- Me devotshmërinë në jetën e tyre,
- Me fytyrën e buzëqeshur dhe shpresëdhënëse,
- Me bujarinë dhe altruizmin e tyre,
- Me shpirtgjerësinë e tyre në pranimin e faljes,
- Me entuziazmin (dëshirën, emocionin) e tyre për të dashur krijesat për hir të Krijuesit.

Miqtë e Allahut:

- Janë në gjendje lavdërimi, pëlqimi, falënderimi dhe dhikri ndaj Allahut.
- Ata jetojnë me thellësinë e meditimit dhe urtësisë.
- Janë larg punëve të kota. Mbartin madhështi shpirtërore dhe respekt.
- Ata kanë braktisur krenarinë, mendjemadhësinë egozimin dhe janë të përlulur dhe modestë.
- Ndjejnë dashuri për të devotshmit dhe urrejtje për ata që e meritojnë.
- Shqetësohen për problemet e shoqërisë. Zëmrat e tyre janë strehë mëshire.
- Ndjejnë përgjegjësi për gjithçka që ndodh.



- Nuk lëndojnë askënd e nuk lëndohen nga ass kush.
- Nuk pengojnë por ndihmojnë. Janë sakrifikues, altruistë dhe u shërbejnë njerëzve.
- Janë të pajisur me intuitë dhe mprehtësi.

Për të përfituar nga miqtë e Allahut duhet të lidhemi shpirtërisht me ta

Rruga e realizimit të kësaj lidhjeje është unifikimi i gjendjes shpirtërore me veprat në praktikë.

Ai që krijon raporte sipas parimit “*Njeriu është me atë që do*”³³, duhet të përpiqet t’i ngjajë atij që do. Nëse nuk është bashkë me të me zemër, nuk ka asnjë kuptim të jetë afër me trup. Prandaj thuhet: “*Ai që është në Jemen, është pranë meje; ai që është pranë meje, është në Jemen...*”

Në Tasavvuf, marrëdhënia që siguron lidhjen shpirtërore me miqtë e Allahut është quajtur “rabita”. Rabita është lidhja e ndërsjellë shpirtërore mes njerëzve për hir të Allahut.

Shprehja më e bukur e “rabit-ës”, e parë në nivelin më të lartë, është lidhja midis të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe Ebu Bekrit ؓ, lidhje prej së cilës Ebu Bekri ndjente mall edhe kur ishte pranë të Dërguarit të Allahut.

Aishja ؓ, momentet e vdekjes së babait të saj, të

33. Buhari, Edeb, 96.

përfshirë në emocionin e ritakimit me të Dërguarin e Allahut ﷺ për të cilin ndjente aq mall, i tregon me fjalët:

Babai im Ebu Bekri ﷺ pyeti në shtratin e vdekjes:

“- Cila ditë është sot?”

“-E hënë”, -iu përgjigjëm.

“-Nëse vdes sonte mos më lini të pres deri nesër. Për mua ditët dhe netët më të bukura janë ato më afër Resulullahut! (Është momenti më i afërt që do të takohem me Të)”, - u përgjigj. (Ahmed, I, 8.)

Allahu i Plotfuqishëm mos i lëntë zemrat tona pa dashurinë e të dashurve të Tij.

Le ta përfundojmë me një lutje të Davudit a.s.:

“Zoti im! Kërkoj dashurinë Tënde dhe dashurinë e atij që të do Ty, dashurinë e punëve të mira që më afrojnë drejt dashurisë Tënde...” (Tirmidhi, Deavat, 72.)

Allahu na bëftë nga njerëzit e Tij të dashur e qoftë i kënaqur me ne!





Kur është i nevojshëm Tasavvufi?

Islami nuk është një rregull që duhet të ndiqet në një kohë të caktuar, por një mënyrë jetese e mbështetur në devotshmëri, e cila rregullon çdo frymëmarrje tonën.

Pyetja e shtatë:

Në cilat periudha të Historisë islame është ndjerë nevoja e Tasavvufit? A kemi sot nevojë për Tasavvufin? A mund të rrugëtohet pa të?

Nevoja për Tasavvufin është e përhershme, sepse e tillë është edhe domosdoshmëria e njeriut për t'u përmirësuar.

Nëse hedhim vështrimin në histori, shohim se në kohën e mirëqenies ekonomike dhe shoqërore tasavvufi ka ushqyer shpirtin duke u bërë pengesë e përtacisë, dembelizmit e arrogancës; po ashtu në periudhat e vështira të pushtimit e mizorisë së plotë, ka çelur dritare madhështore duke i dhënë frymë zemrave të ngushtuara.

Kjo është një qasje profetike. I Dërguari i Allahut ﷺ, sa herë arrinte një fitore apo mirësi, thoshte: “O Allah! Jeta e vërtetë është jeta e përtejme...”³⁴, duke mbyllur kështu derën e krenarisë, egoizmit dhe devijimit të zemrave ndaj kësaj bote.

Nga ana tjetër, sa herë përballej me ndonjë padrejtësi, mërzi, shqetësim, shprehej: “O Allah! Jeta e vërtetë është jeta e përtejme...”

Në këtë mënyrë ai i ka ruajtur zemrat e besimtarëve nga humbja e shpresës përballë vështirësive të përkohshme, si dhe nga humbja e qetësisë shpirtë-

34. Buhari, Rikak, 1.



rore si rrjedhje e zhytjes në ankesa dhe në mërzë të tepruar. Ai i dhuroi umetit recetën shpirtërore të paqes, qetësisë dhe ekuilibrit përballë çdo situatë.

Në kohën kur Islami ishte i vështirë të jetohej, nevoja e Tasavvufit u rrit. Për shembull, në periudhën kur bota Islame u plaçkit nga Mongolët, personalitete të larta shpirtërore si Mevlana apo Junus Emre, ishin pranë popullit. E vërteta është se kjo prani nuk ka munguar që prej 700 vjetësh.

Në kohën kur Batinitë synuan ta dëmtojnë shpirtin e Islamit, u shfaq Imam Gazaliu me devotshmërinë, diturinë dhe urtësinë e tij. Ai ka dhënë një kontribut të vyer në çështjen e ruajtjes së besimit Islam nga disa opinione të huazuara nga filozofia indiane dhe greke. Ai u përpoq të pastronte besimet e gabuara dhe ta drejtonte popullin drejt jetës së devotshme.

Po ashtu shohim edhe këshillat e urta të Imam Rabbanit në kohën kur në Indi, Shahu Ekberi u përpoq të dëmtonte besimin islam duke bërë lëshime në fe. Ai ruajti besimin Islam ndaj përçarjeve të kohës dhe u bë shkak që shumë nga burrat e shtetit, paria ushtarake dhe populli i thjeshtë, të cilët kishin rënë pre e mendimeve të pabaza, të pendoheshin dhe të drejtoheshin në rrugë të drejtë.

Në Perandorinë Osmane mbizotëronte qetësia shpirtërore për sa kohë vazhdoi tarikati (silsile) i Edebalit. Në ditën e bekuar kur Sulltan Mehmet Fatihu mori Stambollin, tha:



“Gëzimi dhe paqja që shihni tek unë, nuk buron thjesht nga pushtimi i kësaj kalaje; por nga prania e (dhe afërsia) e një rob i dashur të Allahut siç është Akshemseddini (nga përfitimi prej mësimëve të tij shpirtërore).”

Aziz Mahmud Hydaji, një rob i dashur i Allahut, i cili ka jetuar në kohën e tetë sulltanëve, ka arritur të jetë burim qetësie shpirtërore, paqeje e qëndrueshmërie në besim, si për sulltanët që kanë sunduar botën ashtu edhe për popullin e thjeshtë, duke iu tërhequr atyre vëmendjen dhe duke i orientuar. Së bashku me Ferhat Pashën, mori pjesë edhe në fushatën luftarake të Tebrizit në detyrën e komandantit shpirtëror të ushtrisë.

Nga ana tjetër, është vërtetuar historikisht se besimtarët që kanë arritur të përfitojnë me të vërtetë nga edukimi shpirtëror i tasavvufit, kanë qenë më të lidhur me besimin dhe punët e mira dhe kanë mbrojtur më lehtë imanin e tyre përballë tiranisë e shtypjes.

Në shumë vende islame si: Ballkani, Kaukazi, Azia Qëndrore dhe Afrika, të ekspozuara nga njëra anë nga rreziku i asimilimit ateist dhe komunist dhe erozioni kulturor global, nga ana tjetër nga aktivitetet misionare, ata që kanë arritur të ruajnë identitetin e tyre islam kanë qenë kryesisht besimtarët e edukuar në frymën e tasavvufit.

Qëllimi i tasavvufit është forcimi i besimit në



zemër në atë shkallë që të mos lëkundet përballë fortunave me të egra të mosbesimit dhe femohimit.

Edhe në vendin tonë, në kohën kur Islami u sulmua, përpjekjet e Sami Efendiut dhe miqve të tjerë të Allahut, ishin të mëdha.



Një aspekt tjetër i domosdoshmërisë dhe rëndësisë së Tasavvufit në ditët tona, është edhe metoda dhe rruga që ai ndjek në çështjen e përmirësimit të njerëzve.

Veçanërisht në këto kohë, shumë njerëz janë zhytur në krizën shpirtërore të egos dhe gjynaheve të mëdha. Është e qartë se në vend që të zemërohemi me ta, është më e lehtë t'u ofrojmë një rrugë shpëtimi dhe përmirësimi përmes parimeve të patjetërsueshme të tasavvufit, siç janë: falja, mirëkuptimi, mëshira dhe dhembshuria.

Kështu sipas botëkuptimit mistik, urrejtja ndaj gjynahit nuk duhet t'i mvishet gjynahqarit. Madje qasja ndaj tij duhet të jetë e bazuar në dhembshuri dhe mëshirë, sikur ndaj një zogu krahëthyer.

Le të shohim disa shembuj që e shprehin bukur këtë të vërtetë:

Kadiu i Shamit, Ebu Derda , një ditë teksa po shëtiste në rrugët e qytetit, vërejti disa njerëz që po i flisnin me fjalë të rënda një gjynahqari.

U tha:



“-Nëse do shihnit një njeri që ka rënë në pus, a do e shpëtonit?”

“-Po, do e shpëtonim!”, - u përgjigjën ata.

Pas kësaj Ebu Derda tha:

“-Atëherë mos i flisni me fjalë të rënda vëllait tuaj, por falënderoni Allahun që ju ka dhuruar shëndet”.

Ata pyetën:

“-Po ju, a nuk u zemëruat me këtë gjynahqar?”

Ebu Derda u përgjigj:

“-Unë nuk u zemërova me të, por me mëkatin e tij, kur ai të largohet nga ky mëkat, përsëri do jetë vëllai im në fe”. (Abdurrezzak, Musannef, XI, 180; Ebu Nuajm, Hilje, I, 225.)

Një shembull nga Mevlana:

Gjatë një tubimi fetar në teqe papritmas shfaqet një i dehur. Dervishët e pranishëm aty mundohen ta nxjerrin jashtë me forcë. Ndërkohë Mevlana mendon se ky njeri i dehur ka trokitur në derën e teqes për të gjetur të vërtetën, prandaj u thotë dervishëve me ton qortues:

“-Mos e prekni të gjorin! Po shoh se verën e ka pirë ai, por të dehurit jeni ju!”

Një tjetër shembull:

Në një sofër iftari të shtruar nga fondacioni Hydaji, shfaqen dy të dehur. Një pjesë e xhematit shprehet me zemërim:



“-T’i nxjerrim përjashta këto njerëz të pamatur që vijnë të dehur në këtë vend të begatë!”.

Disa të tjerë të edukuar në frymën e tasavvufit thanë:

“-Le të mos shohim mëkatin e tyre. Le t’i pranojmë këta persona si dy krijesa të uritura të Zotit, që kanë trokitur në derën tonë në këtë kohë të begatë”. U japin për të ngrënë dhe për të pirë dhe interesohen për gjendjen e tyre. Koha kalon dhe njëri prej tyre ndryshon krejtësisht duke u bërë një besimtar i devotshëm.

Kështu metoda e tasavvufit ndaj atyre që kanë humbur besimin dhe janë zhytur në dobësitë e egos, synon fitimin e zemrës përmes gjuhës së mëshirës, jo përmes gjuhës së ftohtë dhe helmuese gjarpëruese.

Për këtë arsye, gjatë gjithë historisë ithtarët e vërtetë të tasavvufit, zemrat e të cilëve ishin burime mëshire, kanë qenë një pishtar ndriçues për gjithë shoqërinë. Prandaj dhe Abdulkadir Gejlani, Bahauddin Nakshibendi, Mevlana, Junus Emre e robërit e tjerë të dashur të Allahut, përherë duhen dhe iu ndihet mungesa.

Për fat të keq sot ka prej atyre që e komentojnë Islamin sipas dëshirave dhe interesave vetjake. Por cili është Islami që duhet jetuar në mënyrë që Zoti ynë të jetë i kënaqur? Natyrisht është Islami i të Dërguarit të Allahut dhe shokëve të tij. Pra është



e domosdoshme që Islami të jetohet me thellësinë e zemrës, me delikatesën e moralit dhe me ndjeshmërinë e devotshmërisë.

Ky është vetë Islami; megjithatë për ta ndarë nga kuptime të ndryshme përdoren termat: “takva”, “zuhd”, “ihsan”, shkurtimisht “tasavvuf”. Këto janë emërtime të ndryshme të një të vërtete të vetme...

Në këtë kuptim, në një kohë kur njerëzimi i është nënshtruar materiales dhe epsheve, nevoja për tasavvufin është e patjetërsueshme. Sepse feja mund të ruhet vetëm me ndjeshmërinë e devotshmërisë. Devotshmëria shkurtimisht është frika dhe dashuria ndaj Allahut.

Krijuesi i Gjithësisë i përshkruan besimtarët:

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë...”

(Enfal, 2)

Kjo do të thotë që devotshmëria është të jetuarit e Islamit mes fërgëllimës së një zemre të butë e të ndjeshme.





Çfarë solli e çfarë mori me vete jeta moderne?

Imam Shafiu ﷺ thotë:

*“Nëse nuk e mban veten të zënë me punë të mira, e
keqja do të të pushtojë!”*

Ahmed ib Hanbeli ﷺ thotë:

*“Besimtari mjaftohet me pak pasuri,
ndërsa ambiciozit edhe pasuria
e shumtë i duket pak.”*

Pyetja e tetë

Çfarë solli dhe çfarë mori me vete jeta moderne dhe zhvillimi teknologjik i këtij shekulli? Pjesa më e madhe e rinisë sonë janë përdorues aktivë të rrjeteve sociale. Për çfarë duhet të bëjmë kujdes kur përdorim teknologjinë dhe veçanërisht internetin, në mënyrë që të mos përhumbemi në rrugët e pakuptimita të internetit dhe të mos devijojmë drejtimin tonë?

Të nderuar vëllezërit e mi!

Sot hekuri, metalet dhe progresi teknologjik konsiderohen zhvillim. E vërteta është se zhvillimi arrihet përmes vlerave njerëzore. Progresi teknik dhe teknologjik nuk mund të prodhojë virtyte njerëzore, përkundrazi ai ndryshon natyrën e njeriut. Pra ndryshon negativisht natyrën njerëzore ngjashëm me frutat dhe perimet e ndryshuara gjenetikisht me hormone.

Cili është rezultati i zhvillimit të industrisë dhe teknologjisë?

- I nxiti njerëzit të bëhen egoistë. Ata tashmë mendojnë vetëm për vete.
- I orientoi drejt harresës së Ahiretit (Jetës së Përtejme).
- Ua dobësoi tiparet dhe virtytet, si: turpi, nderi, morali i bukur apo intimiteti.



Interneti është rezultat i teknologjisë. Nëse një besimtar mysliman paraqet një foto në internet duke darkuar me familjen e tij në një restorant luksoz dhe ju e pyesni:

“-Çfarë po bën?”

Ai do t’ju përgjigjet: “Po ia dërgoj një mikut tim.”

Ndoshta ai mik është nevojtar dhe kjo foto i ngjall lakmi.

Pastaj ajo foto mund të mos shkojë vetëm te mik, por mund të përhapet. Kështu humbet privatësia.

Nga ana tjetër, feminiliteti po humbet si rezultat i pushtimit kulturor global. Femra po mashtrohet dhe sulmohet në emër të lirisë e barazisë. Në fakt gruaja është mbretëresha e familjes së vet.

Një problem tjetër është zhdukja e vlerave tona në ambiente dasmash:

- Dukja, shfaqja, syfaqësia po bëhen kriter i vlerësimit të dasmave.

- Të varfërit dhe nevojtarët po anashkalohen.

- Po humbet privatësia.

Kjo është një humbje e vërtetë, një humbje e vlerave shpirtërore si rezultat i pushtimit kulturor global i cili ka gjetur zhvillim të shpejtë përmes teknologjisë.

Kultura jonë e të ushqyerit po humbet:

Tashmë vendosja e lugës dhe pirunit në tryezat



Çfarë solli dhe çfarë mori me vete jeta moderne? 

tona ka filluar t'i ngjasojë mënyrës së vendosjes në tryezat e huaja.

Ushqimet po ekspozohen. Ndërkohë që ka shumë prej njerëzve të privuar nga ushqimi. Ai ushqim më pas bëhet shkak për pakujdesi ndaj atij që e konsumon.

Në Stamboll, në kohën e fëmijërisë dhe rinisë sonë, kishte restorante luksoze si (për shembull) “Konja Lezzet”. Në vitrinë kishte një perde që pengonte dukjen. Pra kishte një lloj ndjeshmërie të bukur që buronte nga tradita.

Në atë kohë nuk kishte furra në shtëpi. Ushqimi gatuhej me zjarrin që ndizej në oborr. Byrekët e bakllavatë mbuloheshin me një copë dhe piqeshin në furrën e lagjes. Pastaj na thonin:

“-Kujdes o bir, ndaj diçka edhe për furrëpjekësin, mbase aroma e gatimit e shtyn ta provojë”.

Në atë kohë nuk kishte as qese plastike, por çanta që pengonin ekspozimin e gjërave që kishin brenda. Kur dilnim të bënim pazar na thuhej:

“- Kujdes mos na sillni fruta e perime që kanë ngelur në syrin e nevojtarëve”.

Për më tepër nuk kishte as ushqime të ekspozuara në syrin e nevojtarëve, si: doner, qebap apo të tilla si këto. Për fat të keq me kalimin e kohës u përhapën.

Për shembull në Stamboll -shpresoj të mos ndodhë kështu edhe në Konja- nuk gatuajnë më



në shtëpi. Restorantet janë plot. Ushqimet sillen në shtëpi me motorçikleta.

E vërteta është se ushqimi ka një shije materiale, por edhe një shije shpirtërore. Gatimi (duke qenë) me abdest, me emrin e Zotit, me shehadet dhe me meditim, është burim qetësie dhe shërimi për ata që e konsumojnë. Ndërsa sot nuk dihet kush e gatuan ushqimin, me çfarë dhe si!

Duhet gjithashtu që ushqimi të fillohet me bismilah (me emrin e Zotit) dhe të përfundohet me elhamdulillah (falënderim), pa harruar Zotin e vërtetë të mirësive, në mënyrë që ai ushqim të jetë burim qetësie shpirtërore dhe shërimi.

Për fat të keq këto janë disa vlera që po humbasin me kohën.

Ka humbur kultura jonë e veshjes:

Po përdoren rroba të ngushta, të papërshtatshme për shëndetin dhe karakterin e njeriut. Po përzihet karakteri mashkullor me atë femëror. Po rritet tendenca për t'u ngjarë të huajve. Shumë gjëra jo të hijshme konsiderohen të zakonata për fëmijët, vetëm e vetëm që ata të kënaqen. Shumë parime të mbulesës po nëpërkëmben.

Kanë ndryshuar marrëdhëniet familjare:

Në të shkuarën, pra në fëmijërinë tonë, gratë kishin profesione të tilla si: gjinekologe, rrobaqepëse,



Çfarë solli dhe çfarë mori me vete jeta moderne? 

mësuese, mësuese në kurse Kurani për vajza, në vende ku frekuentoheshin vetëm nga femra. Pra punonin në vende të përshtatshme për ta.

Në atë kohë familja dhe shtëpia nuk lireshin pas dore. Ndërsa sot po. Natyrisht nuk flas për të gjithë, por fëmijët e sotëm janë viktimë të televizionit, internetit, modës, reklamave. Ata kanë filluar të marrin kënaqësi prej tyre. Si rezultat, tashmë nuk marrin ndonjë kënaqësi nga nëna dhe babai dhe nuk i ndjekin ata si shembull. Natyrisht kjo shkakton një pështjellim të madh shpirtëror të shoqërisë.

Ka humbur kultura e lagjes:

Më përpara njerëzit në lagje mbronin njeri - tjetrin. Jetimët dhe vejushat mbroheshin në mënyrë të veçantë, në kuptimin e plotë të fjalës. Paja e vajzës jetime përgatitej nga vetë zonjat-gratë e lagjes.

Të pasur e të varfër banonin së bashku në të njëjtën lagje. Nuk kishte një sistem klasash mes të pasurve dhe të varfërve. Jetohej në vëllazëri.

Kishte mirëkuptim dhe kursim. Kishte thjeshtësi dhe dinjitet.

Kishte mirësjelljeje të veçantë. Madje të sëmurëve mendore nuk u thuhej “të çmendur”, por “të pafuqishëm-të dobët”.

Sot kjo edukatë, kjo delikatesë, kjo hijeshi ka humbur. Për shembull shohim se në dasma hidhen



fishekzjarre. A ka aty rrotull njerëz të sëmure, njerëz që vuajnë apo të tjerë me probleme? Për fat të keq askush nuk mendon për ta.

Moda ka marrë një vëmendje të madhe:

Moda i ka kthyer njerëzit në robotë. Përpjekja e njerëzve për të mbushur mangësitë shpirtërore përmes materializmit, është tashmë tepër e dukshme. Pra dobësinë e personalitetit mundohen ta kompensojnë përmes modës dhe stilit të veshjes.

Kjo shfaqje, ky ves i konsumit, grykësia dhe shpërdorimi, janë elementet e një jetese që Islami nuk e pranon.

Ngjashmëritë formale dhe artificiale me ata që kanë fituar zemërimin e Allahut, tani janë shtuar.

Çfarë përfaqëson ky model sjelljeje? Është komplet kundërvënie ndaj mesazhit të vargut Kuranor:

غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ

“...jo në rrugën e atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd...” (Fatiha, 7)

Përngjasimi me ata që kanë shkaktuar zemërimin e Allahut dhe me ata që kanë humbur rrugën, përkon me të qenit një prej tyre.

I Dërguari i Allahut ﷺ shprehet:



Çfarë solli dhe çfarë mori me vete jeta moderne? ﴿فَقُلْ﴾

مَنْ تَشَبَّهَ بِقَوْمٍ فَهُوَ مِنْهُمْ

“Ata që mundohen t’i përngjajnë një populli të caktuar, janë prej tyre”. (Ebu Davud, Libas, 4/4031.)

Prandaj konceptet si, “Çdokush në shoqëri sillet kështu; si të veprojnë të tjerët, do të veprojnë edhe unë...”, nuk mund të jenë një kriter i pranueshëm nga ana jonë. Shembulli ynë është i Dërguari i Allahut, janë shokët e tij, janë njerëzit e mëdhenj të Islamit.

Bota kapitaliste shpiku disa festa në ditë të veçanta në mënyrë që të rrisë konsumin, të shesë më tepër e të fitojë më shumë para:

E vërteta është se ditëlindjet, ‘Dita e nënës’, ‘Dita e babait’ e të tjera si këto, janë shpikje të Perëndimit kapitalist në mënyrë që të nxisë shoqërinë drejt shpërdorimit.

Shkëmbimi i dhuratave sigurisht është traditë profetike. Nuk ka ndonjë pengesë në shkëmbimin e dhuratave, pa e tepruar, në raste të tilla si ditëve të xhuma, netëve të mëdha, bajrameve etj., përkundrazi, ky është burim mëshire, begatie dhe dashurie.

Për të shitur sa më shumë mallra, perëndimi kapitalist nxori një ‘Ditë të nënës’, apo ‘Ditë të babait’. Shoqëritë që kanë humbur vlerat shpirtërore, filluan të qetësojnë ndërgjegjen e tyre duke iu dhënë vlerë personave të afërt vetëm në një ditë gjatë vitit.



E vërteta është se çdo ditë është e nënës dhe e babait. Një mysliman duhet të interesohet në çdo rast për gjendjen e prindërve, t'u puthë dorën, t'u fitojë duanë e t'i vizitojë ata. Madje edhe pas vdekjes së tyre duhet t'u jetë mirënjohës, të kryejë vepra të mira në emër të tyre, të lutet për shpirtin e tyre, e të jetë një sadaka rrjedhëse për ta.

Po ashtu, perëndimi kapitalist për të shfrytëzuar shoqërinë edhe më shumë, shpiku "Ditën e të Dashuruarve". Është shumë e vështirë të kuptohet ç'është kjo dashuri!

Dashuria e vërtetë është ajo që të drejton drejt dashurisë hyjnore. Dashuria është nevoja e shpirtit për shpirtin. Nevoja e trupit për trupin nuk është më dashuri, por epsh.

Sa bukur shprehet Mevlana:

"Ki mëshirë! Dashuria është diçka e mirë. Janë shprehjet tuaja të këqija ata që e dëmtojnë dashurinë. Ti e paske quajtur dashuri epshin. Ah sikur ta dije, sa shumë ndryshim ka midis dashurisë dhe epshit!"

Dashuria hyjnore e bën besimtarin vigjilent. Ndërsa dashuria e kësaj bote dhe epshi e bëjnë njeriun budalla dhe kokëtrashë".

Burimi i vërtetë i dashurisë është "el-Vedud", Krijuesi i Gjithësisë. Besimtari i vërtetë i sheh të gjitha krijesat me dashuri në sajë të Krijuesit të tyre. Dhe këtë nuk e bën vetëm në një ditë, por çdo ditë.



Çfarë solli dhe çfarë mori me vete jeta moderne? ﴿٢٤٤﴾

Po ashtu, me avancimin e teknologjisë u përhap edhe vesi i fotografisë. Madje në emër të lidhjes (rabita) u shtri deri në jetën shpirtërore. Nuk mund të ketë lidhje shpirtërore (rabita) përmes fotografisë. Rabita është ruajtja e dashurisë, është një lidhje shpirtërore, vetëm kaq. Nuk mund të shkojë më tutje. Rabita duhet të mbesë në kufirin e dashurisë. Tejkalimi i këtij kufiri -Zoti na ruajt- shpie në shirk. Besimi monoteist nuk e pranon në asnjë mënyrë ortakërinë.

Edhe dashuria e nënës për fëmijën e saj është rabita, edhe dashuria e një njeriu të devijuar për pijen e kumarën e tillë është. Ndërsa rabita e një myslimani është dashuria për të Dërguarin e Allahut; dashuria, lidhja dhe besnikëria që ndjen në shpirt për njerëzit e mirë e të devotshëm. Kjo pra është rabita.

Nuk mund të ketë rabita duke parë fotografinë. Për më tepër, fotografia është kufizim i kuptimit. Adhurimi i idhujve lindi pikërisht në këtë mënyrë. Sahabët nuk bënë rabita duke pikturuar portretin e njeri-tjetrit.

Në qytetërimin tonë njerëzit e mirë nuk përkujtohen me fotografi, ata mbahen mend me karakteristikat morale dhe përvojat e tyre. Për shembull, kur flitet për Omerin ﴿٢٤٥﴾, ne kujtojmë drejtësinë e tij, trimërinë e mprehtësinë. Nuk kujtojmë vetullën, syrin, e trupin e tij!



Për fat të keq gabime dhe risi të tilla tashmë kanë hyrë në jetën tonë. Interneti po i përhap ato me shpejtësi të madhe.

ÇFARË MASASH DUHET TË MARRIM?

Zakonet dhe traditat e kohës duhet t'i vlerësojmë mbi bazën e parimeve Islame.

Nuk duhet të harrojmë se lehtësimet që ka sjellë teknologjia janë thikë me dy presa, kanë anët e tyre pozitive dhe ato negative.

Gjatë përdorimit të kompjuterit, telefonit, tabletit apo rrjeteve sociale, nuk duhet të harrojmë domosdoshmërinë e kujdesit ndaj “takvasë” (devotshmërisë) në çdo çast të jetës sonë.

Shpesh duhet të mendojmë se edhe këto janë mirësi për të cilat do japim llogari në jetën e përtejme.

Në mënyrë të veçantë kjo këshillë e Imam Shafiut, duhet të jetë moto për çdo çështje:

“Nëse nuk e mban veten të zënë me punë të mira, e keqja do të të pushtojë!”





Sistemet njerëzore dhe ISLAMI si fe e vërtetë

Rumiu thotë:

*“Shemsi më mësoi (thellë në shpirt, jo në mendje):
“Nuk ke të drejtë të ngrohesh në këtë botë, nëse edhe një
besimtar i vetëm ka ftohtë!..”*

DYETJA E NËNTË

Komunizmi, kapitalizmi dhe liberalizmi janë sisteme njerëzore ndikuese në botë. Çfarë sistemi ofron feja Islame përballë tyre? Cila është pikëpamja botërore e Islamit në menaxhimin e individit dhe shoqërive?

Ashtu siç e kam sqaruar edhe më parë në shembullin e Garaudi-t, sistemet njerëzore asnjëherë nuk kanë arritur të përmbushin nevojat e shpirtit të njeriut.

Kur u shfaqën komunizmi dhe socializmi, pretendonin se “Pasuria është e popullit”. Por një grup i ashtuquajtur “elita”, të cilët shtireshin sikur përfaqësonin popullin, zunë vendin e të pasurve dhe kështu pasuria nuk ishte më e popullit por e “partiakëve”. Partiakët vepruan sipas nismave të tyre. Papritmas u bënë të pasur edhe pse më parë nuk zotëronin asgjë. Populli u varfërua. Ndërsa për ata, tragei, treni e gjithçka tjetër, ishin të gjitha falas.

Komunizmi u shfaq me pretendimin se gjoja të gjithë do të jenë të barabartë, në këtë mënyrë do të ketë drejtësi, balancë e paqe në shoqëri. Por, si ai që punoi, si ai që nuk punoi, u trajtuan njëllëj. Si ai që e theu broken, si ai që e mbarti pa e thyer, ishin të barabartë. Këto sjellje u bënë shkak i paralizimit të prirjeve.



Për shembull, në një garë, ai që vrapon më shpejt, shpallet i pari. Por nëse i pari dhe i fundit trajtohen në të njëjtën mënyrë, kjo nuk e motivon personin që mund të vrapojë shpejt. Kjo praktikë e ndalon zhvillimin në tërësi.

Komunizmi, për shkak të këtij qëndrimi kundër natyrshmërisë dhe realitetit njerëzor, u kthye në një sistem abuzimi nga i cili përfituan vetëm partiakët...

Përkundër kësaj mizorie dhe padrejtësie të komunizmit, Kapitalizmi u shfaq me shprehjen tunduese: "Pasuria është e individit". Mirëpo e tërë pasuria u grumbullua në duart e trusteve dhe kartelevë. I pasuri u pasurua edhe më shumë. Njerëzit u armiqësuan ndaj klasës sunduese dhe borgjezisë. U përjetuan shumë drama.

Liberalizmi kishte moton: "Njerëzimi do të konkurrojë në liri". Askush të mos e ndalë kapitalin;

"Laissez faire, laissez passer!"

Pra: "Le ta bëjnë, le të kalojnë! Fitoni atë që fitoni!"

Do të dilnin mallra me cilësi më të mirë gjoja si rezultat i konkurrencës, prodhimi do bëhej më i lirë, çmimet do uleshin, pra të gjithë do fitonin. Por ndodhi e kundërta. Kartelet dhe trustet ranë në ujdë për çmimet. Kështu u mblodhën të gjitha fabrikat që prodhonin një laps, vlera e të cilit nuk kalonte 10 kurush, por ata e hodhën në treg me një çmim shumë më të lartë se vlera reale. Kështu



u hap rruga e një abuzimi të ri. Me inflacionin e nxitur nga përqindja e interesit, të varfrit u varfëruan edhe me shumë.

Pra kuptimi i: «Le ta bëjnë, le të kalojnë! Fitoni atë që fitoni!», mori trajtën: “Të moliset shtresa e ulët”.

Meqë mëshira dhe solidariteti as që ishin pjesë e jetës, pati shkatërrime dhe kriza sociale. E gjitha u shndërrua në një garë mes të fortëve për të shtypur të dobëtit.

Të gjitha sistemet shfaqeshin me mashtrim. Kapitalistët dhe komunistët u bashkuan në çështjen e pronës për të shfuqizuar dispozitat e pronarit të vërtetë të pasurive, Allahut të Plotfuqishëm. Në fakt ata ishin njëlloj. Pra, materialistë dhe femohues...

Komunizmi dhe kapitalizmi u ndanë në çështjen e përkatësisë së pronës. Komunistët deklamuan që “prona është e popullit”, ndërsa kapitalistët pretenduan se “prona është e individit”.

Ndërsa sipas Islamit prona nuk është as e popullit as e individit, ajo është vetëm e Allahut. Gjykimi i vullnetit hyjnor është përcaktues në përdorimin e pasurisë.

Islami mësoi se e gjithë pasuria është -me terminologjinë e sotme- një lloj prone e përkohshme (devre mulk). I mësoi njeriut se pasuria i është dorëzuar atij si amanet për një kohë të përcaktuar. Pra, njeriu nuk është pronari i vërtetë i pronës, por një përdorues i përkohshëm i pasurisë së tij.



Prandaj në Islam ndalohet rreptësisht shfrytëzimi i njeriut dhe shoqërisë, dhe anashkalimi i kufijve hyjnorë për të përfituruar disa të mira materiale prej të cilave një ditë do të largohemi.

Para së gjithash fitimet jo të lejuara si “*gabn-i fahish*”, pra fitimi i tepërt duke mashtruar, interesi, spekulimi, stoqet, janë të ndaluara. Po ashtu, janë të ndaluara edhe shpërdorimi dhe koprracia.

Shpërdorimi është përpjekja për të mbuluar ndjenjën e inferioritetit përmes shfaqjes së forcës.

Ndërsa koprracia është akumulimi i pasurisë vetëm për vete dhe mosdhënia (shtrëngimi, ruajtja) e saj nga frika e rënies në varfëri, si një ndjesi e nxitur nga shejtani. Kjo është një dobësi që vjen si rezultat i frikës dhe mungesës së mbështetjes tek Allahu. Pra, në vend që të kërkojë strehim tek Allahu, njeriu kërkon strehim dhe mbrojtje tek paraja.

Si shpërdorimi, ashtu edhe koprracia janë një lloj rebelimi ndaj pronarit absolut të pasurisë, Allahut të Plotfuqishëm.

Njeriu, në çështjet materiale është një amanetqar që duhet ta përdorë pasurinë sipas dispozitave të Allahut.

Sistemet njerëzore e konsiderojnë njeriun si mekanizëm i rotullës së ekonomisë dhe e shfrytëzojnë atë. Madje të vjetrit kishin një shprehje: “Më parë kishte puse në kopshte. Për të nxjerrë ujin nga këto puse, një kalë me sy të lidhur sillej rreth



tyre nën trysninë e kamxhikut. Në këtë mënyrë nxirrej uji”. Komunizmi solli pikërisht këtë metodë prodhimi.

Kapitalizmi, nga ana tjetër, i tregon kalit qesen me bar, sapo ai afrohet, qesja tërhiqet dhe kështu e përdor kalin për të nxjerrë ujë nga pusi. Pra, të dy sistemet janë shfrytëzuese.

Nga ana tjetër ekonomia islame synon të zgjidhë problemin njerëzor. Kështu në Islam mundësitë duhet të ndahen me të tjerët, duke u bërë i dobishëm për ta.

Në ajetin fisnik thuhet:

وَفِي أَمْوَالِهِمْ حَقٌّ لِّلسَّائِلِ وَالْمَحْرُومِ

“Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët...” (Dharijat, 19)

Nëse dikush ka një nevojë dhe e ndan me ju, ju duhet t’ia plotësoni. Por nëse nuk e shpreh si rrjedhojë e turpit dhe sedrës, duhet të jeni ju ata që interesoheni për zgjidhjen e hallit të tij.

Krijuesi i Gjithësisë thotë:

“...Do t’i njohësh nga pamja e tyre...” (Bekare, 273)

Me fjalë të tjera, Islami e ngarkon të zotin e pasurisë me një detyrë. E edukon atë si ta përdorë pasurinë e tij, në mënyrë që ajo të bëhet shkak i afrimit të zemrave.



Si në çdo fushë të jetës, Islami ka vendosur një rend edhe në aktivitetin tregtar dhe atë ekonomik. Ka vendosur kufirin midis të lejuarës dhe të ndaluarës. Islami e konsideron besimtarin përgjegjës për vëllain e tij besimtar, duke urdhëruar mëshirë dhe butësi. Fitimin e ka brumosur me parimin e “hakut”, “drejtësisë” dhe “mëshirës”.

Islami ndalon fitimin që vjen si pasojë e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe haramit. Madje ka bërë me dije se adhurimet e kryera duke shkelur të drejtën e njeriut, janë të papranuara. Në një hadith fisnik thuhet:

“Nuk i është bindur Allahut ai që e viziton këtë shtëpi (Qaben) me para të fituara në rrugë të ndaluar. Nëse një njeri i tillë, kur bën nijet për haxh, vishet me ihram, hip mbi yzengji dhe pasi fillon të ecë, thotë: “Lebbejk Allahume lebbejk”, një lajmëtar nga qielli thërret:

«Për ty nuk ka as lebbejk as sa’dejk! Sepse të ardhurat tuaja, ushqimet tuaja, kafsha mbi të cilën kalëron, janë të gjitha të fituara përmes rrugëve të ndaluara. Kthehu si gjynahqar pa fituar asnjë sevap! Mërzitu, sepse do të përballesh me diçka që nuk ka për të të pëlqyer!»

Ndërsa nëse një njeri që niset për haxh me para të fituara në rrugë të lejuar, hip mbi kafshën e tij dhe thotë: Lebbejk Allahume lebbejk, një lajmëtar nga qielli thërret:



«Lebbejk dhe Sa'dejk. Ty t'u përgjigja. Sepse të ardhurat tuaja, ushqimet tuaja, kafsha mbi të cilën kalëron janë të gjitha nga burime të lejuara. Kthehu me sevape shumë të mëdha dhe pa asnjë gjynah. Gëzohu, sepse do të përballesh me gjëra që do të të gëzojnë dhe do të të lumturojnë!»

(Hajthemi, III, 209-210.)

Islami u ka kushtuar rëndësi zekatit, dhurimit dhe bamirësisë dhe ka penguar rritjen e pasurisë në mënyrë të pakontrolluar.

Zekati i detyrueshëm jepet veçanërisht për “pasurinë e grumbulluar». Zekati nuk është fakultativ, por i detyrueshëm. Është e drejta personale e të varfrit. Pra Islami, në një farë kuptimi, të varfrin e ka bërë ortak në pasurinë e të pasurit. Mosdhënia e zekatit është vjedhja më e keqe, është vjedhje e pasurisë (të drejtës) së të varfërve.

Islami siguron një solidarizim të vërtetë me shtresën e ulët sa i takon aspektit material.

Krijuesi i Gjithësisë i vë në provë njerëzit dhe shoqërinë përmes ndarjes së pasurisë dhe rriskut në mënyrë jo të barabartë. Si rrjedhojë e kësaj sprove:

- I pasuri është përgjegjës për të varfrin. Pra i varfri ka të drejta ndaj të pasurit. Në këtë botë i varfri është nevojtar i të pasurit. Në botën tjetër i pasuri do të ketë nevojë për duanë e të varfrit, do të ketë nevojë për shpërblimin e lëmoshës që i ka dhënë të varfrit.



- Personat me gjendje të mirë ekonomike, janë përgjegjës për të mjerët dhe vetmitarët.

- I fuqishmi është përgjegjës për të dobtin.

- I shëndoshi është përgjegjës për të sëmurin. Në këtë botë, të sëmurët kanë nevojë për ndihmën e atyre që janë të shëndoshë. Në Ditën e Gjykimit, në atë ditë të vështirë, njerëzit e shëndoshë do të kenë nevojë për duanë e të sëmurëve.

- I dituri ka përgjegjësi për të paditurin.

Me pak fjalë, ai që zotëron një mundësi të caktuar, është përgjegjës për atë që është i privuar nga ajo mundësi. Pra, secili ka përgjegjësi për njeri-tjetrin.

Çdo qytetërim formon modelin e vet njerëzor. Në Islam, tiparet dalluese të këtij modeli njerëzor, janë bujaria dhe sakrifica. Kështu:

Zekati (Është një përgjegjësi minimale. Është një e drejtë e të varfërit, është e drejta e tij mbi pasurinë e të pasurit.)

Sadakaja (Është një lëmoshë vullnetare që i mbron njerëzit nga problemet dhe fatkeqësitë.)

Infaku (Nuk ka fund, është pa kufi.)

Allahu Fuqiplotë thotë:

لَنْ تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنْفِقُوا مِمَّا تُحِبُّونَ

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...” (Al-i Imran, 92)



Ky nivel i bujarisë dhe sakrificës, e afron më tepër njeriun me Zotin.

Natyrisht gjatë dhurimit, Islami kërkon edukatën, delikatesën dhe ndjeshmërinë e vetëdijes se lëmosha nuk mbërrin në duart e të varfërve apo nevojtarëve, por në dorën e fuqishme të Krijuesit të Gjithësisë në përputhje me ajetin kuranor **“Lëmoshën e merr (Allahu)...”**

Përveç kësaj, e ndalon njeriun nga mbartja e qëllimeve egoiste, si: syfaqësia, dukja, krenaria, mendjemadhësia dhe vetëkënaqësia. Sepse besimi monotesit nuk pranon asnjë lloj ortakërie. Prandaj duhet të dhurohet fshehurazi.

Me pak fjalë, Islami e ka ringjallur shoqërinë me vlera shpirtërore, si: mëshira, sakrifica, altruizmi dhe bujaria.

Tek të parët tanë Osmanët, janë regjistruar rreth 26.600 vakufe. Ka shumë të tjera që ende nuk njihen. Këto institucione të mëshirës e dhembshurisë u shtrinë në të gjithë shoqërinë. Për këtë arsye, në shoqëri të tilla nuk janë përjetuar kriza ekonomike, trazira apo rebelime.

Të tilla probleme nuk kishte as në Epokën e Lumturisë. Përse?

Sepse ekzistonte zekati, infaku (dhurimi), sadakaja, agjërimi...

Gjithashtu nuk përjetohej ndonjë shqetësim psikologjik si (për shembull) depresioni, sepse namazi i ruante njerëzit. Krijuesi i Gjithësisë shprehet:



“..bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!” (Alak, 19)

“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit!” (Bekare, 153)

“Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (Rra'd, 28)

Kjo është pikëpamja botërore e qytetërimit tonë...

Komunizmi solli një model njerëzor të ngurtë, të pashpirt, mizor.

Edhe kapitalizmi solli një rrënim të njeriut që u kthye në qenie brutale, arrogante dhe të devijuar nga natyrshmëria.

Të dy bashkë sollën modelin e njeriut të pamëshirshëm, të pandjeshëm, të pandërgjegjshëm, materialist.

Të gjithë jeni dëshmitarë të vendeve të shfrytëzuara historikisht dhe në mënyrë të veçantë po shihni Sirinë e sotme: Kapitalizmi i egër vjen nga mijëra kilometra larg, bombardon, djeg dhe shkatërron...! Po shfrytëzon burimet e tyre nëntokësore dhe mbitokësore duke shtypur edhe më tepër shtresën e dobët.

Sistemi kapitalist mendon vetëm për interesin material dhe përfitimin. Për këtë arsye e shfrytëzon njeriun në mënyrë të pamëshirshme. E konsideron të lejuar çdo rrugë me qëllim që të arrijë suksesin e tij.



Ndërsa Islami përkundër kapitalizmit dhe komunizmit, zgjon ndërgjegjen duke pyetur:

“Ku e fitove pasurinë? Si e fitove? Ku dhe si do ta përdorësh?” I përkujton njeriut se do japë llogari në mënyrë të hollësishme para gjykimit hyjnor.

Megjithatë një besimtar i devotshëm e nis ditën duke u pyetur nga ndërgjegjja:

“Allahu i plotfuqishëm sot hapi një fletë të re nga kalendari i jetës tënde. Sa kohë do të punosh sot për veten dhe sa kohë për të tjerët? Allahu të dhuroi ty plot nga begatitë e Tij, por filanit nuk i dha. Do të thotë që ai ka të drejta mbi ty...”

Në ajetin fisnik Krijuesi i Gjithësisë thotë:

“Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu.” (Kasas, 77)

Për këtë arsye, një besimtar i vërtetë, me një zemër altruiste, e konsideron veten vazhdimisht përgjegjës në përmbushjen e nevojave dhe mangësive të krijesave, duke dhuruar dhembshuri dhe mëshirë.

Shmangia e shpërdorimit dhe jetesa në mënyrë të moderuar, e afruan të pasurin me të varfrin. Kultura e zekatit, infakut dhe vakufëve, parandaloi përjetimin e dramave në shoqëri.

Secili e konsideroi veten përgjegjës për vëllain e tij, përmes ndjenjës së vllazërisë. Besimtarët ishin si dy duar që lanin njera-tjetrën. Ata ndanë me njeri-tjetrin problemet e veta, jo vetëm në planin



material por edhe në atë shpirtëror. Në këtë mënyrë u ndërtua një shoqëri e fortë si muret e kalasë, e mbërthyer me dashuri, si një trup i vetëm.

Mirëpo, në periudhën e Lales (tulipanëve) shoqëria jonë filloi të jepej pas luksit dhe shpërdorimit. Ndërsa në periudhën e Tanzimatit filloi të shfaqej admirimi për Perëndimin dhe euforia evropiane. Ana materiale zuri vendin e anës shpirtërore. Historia jonë e kohëve të fundit vazhdoi me një qasje imituese ndaj botës kapitaliste duke u tjetërsuar tërësisht nga origjina.

Sot, ne duhet të eliminojmë të gjitha këto aspekte negative dhe të ecim përpara me parimet bazë që Islami kërkon prej nesh. Për të shpëtuar veten dhe për të arritur lumturinë e shoqërisë, duhet të risjellim në praktikë kulturën e vakufëve dhe të dhurimit. Duhet të jemi pasues të denjë të asaj gjenerate që skaliti gurët e sadakasë dhe ndërtoi vakufe për fshirjen e borxhit të njerëzve në defteret e tregtarëve, për përgatitjen e pajës së vajzave të varfra, apo për kompensimin e vlerës së enëve të thyera të shërbëtorëve...





Jo islamofobi, por virtyt islam

Islam do të thotë selam, shpëtim i njerëzimit, paqe, qetësi.

Islami nuk është i frikshëm, përkundrazi është një fe që fal paqe në shpirt, në të njëjtën kohë përhap delikatesë dhe mirësjellje. Islami është feja që lufton të gjitha llojet e padrejtësive dhe terrorit. Jeta profetike 23 vjeçare e

Muhamedit ﷺ, ishte një luftë kundër terrorit.

Islami është feja e mëshirës ndaj çdo krijese.

PYETJA E DHJETË

Sot në botë, termi “islamofobi” po përhapet qëllimisht. Përse thuhet pikërisht “islamofobi” ndërkohë, që për fetë e tjera nuk përdoret termi “fobi-frikë”?

Shkaku i përdorimit të termit “fobi” vetëm për Islamin dhe jo për fetë e tjera, është i qartë:

Sepse:

“Pema që ka fruta goditet”.

“Hajduti synon të vjedhë dyqanin e argjendarrëve dhe jo të vjetërsirave”.

Sot të gjitha fetë e rreme dhe të devijuara, nuk kanë çfarë t’i japin njerëzimit. Kishat në Europë po shiten dhe po kthehen në xhami. Bartësit e besimeve të rreme po mundohen ta paraqesin Islamin si të shëmtuar për t’i dhënë fund përhapjes së tij. Ata po përpiqen ta diskreditojnë Islamin për të parandaluar konvertimin në Islam të bashkëfetarëve të tyre.

Arsyeja pse flasin keq për Islamin është e thjeshtë:

“E kota shqetësohet nga e drejta!”

Ata që flenë në gjumin e shkujdesjes, shqetësohen nga ata që ua prishin gjumin.

Sot Islami po shqetëson njerëzit dhe shoqëritë pragmatiste, si dhe fuqitë imperialiste, si rrjedhojë



e predikimit të mëshirës së vërtetë, dhembshurisë dhe altruizmit. Po ashtu po shqetëson zullumqarët dhe mashtruesit për shkak të drejtësisë dhe të së vërtetës që shpall.

Në të vërtetë, 20-30 vite më parë vendet Evropiane thurën plane kundër saj. Ata pranuan që qytetërimi Islam ishte i vetmi që mund të përballej me qytetërimin perëndimor. Kështu hodhën tezën e Konfliktit të Qytetërimeve.

Ata kanë frikë nga Islami edhe pse myslimanët janë ende shumë larg nga Perëndimi në aspektin material, politik, ushtarak, teknik dhe teknologjik.

Përse ndodh kjo?

Sepse sipas Islamit jeta e vërtetë është jeta e përtejme (Ahireti). Islami ndërthur jetën e kësaj bote me botën tjetër. Jep formulën e lumturisë për të dy botët.

Por ata nuk pranojnë përgjegjësinë e jetës së përtejme dhe janë në kërkim të jetës së dëfrimit, të rastësisë dhe të asaj që përshtatet me dëshirat e tyre egoiste.

Arsyeja pse i kundërvihen Islamit është se kjo fe e ngarkon njeriun me përgjegjësi, përcakton kritere dhe kufij në jetë dhe pengon papërgjegjshmërinë dhe indiferentizmin.

Ata gjithashtu e dinë se pragmatizmi e trazon ndërgjegjen njerëzore, sepse njerëzimi ka nevojë për dhembshuri dhe mëshirë.



Padrejtësia trazon zemrat. Njerëzimi ka nevojë t'i drejtohet një feje që urdhëron drejtësi dhe fal jetë.

Një jetë pa qëllim, jonjerëzore dhe e çmëndur, e lëndon shpirtin njerëzor, sepse njeriu është përherë në kërkim të qëllimit të ekzistencës.

Përgjigjen e kësaj pyetjeje e japin më së miri ata myslimanë që me zemër të mëshirshme e të butë e jetojnë Islamin në mënyrën më të denjë.

Në këtë këndvështrim, duan ta njollosin dhe ta deformojnë Islamin në mendjet njerëzore, në mënyrë që të pengojnë përhapjen e tij në masat e gjera.

Situata e sotme paraqitet e njëjtë me gjendjen e shumë peygamberëve të cilët historikisht janë kundërshtuar dhe ndaj të cilëve është shpifur.

Sot, ata që duan të ndalojnë përhapjen e Islamit në mbarë botën, kanë krijuar një valë të shëmtuar urrejtjeje ndaj tij dhe myslimanëve, nën emrin «Islamofobi». Ata përpiqen ta etiketojnë Islamin me terrorizëm. Shpallin Islamin si diçka të frikshme e që duhet patur fobi.

Por e vërteta është se terrori bazohet në zemërim, ndërsa parimet Islame të edukatës, moralit, ndërgjegjes, dashurisë dhe frikës ndaj Allahut, të vërtetës dhe drejtësisë, janë parime të larta që për ata nuk kanë kurrëfarë vlere. Terrorizmi nuk njeh lot, mëshirë dhe ndërgjegje.

Përkundër kësaj, Islami është ndërtuar veçanërisht mbi bazën e dhembshurisë dhe mëshirës.



Allahu Fuqiptotë në Kuranin Famëlartë na mëson për emrat e Tij “Rrahman”(i Gjithëmëshirshmi) dhe “Rrahim” (Mëshirëploti), pra për mëshirën që ka përfshirë çdo krijesë. Edhe Profeti ﷺ është dërguar si “mëshirë për botët”.



Në Luftën e Dytë Botërore, Amerika bombardoi Japoninë me bombë atomike. Mbetën të varurë gra, fëmijë, të moshuar, njerëz që nuk kishin asnjë lidhje me luftën, madje edhe kafshët e bimët u shkrumbëzuan e u bënë pluhur. Personi që e urdhëroi bombardimin ishte i krishterë. Edhe Hitleri që vrau me qindra mijëra njerëz ishte po ashtu i krishterë. Por askush nuk e quan këtë terrorizëm katolik.

Stalini ishte komunist. Vrau me qindra e mijëra persona. Ndërtoi kala me kafkat e viktimave. Por askush nuk e quan këtë terrorizëm komunist.

Izraeli ka vrarë vëllezërit tanë palestinezë për vite me radhë. Por askush nuk e quan këtë terrorizëm hebre.

Aty ku shteti mbyll njërin sy, në Mijanmar (Myanmar), terroristët po vrasin myslimanët e Arakanit. Por askush nuk e quan këtë terrorizëm budist.

Islami akuzohet me terror edhe pse janë myslimanët atë që nëpërkëmben dhe shkatërrohen.



Islami po përpiket të tregohet si diçka për t'u patur frikë.

E vërteta është se Islami ka sjellë një sistem drejtësie të jashtëzakonshëm, i cili vlen edhe për luftën. I Dërguari i Allahut ishte burim mëshire edhe në luftë. Le të sjellim një shembull:

Në luftën e Bedrit, një ditë para betejës, idhujtarët kërkuan të nxirrnin ujë nga pusi i të Dërguarit të Allahut. Pejgamberi i lejoi.

Në kthimin nga Bedri, kishin mbetur 150 km për të mbërritur në Medine. Ishin zënë 70 robër. Kafshët e udhëtimit nuk mjaftonin. Sahabët e nderuar herë pas here zbrisnin nga devetë e tyre, hipnin robërit mbi deve dhe ecnin. Shpreheshin se: “Edhe ata janë (njerëz) si ne”. I Dërguari i Allahut i porositi sahabët: “Jepuni robërve për të ngrënë e për të pirë ashtu si bëni për veten tuaj!” Shumica dërmuese e myslimanëve ishin mbartës të këtij virtyti dhe kësaj mëshire.

Çfarë i bëri ata të sakrifikojnë në këtë mënyrë?

- Qasja ndaj krijesave me mëshirën hyjnore...
- Shpresa se edhe robërit do udhëzohen (si ata)...
- Shfaqja e një personaliteti dhe karakteri të lartë Islam...

Do të mjaftonte ky shembull për të treguar që Islami i mëson njeriut humanizmin e vërtetë. Pra ky humanizëm është tipar vetëm i Islamit, ndërsa Humanizmi si ideologji është një gënjeshtër boshe.



Kur hedhim vështrimin në histori kuptojmë se, personi që ka luftuar më shumë me terrorin është i Dërguari i Allahut ﷺ. Periudha 23 vjeçare profetike është një periudhë lufte kundër terrorit. Terrorit ndaj të dobtëve në shoqëri, ndaj robërve, skllëvërve, kafshëve e bimësisë... Ai respektoi të drejtat e çdo qenieje njerëzore, pa marrë parasysh nëse është besimtar apo i pafe. Si rrjedhojë solli paqe në shkretëtirat që qenë kthyer në liqene gjaku. Ai hodhi themelet e një qytetërimi të pashembullt të virtyeteve që historia e njerëzimit nuk kishte pare asnjëherë.

Ajo që duhet të bëjmë sot, është praktikimi i moralit të lartë të Resulullahut ﷺ që është dërguar si mëshirë për botët, dhe përcjellja e mesazhit të tij me aq sa kemi mundësi. Nëse e realizojmë këtë detyrë me dinjitet, sado të mundohen ta njollosin Islamin, Allahu i Plotfuqishëm ka për t'i prishur planet e tyre.

Sepse Islam do të thotë selam, shpëtim për njerëzimin, paqe, prehje...

Islami nuk është frikësues, përkundrazi është qetësim i shpirtit, në të njëjtën kohë është një fe që përhap delikatesë dhe mirësjellje. Islami lufton çdo lloj padrejtësie dhe terrori. Është feja e mëshirës ndaj çdo krijese.

Le të japim disa shembuj:

Një ditë i Dërguari i Allahut ﷺ u shpreh:



“Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, nuk do të hyni në Xhenet derisa të mos mëshironi njëri-tjetrin”.

Sahabët thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Të gjithë jemi të mëshirshëm”.

Pejgamberi u përgjigj:

“Mëshira që kam për qëllim nuk është thjesht mëshira që keni për njeri-tjetrin. Përkundrazi është mëshira që përfshin të gjitha krijesat, po, është mëshira që përfshin të gjitha krijesat.”

(Hakim, IV, 185/7310.)

I Dërguari i Allahut ﷺ një ditë pa një person duke tërhequr nga veshi delen, të cilën donte ta therte. Menjëherë ndërhyri duke thënë:

“Lëre veshin e bagëtisë (e kafshës) dhe kape nga qafa.” (Ibn-i Maxhe, Dhebaih, 3.)

Përsëri, i Dërguari i Allahut ﷺ, takoi një grup njerëzish rrugës. Ata ishin ndaluar dhe po flisnin hipur mbi kafshët e tyre. U tha:

“Hipni mbi kafshët tuaja pa i lodhur dhe lërinin të pushojnë. Mos i ktheni ata në karrige për të bërë bisedat tuaja në rrugë. Ka shumë kafshë që janë më të dobishme se personi që mbartin dhe ato e përmendin Allahun më shumë”. (Ahmed, III, 439.)

Sevade ibn Rebi ﷺ ka thënë:



“Dola para Pejgamberit ﷺ dhe kërkova diçka. Ai urdhëroi të më jepeshin disa deve. Pastaj më këshilloi:

“Kur të kthehesh në shtëpinë tënde porositi njerëzit e tu (anëtarët e familjes) që të kujdesen për kafshët, e t’u japin atyre ushqim (në mënyrë të rregullt). Po ashtu, urdhëroi që të presin thonjtë në mënyrë që kur të mjelin (kafshët) mos t’i dëmtojnë thithkat (gjinjtë) e tyre”. (Ahmed, III, 484; Hajthemi, V, 168, 259, VIII, 196.)

Po ashtu kur i Dërguari i Allahut ﷺ po shkonte me sahabet e tij në Mekë, rrugës u ndesh me një gazelë që po flinte e strukur. I Dërguari i Allahut urdhëroi një nga shokët e tij të priste pranë gazelës derisa të kalonin të gjithë në mënyrë që kafsha të mos shqetësohej.³⁵

Ndërsa kur po shkonte në Mekë me një ushtri prej dhjetë mijë ushtarësh, rrugës pa një qen të shtrirë mbi këlyshët duke u ushqyer ato me gji. I Dërguari i Allahut thirri nga sahabet e tij Xhuajl bin Surakën رضي الله عنه, të cilin e ngarkoi me detyrën e rojtarit pranë këtij qeni dhe këlyshve të tij.³⁶

Një herë i Dërguari i Allahut ﷺ pa një fole milingonash që i ishte vënë zjarri. Ai nuk mundi ta pranonte këtë pamje. Foleja e djegur e milingonave trazoi zemrën e tij të butë dhe me një keqardhje të madhe u shpreh:

35. Muvatta, Haxh, 79; Nesai, Haxh, 78.

36. Vakidi, II, 804.

*“Kush e dogji këtë fole? Dënimi me zjarr është një e drejtë vetëm e Zotit të zjarrit.”*³⁷

Përsëri i Dërguari i Allahut kishte parë një beduin (endacak) që për të ushqyer kafshët e tij, përpiquej të hidhte gjethet e pemës duke e goditur atë me një shkop. U tha personave që kishte pranë:

“Ma sillni atë beduin, por silluni butë me të, mos e frikësoni”.

Kur e sollën iu drejtua butësisht:

“O beduin! Hidhi gjethet në mënyrë të butë dhe duke e tundur pemën lehtë, jo duke e thyer atë. (Pra mos e dëmto rrënjën e pemës).” (Ibnu'l-Ethir, Usdu'l-Gabe, Bejrut, 1417, VI, 378.)

I Dërguari i Allahut, i cili nuk pajtohej qoftë edhe me një dëmtim të rëndomtë të një dege peme, në çdo rast i kumtoi umetit të tij mirësinë, ëmbëlsinë, butësinë, mëshirën.

Tek paraardhësit tanë Osmanët, mëshira dhe dhembshuria përfshiu edhe bimët e kafshët. Kështu, ishte e ndaluar me ligj të ngarkohej kafsha përtej mundësisë së saj. Forcat e rendit kishin për detyrë të evidentonin ata që shkelnin këtë ligj, duke i dënuar të mbanin të njëjtën ngarkesë dhe ta linin kafshën të pushojë. Sulltan Sulejmani (Kanuni Sultan Süleyman) gjatë ndërtimit të xhamisë Sulejmanije kishte nxjerrë një sërë dekretesh në lidhje me kaf-

37. Ebu Davud, Xhihad, 112/2675, Edeb, 163-164/5268.



shët që përdoreshin për transport dhe kishte urdhëruar të vëzhgoheshin me kujdes oraret e tyre të pushimit dhe të kullotjes në livadhe.

Si përfundim, emri i një feje që fal mëshirë të tillë, jo vetëm ndaj njerëzve por ndaj të gjitha krijesave, në asnjë mënyrë nuk mund të barazohet me “fobi”-ra. Nëse Islami si fe e virtytit do njihej ashtu siç duhet, në vend të frikës dhe ngurrimit, do ngjallte vetëm dashuri dhe admirim. Përpyekja për ta njolllosur duke anashkaluar këto virtyte, nuk është gjë tjetër vetëm se një tregues dashakeqësie.





Çlirimi i vërtetë, xhihadi i vërtetë

*Qëllimi i xhihadit në Islam,
nuk është derdhja e gjakut me dëshirën e
pushtimit dhe sundimit të botës, por është
dëshira për të pushtuar zemrat.*

PYETJA E NJËMBËDHJETË

Siç dihet, tashmë në Afrin jemi përfshirë në luftë. Në përvjetorin e 103-të të epopesë së jash-tëzakonshme të Çanakalasë, pasardhësit trima të të parëve tanë me të njëjtën frymë besimi po shkruajnë sot një tjetër epope në kufirin me Sirinë dhe Irakun Verior. Në Afrin kemi dhënë dëshmorë dhe veteranë. Si duhet ta kuptojmë operacionin e Afrinit në kontekstin luftarak (fet'h)? Ç'është pushtimi i vërtetë? Cili është kuptimi i vërtetë i xhihadt në Islam?

Qëllimi i xhihadt në Islam nuk është derdhja e gjakut me dëshirën e pushtimit dhe sundimit të botës, por është dëshira për të pushtuar zemrat.

Domethënia e xhihadt në Islam nuk është vrasja e njeriut, por zhdukja e së keqes. Është eliminimi i padrejtësisë. Është udhëzimi i njerëzve. Është ringjallja e zemrave. Ky është thelbi i xhihadt.

Kur hedhim vështrimin në Epokën e Lumturisë, shohim se ashtu si sot, paganët e luftuan Islamin në Bedër, Uhud, Hendek dhe në të gjitha luftërat e tjera...

Disa të paditur, herë pas here bëjnë veprime të gabuara në emër Islamit dhe këtë ia mveshin fesë. Kjo është një ngjarje që nuk mund të pranohet kurrë nga Islami, sepse Islami është feja e mëshirës, i cili edhe në rast lufte urdhëron kujdes ndaj ligjit të së



drejtës dhe mëshirës. Lufta bëhet vetëm në raste të detyrueshme.

Gjatë gjithë historisë, myslimanët kanë përhapur drejtësi kudo ku kanë shkuar. Për shembull në Poloni shprehja: *“Për sa kohë kuajt e Osmanllinjve nuk pinë ujë në lumin Visla, ky vend nuk mund të gjejë lirinë dhe pavarësinë.”*, është kthyer në një fjalë të urtë. Ajo zonë pati njohur ligjin, drejtësinë e paqen vetëm duke qenë në mbrojtjen e Islamit.

Reformatori gjerman Martin Luter (Martin Luther) ka thënë:

“O Zot! Silli turqit e mëdhenj sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që përmes tyre edhe ne të begatohemi nga drejtësia Jote hyjnore.”

Udhëheqësit që shfrytëzuan në mënyrë të pamëshirshme popullin e tyre, Martin Luteri i paralajmëroi me këto fjalë:

“Në vend që të jetojmë në administrimin e princave të pangopur, agallarëve të tokave e borgjezisë, preferojmë të jetojmë në administrimin osman. Sepse ata janë më të mëshirshëm ndaj të varfërve sesa ju.”

Një nga themeluesit e Revolucionit Francez të vitit 1789, filozofi La Fajet (La Fayette), pasi studioi të gjitha sistemet e drejtësisë, vërejti madhëstsinë e ligjit Islam dhe duke iu referuar Profetit ﷺ u shpreh:

“O njeri i lavdishëm e i madh! Sado të të laudërojnë është pak për ty! Sepse ti je drejtësia



vetë. Askush deri më sot nuk ka arritur të ngjitet në nivelin e drejtësisë që ti ke përhapur.” (Kamil MIRAS, Tecrid-i Sarih Tercemesi, IX, 289.)

Ushtria e lavdishme e Fatihut (Sultan Fatih Mehmet), kur mori Stambollin u dhuroi nga një shtëpi si lëmoshë të krishterëve të varfër.

Kapiteni Barbaros Hajretin Pasha, hebrejtë e përndjekur të Spanjës i dërgoi me anije në Stamboll. Banorët e Stambollit treguan mëshirë e kujdes për ta duke thënë: “Këta janë njerëz të shtypur”.

Ky është horizonti i ndërgjegjes së një myslimani. Kjo është ndërgjegjja e botës Islame. Kjo është ajo që ne kuptojmë me fjalën xhihad.



Nga ana tjetër, mbrojtja e atdheut, e fesë, ruajtja e nderit, mbrojtja e gjërave të shenjta, sakrifikimi i jetës dhe i pasurisë për të zhdukur të keqen dhe përçarjen, është gjithashtu pjesë e xhihadit. Edhe pse mund të mos ketë luftë në kuptimin konkret, lufta shpirtërore është një proces pa mbarim.

Për rrjedhojë, ta shohësh xhihadin vetëm si “luftë të armatosur”, do të thotë ta kufizosh përmbajtjen e këtij koncepti. Kjo është thjesht dëshira e atyre që duan ta largojnë njerëzimin nga Islami duke e paraqitur atë si “fe të luftës”.

Xhihadi nuk është gjë tjetër vetëm se një përpjekje për ta lartësuar Islamin në zemrat e nje-



rëzve duke përdorur të gjitha mundësitë që ka dhuruar Allahu.

Po kështu në këtë kuptim përfshihet çdo kontribut personal dhe shoqëror për ta jetuar e për ta mbajtur gjallë fenë e Allahut.

Kështu:

- Edukimi i njeriut në formën më të mirë, është xhihad.
- Edukimi i nxënësve të Kuranit, është xhihad.
- Përpjekja për t'i shërbyer Islamit, kontributi material dhe shpirtëror është xhihad.
- Mbështetja dhe realizimi (publikimi) i botimeve islame është xhihad.
- Edukimi i dëshmuesve të Zotit, Allahut, në tokë, pra i njerëzve që e përfaqësojnë denjësisht Islamin, është po ashtu xhihad.

Kështu “thirrja në Islam” është një “xhihad i madh”.

Krijuesi i Gjithësisë shprehet:

“Mos i dëgjo mohuesit, por luftoju ata me forcë nëpërmjet këtij (Kurani).” (Furkan, 52)

Urdhri për të **“luftuar me forcë”**, i përmendur në këtë ajet, zbriti në periudhën e Mekës, në një kohë kur besimtarët nuk kishin forcë materiale për t'i luftuar politeistët. Ky urdhër hyjnor zbulon një nga kuptimet më të rëndësishme të xhihadit, atë të kumtesës së parimeve kuranore përmes praktikimit në jetë.



Kështu, në vende të tilla si Etiopia dhe Indonezia, Islami u përhap pa luftë.

Krahas kësaj, ndërhyrja ushtarake në një rast të nevojshëm duke patur një qëllim sublim (të drejtë), konsiderohet gjithashtu xhihad. Operacioni i sotëm në Afrin përbën një shembull të tillë.

Siç dihet, ushtria jonë trime, ushtarët tanë besimplotë, mbrojtën atdheun për një periudhë disa mujore. Ata u përpoqën duke sakrifikuar deri në vetëmohim. Patëm dëshmorë dhe të plagosur. Lusim Allahun t'i mëshirojë dëshmorët tanë, t'i shërojë të plagosurit tanë dhe të afërmve të tyre t'u japë durim!

Kur vështrojmë në histori, kuptojmë se nëse në një betejë kanë rënë dëshmorë të vërtetë, nëse shpirtrat janë martirizuar për Allahun, atëherë fitorja është e garantuar. Në të kundërt, nëse kanë vdekur ca shpirtra të rrënuar, e ardhmja e vendit është shkatërrim, disfatë, shkretim i tokave të atdheut.

Sot dëgjojmë porosi të bukura (amanete) të lëna nga dëshmorë që kanë dhënë shpirtin për Allahun. Një dëshmor i la amanet vëllait të tij:

“Vëlla, nëse bie dëshmor, me paratë që do dorëzojë shteti si kompensim, dërgoji prindërit tanë në haxh, paguaj borxhin e babait, e ti martohu”.

Po kështu, teksa po nisej drejt frontit të luftës një ushtar, pyetet:

“A dëshiron t'i thuash diçka familjes tënde?”



“Mos të më presin!”, -përgjigjet ai.

Trima të tillë që vrapojnë duke fluturuar drejt martirizimit, shpresojmë të jenë lajmëtarë të një triumi të madh.

Shprehje të tilla janë reflektimi i sotëm i shpirtit të ushtarëve të lavdishëm të Sulltan Mehmed Fatihut, që kur iu ngjit mureve të kalasë së Stambollit, tha “*Sot është radha jonë të biem dëshmorë*”.

Është dëshmia e martirëve të vërtetë që dhanë jetën për fe, atdhe e komb.

Kjo frymë është manifestimi i sotëm i emocionit të besimit që vazhdon nga lufta e Bedrit deri në atë të Çanakalasë.

Pasardhësit e atij brezi të lavdishëm po shkruajnë sot përsëri të njëjtën epope.

Martirët tanë besimplotë e veteranët e luftës do jenë umeti trim që do mbulohet me dashuri nën Flamurin e Lavdërimit (Liva-u'l-Hamd) të Krenarisë së Njerëzimit, Pejgamberit ﷺ.

Mehmed Akif Ersoj shprehet me admirim:

“O dëshmor, bir i dëshmorit, mos kërko varr nga unë,

Pejgamberi po të pret krahëhapur...”

Falënderimet i qofshin (Krijuesit të Gjithësisë):

✓ Zëri i ezanit mos pushoftë për asnjë çast në qiejt tanë,

✓ Flamuri që mbart hënën e Islamit mos u ultë asnjëherë,



✓ Dora e huaj mos prektë vendet tona të adhurimit,

✓ Mos shkeltë këmbë armiku në këtë atdhe ku do të jetojmë e mbajmë gjallë fenë e besimin tonë,

✓ Falënderimet i qofshin Atij që ushtarët tanë besimtarë, bijtë tanë trima, paguajnë me jetën e tyre për sovranitetin e Turqisë si kalaja e vetme dhe më e madhe e Islamit.

Në luftën e Bedrit, myslimanët në dukje ishin të dobët, të pafuqishëm dhe të pakët në numër, por Krijuesi Fuqiplotë e përforcoi atë ushtri të besimit me melekë, me një ushtri të padukshme. E njëjta gjë ndodhi edhe në Çanakala.

Në Çanakala, Lutfi Beu i rrethuar nga armiku, thërriste:

“Eja o Muhamed! Libri yt shkoi!”

Besimi, sinqeriteti, sakrifica e ushtarëve tanë, ndryshuan rrjedhën e betejës së madhe kundër ushtrive të kryqëzatave dhe e pamundura u bë e mundur.

Falë atyre trimave shprehja “Çanakalaja është e pakalueshme” u shkrua përjetësisht në histori. Ata fituan ndihmën e Allahut në sajë të besimit të sinqertë që kishin në zemër.

Historiani Hamilton, komandanti anglez në luftën e Çanakalasë, është shprehur:

“Ne nuk u mundëm nga fuqia materiale e turqe, por nga fuqia shpirtërore e tyre. Ata



nuk patën më as barut për të hedhur. Por ne shihnim fuqinë që zbriste nga qielli.” Pra në atë luftë metafizika eliminoi fiziken (hyjnorja mundi njerëzoren). U vërtetua se forca e besimit është mundësia më e madhe brenda çdo pamundësie.

Kur Uinston Çërçill (Winston Churchill) u pyet në shtetin e tij për disfatën në luftën e Çanakalasë, ai u shpreh:

“A nuk e kuptoni, në Çanakala nuk luftuam me turqit, por me Allahun! Natyrisht që do humbisnim...”, duke u detyruar kështu të pranonte këtë ndihmë hyjnore.

Edhe në Luftën e Pavarësisë, si sot, vendi ishte i rrethur ngado. Populli ynë i rrethuar nga armiku nuk kishte asnjë fuqi të dukshme. Por ndihma e Allahut nuk mungoi.

Ndodhi të ngjashme u përjetuan edhe në operacionin e Qipros.

Fitorja e 15 Korrikut ishte një fitore që nuk mund të konceptohet dot me mendje, një manifestim i ndjeshmërisë së lartë shoqërore. Ishte ndihma e Allahut. Ndoshta ne nuk arritëm ta shikojmë, por mbase Ai dërgoi melekët e Tij. Vendi pothuajse u përhumbe, atdheu u përça. Por ndihma hyjnore nuk vonoi.

Edhe në ditët e sotme vërejmë që ka një përpjekje të pamatë për t’ia dalë ndaj superfuqive. Me besimin e plotë të ushtarëve, djemve tanë trima, Allahu ka



dhuruar fitore përmes një fuqie që ne nuk e shohim, por vetëm Ai e di.

Besimtari nuk është kurrë pesimist, por gjithnjë optimist. E ardhmja është fitore. Nuk ka dyshim!

Detyra jonë është të lutemi për ata që janë në front.

Të mos harrojmë se lufta fitohet me përpjekjet e singerta të **“ushtarëve të luftës”** dhe **“ushtarëve të lutjes”**. Njëri është fronti material, ndërsa tjetri është ai shpirtëror. Të dy janë shumë të nevojshëm. Sepse për sa kohë trimat e frontit të luftës mbështeten në një komb që lutet për ta, ata kurrë nuk do të mposhten. Fuqia morale është superiore ndaj armikut. Është pikërisht kjo fuqi shpirtërore që përbën forcën më ndikuese në arritjen e fitoreve në lufta. Sepse një shpirt i pamposhtur nga ana morale dhe shpirtërore, është e pamundur të mposhtet edhe nga ushtritë më moderne.

Nisur nga kjo, të gjithë ne si komb duhet të lutemi shumë për bijtë e këtij atdheu të lavdishëm. Trimat tanë do t'i nisim në mbrojtje të atdheut bashkë me lutjet tona. Në mënyrë të veçantë duhet të lutemi në namazin e natës për fitoren e Islamit dhe të myslimanëve.

Po ashtu duhet të shpreshtojmë duanë që bënte ushtria e paktë në numër, por e fortë në besim, e Talutit, kur përballej me ushtrinë e shumtë në numër të Xhalutit:



رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَثَبِّتْ أَقْدَامَنَا وَانصُرْنَا عَلَى
الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ

“...Zoti ynë! Na pajis me durim (na e mbush zemrën me besim), **na forco këmbët tona** (na jep fuqi të përballojmë, të rezistojmë) **dhe na ndihmo kundër këtij populli jobesimtar!”** (Bekare, 250)

Po ashtu, duhet të përpiqemi të lexojmë çdo mëngjes suren Fet’h.

Lusim Krijuesin Fuqiplotë të na dhurojë fitore materiale dhe shpirtërore në saje të ushtrisë së duave të singerta, lutjeve të singerta të myslimanëve të shtypur dhe përpjekjeve altruiste të ushtrisë sonë të shenjtë!





Tregime dhe këshilla nga Rumi

Rumi thotë:

“Fjalët e miqve të Allahut janë plot jetë, të pastra, të kulluara si uji i lumit. Përfito prej tyre sa të mundesh, shuaje etjen duke pirë nga ai ujë, që në zemrën tënde të çelin lulet e trëndafilat e shpirtit.”

PYETJA E Dymbëdhjetë

Sot ndodhemi në Konja, në qytetin e Mevlana Xhalaleddin Rumiut, sulltanit të zemrave. Shohim se keni një lidhje të veçantë me Mevlanën, keni shkruar vepra në lidhje me të si dhe i referoheni shumë edhe në veprat tuaja.

Nëse do të kërkonim disa nga historitë dhe tregimet plot urtësi të Mevlanës, që kanë ndikuar më shumë tek ju, çfarë do na thonit?

Para së gjithash më lejoni të shpreh se të gjithë miqtë e Allahut kanë një ndikim të madh dhe Mevlana dallon në mesin e tyre. Me aftësinë e rrallë të shprehjes, ai ka arritur të kumbojë me një stil tejet letrar, të fshehtat dhe urtësitë e njohjes dhe dashurisë hyjnore në botën e ndjenjave të miqve të Allahut. Shembull i kësaj është vepra “*Methnevi Sherif*”.

Le të tubohen sot të gjitha fakultetet e të shkruajnë një vepër të ngjashme me “*Methnevinë*”, të thurin 26.600 vargjet e saj. Do të ishte e pamundur! Sepse kjo është një vepër e shpirtit.

Mendja e ka të vështirë të kuptojë të vërtetat abstrakte. E veçanta e Mevlanës është se përmes shembujve konkret, ai arrin të përcjellë lehtësisht në zemrat e njerëzve këto të vërteta që është e vështirë të kuptohen. Prandaj në veprat e tij u është lënë shumë hapësirë shembujve, krahasimeve dhe tregimeve.



Po ashtu në veprat e Mevlanës kemi shumë tregime dhe këshilla të urta. Le të paraqesim disa prej tyre:

Mevlana i quan mendjelehtë ata të cilët janë të hallakatur, të hutuar e të pandjeshëm ndaj manifestimeve të panumërta të fuqisë dhe madhështisë hyjnore, të shfaqura në univers, si dhe ata që edhe pse ushqehen me dhuntitë e Allahut, harrojnë pronarin e vërtetë të tyre dhe Ditën e Gjykimit. Ai thotë se mendjelehtësia është shkatërrim hyjnor që nuk ka shërim, sepse mendjelehti e ka lidhur zemrën me këtë botë. Ashtu si dashuria e qengjit për ujkun, mendjelehti e ka skllavëruar veten përjetësisht ndaj dëshirave egoiste shkatërruese.

Mevlana, në veprën e tij “*Methnevi*”, tregon rrugën se si duhet qëndruar larg këtyre mendjelehtëve të përfshirë në zemërimin hyjnor, në mënyrë që të mos ndikohemi negativisht dhe gjendja e tyre të mos reflektojë tek ne.

LARGOHEM NGA MENDJELEHTI!

Isai عليه السلام po largohej me shpejtësi sikur ta ndiqte një luan nga pas. I habitur nga kjo pamje, një burrë e ndjek nga pas dhe e pyet:

“-Nga kush po largohesh kështu si një zog i trembur? Askush nuk po të ndjek!”

Aq shpejt po vraponte saqë nga nxitimi Isai عليه السلام nuk i ktheu dot përgjigje. Më në fund burri kureshtar u afrua dhe e pyeti përsëri:



“- O Ruhullah! (frymë e Allahut)! Ikja jote u bë mister për mua. Nga kush po largohesh?”

Isai  iu përgjigj:

“Po largohem nga mendjelehti, nga i pamendi...! Ik mos më pengo, më lër të shpëtoj veten!”

Këtë herë burri i përkuqton mrekullitë (me të cilat ishte dërguar) dhe e pyet sërish për urtësinë e largimit: “A nuk je ti «Mesihu» që prej frymës tënde gjetën shërim të verbërit dhe të shurdhët?” Isai  iu përgjigj:

“Po, unë u lexova të shurdhëve dhe të verbërve emrin më të Madh të Allahut dhe ata gjetën shërim. U lexova të vdekurve dhe ata u ringjallën. Mirëpo kur i lexova mendjelehtit për të disatën herë me dhembshuri e mëshirë, ai përsëri nuk përfitoi. Mbeti si gur e prapë se prap nuk hoqi dorë nga mendjelehtësia. U kthye në rërë të thatë ku as bari s’mbiu”.

Pasi dëgjoi këto fjalë, kureshtja e burrit u shtua edhe më shumë dhe e pyeti përsëri:

“Meqë dua jote ka ndikim dhe shërim në shumë gjëra, si është e mundur të mos ketë ndikim tek mendjelehtësia? Ndërkohë që sëmundjet e tjera i shëron, përse këtë jo?”

Isai  u përgjigj:

“Mendjelehtësia është një sëmundje shkatërruese. Ndërsa të tjerat janë varësi që nuk kanë fituar zemërimin e Allahut. Edhe varësia është sëmundje por ajo ka ndikim vetëm tek i sëmuri. Ndërsa



mendjelehtësia është një sëmundje e tillë që dëmton jo vetëm të sëmurin por edhe të tjerët përreth”.

Me të vërtetë mendjelehtësia është zgjedhja e kësaj bote kundrejt ahiretit, apo të një pike uji kundrejt një deti të tërë. Ajo të shtyn të bësh një zgjedhje kaq të verbër, që në fakt është verbërimi i vetë zemrës. Është përhumbla e saj ndaj gjithë manifestimeve hyjnore. Mendjelehti vështrohet i hutuar manifestimet e panumërta të fuqisë dhe madhësisë së Allahut pa qenë i aftë të shohë asgjë, ashtu si një njeri që nuk mund të shohë nëse i mbyll sytë me gishtërinjtë e tij.

Rasti i tij i përngjet maces:

Nëse maces do i ofronin disa qebapë të shijshëm, ajo do i refuzonte në këmbim të një miu të pisët. Kjo i ngjan sakrifikimit të lumturisë së përjetshme si rezultat i nënshtrimit ndaj dëshirave egoiste.

Kështu duhet të largohemi nga mendjelehtëti siç ikim nga luanët me frikën që të mos ndikohemi nga gjendja e tyre.

Krijuesi i Gjithësisë në ajetin fisnik shprehet:

“...mos rri me keqbërësit.” (En'am, 65)



Përsëri, hutimin e njeriut dhe indiferentizmin e tij përballë shfaqjeve të panumërta të fuqisë dhe madhësisë hyjnore në univers, zhvlerësimin që njeriu i bën detit përballë një pike uji të vetme, Mevlana e shpreh me këtë krahasim:



Në një kohë, Bagdadi ishte një qendër unike e qytetërimit, e zbulimeve të mëdha, e shkencës dhe artit. Lumi Tigër, që kalonte përmes qytetit, ofronte një shfaqje të jashtëzakonshme të artit hyjnor. Mevlana tregon:

“Një ditë Bagdadi vizitohet nga një ká që e shëtiti qytetin pash më pash. Në gjithë atë Bagdad legjendar, të vetmet mirësi i duken lëkurat e pjeprit e shalqirit...”

Natyrisht gjëja që i tërheq vëmendjen kaut dhe gomarit, është ose kashta e shpërndarë rrugës ose barishtet që mbijnë qosheve!”

Edhe gjendja e nefsit të prirur për keq, nuk është e ndryshme nga kjo. Ai e harron ahiretin duke u përhumbur në këtë botë; e dëmton jetën duke u dhënë pas gjërave të shëmtuara, humb vlerat hyjnore dhe mbërthehet në mendjelehtësinë e kërkimit të diturisë në tregun e mjerimit.

Mevlana e shpreh me një tjetër shembull konkret vështirësinë e shpëtimit nga një ego e pabindur si dhe domosdoshmërinë jetësore të pastrimit të nefsit, si një kusht për të arritur shpëtimin e përjetshëm:

DOMOSDOSHMERIA E PASTRIMIT TË EGOS

“Një prijës, teksa po kalëronte me kalin e tij, shikoi një person që po flinte nën pemë dhe një gjarpër të zi që po i futej në gojë. I tronditur nisi të



bëjë gjithçka për ta shpëtuar njeriun e përgjumur. Filloi ta godasë fuqishëm me një kamxhik. Nga dhimbja njeriu u ngrit nga vendi dhe iku me vrap.

Prijësi nuk iu nda dhe e zuri nën një pemë molle. E detyroi të hante mollë të kalbura dhe nga ana tjetër i tha:

“-O hallexhi i pashpresë, do t'i hash të gjitha! Do ta vuash këtë përvojë të hidhur!” Njeriu i shkretë i hutuar e mallkoi duke i thënë:

“-O prijësi! Çfarë të kam bërë? Përse po më keqtrajton? Nëse ke për qëllim jetën time, më vrit me shpatën tënde. Paska qenë e mallkuar dita kur të pashë. Sa fatlumë paskan qenë njerëzit që nuk ta kanë parë fytyrën. O Zot, jepja Ti dënimin këtij zullumqari!”

Por prijësi nuk u ndikua nga ato fjalë. Vazhdoi ta ndiqte duke e goditur me kamxhikë.

Njeriu i shkretë vazhdoi të vraponte si era nga frika e prijësit dhe dhimbja që i shkaktonte kamxhiku. Por tashmë nga lodhja nuk kishte më fuqi të hidhte asnjë hap. I rraskapitur filloi të villte...

Çdo gjë që kishte ngrënë, filloi t'i dilte nga goja me shumë vështirësi. Më në fund së bashku me mollët e kalbura doli edhe gjarpri i zi.

Njeriu i shkretë u tmerrua nga gjarpri i frikshëm. Menjëherë u soll nga prijësi dhe u përul duke thënë:

“Vërtet ti u shfaqe si mëshira e Xhebrailit. Paskë qenë begati për mua. Sa e bekuar paska qenë dita kur të pashë. Po të mos ishe ti, unë do të vdisja



në një mënyrë të tmerrshme. Nga injoranca dhe pakujdesia të kam thënë fjalë të pakuptimta. Prandaj më fal. Kam folur nga hutimi”.

Prijësi u përgjigj:

“Po të të tregoja për atë që të kishte ndodhur, do të trembeshe. Frika do të të kishte mposhtur. Po të kishe njohur natyrën e tmerrshme të egos që të rrokullis në Xhehenem, nuk do të të ngelte më fuqi as të haje mollën, as të ecje dhe as të nxirrje gjarprin e zi...”

Unë i kalova me durim fjalët tuaja të pahijshme dhe vazhdimisht u luta: “O Zot! Bëje të lehtë daljen e gjarprit. Shpëtoje këtë njeri të gjorë!” Edhe pse ti flisje fjalë të hidhura, mëshira e zemrës sime nuk do të të linte kurrë në atë gjendje. Sepse natyra ime është brumosur me mëshirë.”



Mevlana ishte në kërkim të njeriut të përsosur, edukuesit të zemrave, të brumosur me dashurinë hyjnore. Ai përcjell një tjetër histori në lidhje me dëshirën e zjarrtë të këtij njeriu të përsosur, këtij njeriu ideal që synon të orientojë dhe udhëzojë shoqërinë.

PO KËRKOJ NJERIUN...

“Ishte natë. Dola nga shtëpia. Po shëtisja në rrethina. Pashë një burrë që po ecte me një pish-tar në dorë dhe e pyeta:



-Çfarë kërkon në këtë errësirë të natës?

- Po kërkoj njeriun, -u përgjigj burri.

I thashë:

-Për të ardhur keq! Kot lodhesh. Unë edhe pse e lashë vendin tim, përsëri nuk arrita ta gjej. Shko në shtëpi... Pusho. Kot kërkon, nuk do ta gjesh dot!”

Burri i gjerë vështroi me keqardhje dhe tha:

“Edhe unë e di që nuk kam për ta gjetur. Por ende ndjej kënaqësi duke e kërkuar. Edhe malli për të me jep kënaqësi.”

Pra nuk ka vend për pesimizëm. Duhet gjetur kënaqësi edhe në mall e kërkim...

Mevlana, ndoshta këtu mund të ketë nënkuptuar Shems-i Tibrizin, sepse për një farë kohe e pati humbur Shemsin. Përfjetoi një ndarje të madhe. Pastaj e humbi krejtësisht dhe jetoi gjithnjë me mallin për të. Kërkoi vazhdimisht një njeri që e kuptonte dhe me të cilin mund të ndante misterin dhe urtësitë e zemrës.

Mësuesi ynë i medresesë, Nuretin Topçu, një mendimtar i dhënë pas Mevlanës, i cili na jepte sociologji, kishte një qasje në lidhje me paaftësinë e shumicës së njerëzve për të kuptuar thellësinë e mendimit të Mevlanës.

Ai shprehej:

“Ne kemi dëgjuar vetëm thirrjet e ekstazës



(vexhd) së Mevlanës. Ne nuk arrijmë të shohim qetësinë e thellësisë së detit ku ai noton. Ne mund të shohim vetëm atë që shfaqet në sipërfaqen e detit të dalë nga thellësia e tij. Nuk kemi arritur të përjetojmë ashkun e Mevlanës, por vetëm thirrjet e tij të përkthyer në gjuhën e dashurisë. Vetëm kaq është ajo që mundohemi të shprehim me gjuhën tonë të pamjaftueshme. Realisht vetëm ai u zhyt në detin e qetësisë. Neve na mbetën vetëm ca zëra të shkëputur nga stuhia e ekstazës së tij. Sa keq! Kur mendojmë se ky është Mevlana...”³⁸

Me këtë rast dua ta përkujtoj me rahmet (me mëshirë) edhe një tjetër mësues. I ndjeri Abdulkadir Keçeollu (Abdulkadir Keçeoğlu), ose i njohur ndryshe si “Jaman Dede” (Yaman Dede), ishte një nga njerëzit që mbolli dashurinë për Mevlanën në zemrat tona, teksa ishim ende studentë.

Pasi kishte qenë i krishterë, më vonë pranoi islam. Në një orë letërsie, mësuesi na shkroi disa vargje nga Methnevija e Mevlanës. I frymëzuar shpirtërisht, bota e tij e brendshme filloi të gulfonte, duke u udhëzuar me besim.

Në kohën tonë në medrese jepej lënda e persishtes. Ai ishte mësuesi ynë i gjuhës perse. Gjatë orës së mësimi jepte ca njohuri gramatikore pastaj shkruante në tabelë dhe komentonte mes lotësh

38. Nurettin Topçu, *Mevlana ve Tasavvuf*, s. 139.



gjatë e gjatë një nga vargjet e Mevlanës në gjuhën perse.

Një ditë një shok e pyeti:

“-Profesor, pse na flisni kaq shumë për Mevlanën?”

Ai u përgjigj:

“-Biri im, Mevlana më mori për dore dhe më dërgoi tek dera e të Dërguarit të Allahut, duke u bërë shkak për udhëzimin tim. Të përkujtoj dikë që më shpëtoi nga zjarri është më e pakta që mund të bëj”.

Madje ai ka një poezi shumë të ndjerë që përshkruan dashurinë e thellë për të **Dërguarin e Allahut**:

*Nga dëshira (malli) për ty shpirti pikon gjak
ja Resulallah*

Si e duroj mallin për ty nuk e di ja Resulallah

*Në kuvendin e shpirtrave isha një rënkim i
pashtershëm ja Resulallah*

*Më lumturo me bukurinë tënde që të digjem
ja Resulallah*



Le ta përfundojmë takimin tonë me disa këshilla të urta të Mevlanës. Ai shprehet:

- “O kërkues (i së Vërtetës)! Nëse dëshiron ta njohësh të vërtetën, dije se as Musai as Faraoni nuk kanë vdekur, ata janë në brendësinë tënde,



janë fshehur në ekzistencën tënde dhe vazhdojnë të luftojnë mes tyre në zemrën tënde. Për këtë arsye, këta dy armiq duhet t'i kërkossh në veten tënde!"

- *"Të thyesh idhuj është e lehtë, madje shumë e lehtë. (Me një sopatë mund t'i bësh pluhur e hi.) Por të mendosh se është e lehtë të thyesh idhullin e egos tënde, është injorancë, injorancë! (Sepse egoja përmes hileve të saj fshihet si një dhelprë dinake dhe ti nuk mund ta shohësh më atë idhull që duhet thyer.)*

"O Vëlla! Pasoje urdhërin e Allahut dhe traditën e Pejgamberit, që të shpëtosh nga Ebu Xhehli dhe dëshirat egoiste."

- *"Lutu dhe pendohu me zemër të mbushur nga zjarri i pendimit dhe sy të njomur (nga lotët)! Sepse lulet çelin në vende me diell dhe lagështi!"*

- *"Mos u mundo aq shumë të kujdesesh për lëkurën. Sepse fundja ajo është një kurban i tokës, por kujdesu për zemrën tënde. Ajo që do lartësohet dhe nderohet është zemra jote."*

Ushqeje trupin tënd me masë, sepse ai që e kalon kufirin, bie pre e dëshirave egoiste dhe si rezultat turpërohet.

Ushqeje shpirtin tënd. Ofroji mendim të pjezur, kuptim të thellë dhe ushqim shpirtëror në mënyrë që të mbërrijë fuqishëm aty ku duhet..."

- *O vëlla! Trupi yt përbëhet nga kockat dhe*



mishi. Kështu edhe i kafshëve. Ti duhet të jetosh me meditim. Nëse mediton rreth trëndafilit, ti je në kopështin e trëndafilit. Pra në xhenetin e tokës. E nëse mendon rreth gjembit, ti je trungu i stufës.”

- *Merr një abdest të tillë që kurrë të mos priset. Fal një namaz të tillë që kurrë të mos mbarojë. Ashikut nuk i mjaftojnë pesë kohë të namazit. Atij i duhen pesë qind mijë kohë. A do donte një ashik i vërtetë që malli të mbaronte?”*

- *Mendja pyeti zemrën: “Ç’është feja?” Zemra u përkul në veshin e mendjes dhe tha: “Feja është edukatë!”*

- *“Shoqërohu me njerëz të mirë, që karvani i besnikëve të shtohet. Sepse sa më i mbushur me njerëz të tillë të jetë ky karvan, aq më shumë thyhen ata që presin rrugën (rebelët).”*

- *“Sado i pasur të jesh, mund të ushqehesh aq sa mundesh. Nëse e zhyt enën në det mund të marrësh ujë aq sa ajo nxë, pjesa tjetër ngelet jashtë.”*

- *“Sa e sa peshq të zhytur në qetësinë e detit janë kapur nga grepi si rezultat i pangopësisë.”*

- *“Bir! Vdekja është e ndryshme për secilin njeri; për atë që e urren vdekjen, pa menduar se ajo është takimi i njeriut me Krijuesin, ajo i shfaqet si një armik i frikshëm. Për atë që është i miqësuar me vdekjen, shfaqet si një mik i vërtetë.*



• *“Të bëhesh rob i një miku të Allahut, është më mirë se të jesh kurorë e mbretërve.”*

Zoti na e mundësoftë të gjithëve të dëgjojmë me veshin e shpirtit thirrjet e zemrës të Mevlanës dhe shokëve të tij, miqve të Allahut! Na e mundësoftë të pasojmë parimet e larta që gjallërojnë shpirtin!

Zoti ynë mos e mungoftë në zemrën tonë dashurinë për të dashurit e Tij! Ai me mirësinë e Tij, na mundësoftë të edukohemi me moralin e robërve të Tij të dashur, të ecim në gjurmët e tyre dhe në fund të ringjallemi bashkë me ata njerëz të mirë!

Amin!



PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	5
------------------	---

Çfarë dhe si i mësoi Profeti ﷺ sahabët dhe çfarë arriti?	9
---	----------

Çfarë është dituria e dobishme?	14
---------------------------------------	----

Si mësoi i Dërguari i Allahut?	15
--------------------------------------	----

Metoda e tij e veçantë e edukimit	16
---	----

Metoda e tij e jashtëzakonshme e drejtimit	16
--	----

Aftësia e jashtëzakonshme e udhëheqjes	18
--	----

Drejtësia e tij e jashtëzakonshme	18
---	----

Nxënësit e tij	19
----------------------	----

U mësoi Kuranin	20
-----------------------	----

Si përpiquej ai ﷺ të mësonte të tjerët?	20
---	----

Dëlrësia e Kuranit	21
--------------------------	----

Ai u mësoi imanin	22
-------------------------	----

Ai u mësoi se jeta e vërtetë është jeta e Ahiretit	23
--	----

Ai u mësoi adhurimet	24
----------------------------	----



Ai u mësoi të kërkohet virtyti.....	26
Ai u mësoi zgjimin në seher	27
Ai u mësoi pastërtinë.....	27
Ai u mësoi të drejtën dhe ligjin.....	28
U mësoi moralin e bukur	29
U mësoi çfarë duhet mposhtur dhe rrugën që duhet të ndjekim për këtë qëllim.....	30
Si u mësoi?	37
Çfarë arriti ai?	40
Cili ishte përfundimi i mësimi dhe edukimit të tij?.....	40
Si arriti i Dërguari i Allahut që nga një shoqëri inorante të ndërtonte epokën e lumturisë.....	41
Ruajtja e qëndrueshmërisë në fe	49
Përçarja për shkak të ateizmit dhe deizmit.....	61
Suneti është praktikimi në jetë i Kuranit.....	83
Çfarë është dhe çfarë nuk është tasavvufi?.....	95
Çfarë është tasavvufi?.....	97
Çfarë nuk është tasavvufi?.....	99
Mrekullia e vërtetë është istikameti.....	105
Miq të Allahut.....	115
Kur është i nevojshëm Tasavvufi?	123



Çfarë solli e çfarë mori me vete jeta moderne?	133
Çfarë masash duhet të marrim?	144
Sistemet njerëzore dhe ISLAMI	
si fe e vërtetë	145
Jo islamofobi, por virtyt islam	159
Çlirimi i vërtetë, xhihadi i vërtetë	171
Tregime dhe këshilla nga Rumi	183
Largohem nga mendjelehti!	186
Domosdoshmëria e pastrimit të egos	189
Po kërkoj njeriun...	191

